

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

VJETARI 2018



39

PRISHTINË
2019

**AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS**

VJETARI 2018

39



**KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS**

YEAR-BOOK 2018

39

**Editor: Correspondent member Myzafere Limani,
Scientific Secretary**



**PRISHTINA
2019**

**AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS**

VJETARI 2018

39

**Redaktor: Anëtare korrespondente Myzafer Limani,
Sekretare shkencore**



**PRISHTINË
2019**

Copyright © ASHAK

PËRMBAJTJA

PËRBËRJA E AKADEMISË	1
KRYESIA	1
ANËTARËT E AKADEMISË	2
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	2
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	2
SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	2
SEKSIONI I ARTEVE	3
ANËTARËT IN MEMORIAM	3
ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS	3
ANËTARËT E JASHTËM	3
ANËTARË NDERI	4
SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE DHE TEKNIKE	4
RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2018	5
KUVENDI	6
KRYESIA	9
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	37
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	42
SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	48
SEKSIONI I ARTEVE	49
SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE E TEKNIKE	50
RAPORTI I PERFORMANCËS FINANCIARE PËR VITIN 2018	53
PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2019	59
PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS	71
KRONIKA E VITIT 2018	78

PËRBËRJA E AKADEMISË

KRYESIA



Akademik
Nexhat Daci
Kryetar



Anëtare
korrespondeente
**Justina
Shiroka Pula**
*Sekretare e
Seksionit të
Shkencave
Shoqërore*



Akademik
Jusuf Bajraktari
Nënkrjetar



Anëtar
korrespondent
**Fetah
Podvorica**
*Sekretar i Seksionit
të Shkencave të
Natyrës*



Anëtare
korrespondeente
Myzafere Limani
*Sekretare
shkencore*



Anëtar
korrespondent
Luan Mulliqi
*Sekretar i
Seksionit të
Arteve*



Akademik
Eqrem Basha
*Sekretar i
Seksionit të
Gjuhësisë dhe
të Letërsisë*

ANËTARËT E AKADEMISË

SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Ali Aliu (1934), i zgjedhur më 2000,
Eqrem Basha (1948), i zgjedhur më
2004,
Idriz Ajeti (1917), i zgjedhur më 1975,
Mehmet Kraja (1952), i zgjedhur më
2008,
Rexhep Ismajli (1947), i zgjedhur më
1996,
Rexhep Qosja (1936), i zgjedhur më
1975,
Sabri Hamiti (1950), i zgjedhur më
2008.
Zejnullah Rrahmani (1952), i zgjedhur
më 2016.

b) Anëtarët korrespondentë:

Bardh Rugova (1974) i zgjedhur më
2016,
Kujtim Shala (1974), i zgjedhur më
2016,
Mehmet Halimi (1937), i zgjedhur më
2012.

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Anton K. Berishaj (1954), i zgjedhur më
2016,
Ekrem Murtezai (1931), i zgjedhur më
2000,
Hivzi Islami (1946), i zgjedhur më 2000,
Isa Mustafa (1951), i zgjedhur më 2012,
Jusuf Bajraktari (1948), i zgjedhur më
2016.

b) Anëtarët korrespondentë:

Arsim Bajrami (1960), i zgjedhur më
2012,
Edi Shukriu (1950), e zgjedhur më 2012,
Frashër Demaj (1973), i zgjedhur më
2016,
Gjyljeta Mushkolaj (1963), e zgjedhur
më 2016,
Justina Shiroka Pula (1953), e zgjedhur
më 2016,
Muhamedin Kullashi (1949), i zgjedhur
më 2016.

SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Fejzullah Krasniqi (1953), i zgjedhur më
2012,
Feriz Krasniqi (1931), i zgjedhur më
2000,
Isuf Krasniqi (1948), i zgjedhur më
2012,
Minir Dushi (1929), i zgjedhur më 1979,
Nexhat Daci (1944), i zgjedhur më
1996.

b) Anëtarët korrespondentë:

Arsim Morina (1956), i zgjedhur më
2012,
Fetah Podvorica (1968), i zgjedhur më
2016,
Myzafer Limani (1954), e zgjedhur më
2016,
Qamil Haxhibeqiri (1949), i zgjedhur më
2012,
Salih Gashi (1944), i zgjedhur më 2012.

SEKSIONI I ARTEVE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Rauf Dhomi (1945), i zgjedhur më 1996,
Rexhep Ferri (1937), i zgjedhur më
2000,
Tahir Emra (1938), i zgjedhur më 2008,
Zeqirja Ballata (1943), i zgjedhur më
2000.

b) Anëtarët korrespondentë:

Luan Mulliqi (1953), i zgjedhur më
2012,
Xhevdet Xhafa (1934), i zgjedhur më
2012.

ANËTARËT IN MEMORIAM

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Agim Çavdarbasha,
Ali Hadri,
Ali Podrimja,
Besim Bokshi,
Dervish Rozhaja,
Engjëll Berisha,
Esat Stavileci,
Enver Gjerqeku,
Esad Mekuli,
Fehmi Agani,
Gazmend Zajmi,
Jashar Rexhepagiq,
Latif Susuri,
Mark Krasniqi,
Muharrem Berisha,
Musa Haxhiu,
Muslim Mulliqi,
Osman Imami,
Pajazit Nushi,
Remzi Bakalli,
Syrja Popovci,
Vladeta Vukoviq,
Vukasin Filipoviq.

b) Anëtarët korrespondentë:

Anton Pashku,
Eshref Ademaj,
Hajredin Hoxha,
Ibrahim Rugova,
Ruzhdi Pllana.

ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Sinan Hasani (letërsi), Serbi, i zgjedhur
më 1986.

b) Anëtarët korrespondentë:

Zef Mirdita (histori), Kroaci, i zgjedhur
më 1991.

ANËTARËT E JASHTËM

Aleksandar Stipčević (histori), Kroaci, i
zgjedhur më 1983,
Ismail Kadare (letërsi), Shqipëri, i
zgjedhur më 1991,
Wilfried Fiedler (gjuhësi), Gjermani, i
zgjedhur më 1991,
Eric Hamp (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur
më 1991,
Shaban Demiraj (gjuhësi), Shqipëri, i
zgjedhur më 1996,
Gunnar Svane (gjuhësi), Danimarkë, i
zgjedhur më 1996,
Kristian Gyt (histori e kulturës), Francë,
i zgjedhur më 1996,
Gjelosh Gjokaj (art figurativ), Gjermani,
i zgjedhur më 1996,
Leonard Newmark (gjuhësi), SHBA, i
zgjedhur më 2000,
Robert Elsie (letërsi), Kanada, i zgjedhur
më 2000,

Michel Roux (gjeografi, gjeopolitikë), Francë, i zgjedhur më 2000,
 Muhamedin Kullashi (filozofi), Francë, i zgjedhur më 2000,
 Tomë Berisha (elektroteknikë), Kroaci, i zgjedhur më 2000,
 Noel Malcolm (histori), Angli, i zgjedhur më 2004,
 Victor Friedman (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 2004,
 Emin Riza (arkitekturë), Shqipëri, i zgjedhur më 2008,
 Françesko Altimari (gjuhësi), Itali, i zgjedhur më 2008,
 Muhamet Mufaku (histori), Jordan, i zgjedhur më 2008,
 Alajdin Abazi (elektroteknikë), Maqedoni, i zgjedhur më 2012,
 Kolec Topalli (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2012,
 Oliver Schmit (histori), Austri, i zgjedhur më 2012,
 Radoslav Katičić (gjuhësi), Kroaci, i zgjedhur më 2012,
 Bahri Beci (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2016,
 Matteo Mandala (gjuhësi), Itali, i zgjedhur më 2016,
 Mentor Petrela (mjekësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2016,
 Kristaq Prifti (histori), Shqipëri, i zgjedhur më 2016.

ANËTARË NDERI

Ferid Murati, nobelist, jeton në SHBA, i zgjedhur më 2000.

SHËRBIMI ADMINISTRATIV, PROFESIONAL E TEKNIK

Lendita Juniku Pula, sekretare e Akademisë,
 Ali Caka, drejtor i Departamentit të Përkrahjes Profesionale dhe Teknologjisë së Informacionit e Komunikimeve,
 Vjollca Hykolli, drejtoreshë e Departamentit për Buxhet dhe Financa,
 Hilmi Zogjani, drejtor i Departamentit të Bibliotekës dhe Arkivit,
 Furtuna Naka, udhëheqëse e prokurimit,
 Xhemshit Brajshori, zyrtar i lartë për marrëdhënie ndërkombëtare,
 Hasime Maliqi, zyrtare certifikuese,
 Lirijeta Bunjaku, zyrtare e lartë për buxhet dhe financa,
 Lidije Kelmendi, zyrtare e librarisë,
 Rejhane Ajeti Islami, zyrtare e lartë për bibliografi dhe hulumtim shkencor
 Bedri Pllana, zyrtar bibliotekar,
 Taulant Veseli, administrator i lartë i sistemeve të TIK-ut,
 Premtim Farizi, zyrtar i TI-së për përkrahje,
 Burim Rexhepi, zyrtar i lartë i redaktimit teknik,
 Nitë Krasniqi, asistente ekzekutive,
 Alban Bytyçi, vozitës-korrier,
 Valbona Olluri, zyrtare teknike.

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2018



KUVENDI

Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në vitin 2018 ka mbajtur dy mbledhje. Mbledhja e parë më 8 shkurt 2018 (XCIV) dhe mbledhja e dytë më 28 qershor 2018 (XCV).

1. Në mbledhjen e parë të vitit 2018 (XCIV), përveç miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse, Kuvendi shqyrtoi edhe pikat: Miratimi i Raportit të punës të ASHAK-ut për vitin 2017, miratimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2017 dhe miratimi i Planit strategjik gjithëpërfshirës të ASHAK-ut për vitet 2018-2021 .

Mbledhjen e hapi Kryetari Daci, i cili fillimisht tha se Raporti paraqet punën e Akademisë për vitin e kaluar dhe që Seksionet i kanë shqyrtuar raportet e tyre në mbledhje të rregullta. Raporti i plotë më pas është shqyrtuar edhe në mbledhjen e Kryesisë së Akademisë. Kryetari më pas shtoi se materialet janë ndarë me kohë dhe sot jemi mbledhur për miratimin e Raportit.

Kuvendi filloi shqyrtimin e Raportit të punës të ASHAK-ut, me rend, duke filluar nga Kuvendi. Gjatë shqyrtimit të raportit të punës së Kuvendit, J. Bajraktari propozoi të bëhen disa ndryshime në faqen 5 dhe 6. Propozimi u miratua.

Më pas u shqyrtuan me rend raportet e punës të Kryesisë, të seksioneve dhe të

Shërbimit profesional, administrativ e teknik të ASHAK-ut.

Kuvendi njëzëri miratoi raportin e punës të ASHAK-ut për vitin 2017. Raporti është pjesë përbërëse e procesverbalit dhe do të botohet në Vjetari 2017.

Më pas u miratua njëzëri edhe Raporti financiar i ASHAK-ut për vitin 2017, i cili po ashtu do të botohet në Vjetari 2017. Kuvendi në vazhdim shqyrtoi draftin e Planin strategjik gjithëpërfshirës të ASHAK-ut për vitet 2018-2021. Kryetari Daci e njoftoi Kuvendin se drafti i Planit strategjik është hartuar nga Grupi i caktuar me vendim të Kryesisë së ASHAK-ut dhe e hapi diskutimin. Diskutuan M. Kraja, S. Hamiti, Salih Gashi, Arsim Bajrami, Hivzi Islami.

M. Kraja në diskutimin e tij paraqiti disa sugjerime lidhur me pikat që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkombëtar të Akademisë. S. Hamiti propozoi që teksti të shkurtrohet, ashtu që disa pika të përmbliidhen në një të vetme. S. Gashi tha se është bërë punë e mirë dhe paraqiti disa propozime të reja për plotësimin e disa pikave. A. Bajrami e përgëzoi Grupin punues për punën e bërë dhe paraqiti disa propozime, të cilat tha se do t'i hartojë me shkrim dhe do t'ia paraqesë Grupit. H. Islami në diskutimin e tij tha se ky Plan strategjik është i pari që po hartohet në Akademi dhe se hartimi i tij rrjedh si kërkesë e Auditorit të përgjithshëm, e që edhe për ne është një gjë e mirë, sepse mundëson planifikim më të mirë financiar. Grupi

punues ka bërë punë të mirë, mund të ketë disa lëshime të cilat mund të përmirësohen.

Pas diskutimeve, kryetari Daci tha se e përshëndet dhe e përkrah punën e Grupit punues. Dokumenti është hartuar me përgjegjësi dhe përkushtim, por gjithnjë ka vend për përmirësime. Ai më pas ia kaloi fjalën sekretares shkencore Myzaferë Limani, njëherësh kryesuese e Grupi punues, për të dhënë sqarimet përkatëse.

M. Limani në diskutimin e saj fillimisht i falënderoi të gjithë parafolësit për vlerësimet e mira dhe për sugjerimet e propozimet e paraqitura. Ajo e njoftoi Kuvendin se Grupi punues ka punuar në përbërje të plotë dhe ka hartuar Strukturën themelore të planit strategjik gjithëpërfshirës, të cilën ua ka ndarë të gjithë anëtarëve të Akademisë për të paraqitur sugjerimet dhe propozimet eventuale. Brenda periudhës prej rreth 20 ditëve grupi ka pranuar dy propozime nga dy anëtarë të Akademisë (Z. Ballata dhe M. Halimi). Meqë nuk ka pasur të tjera propozime Grupi e ka finalizuar dokumentin të cilin paraprakisht e ka shqyrtuar Kryesia e Akademisë, e cila më pas ka vendosur t'ia përcjellë Kuvendit të saj. Ajo vazhdoi duke thënë se pajtohet me sugjerimet dhe propozimet që u dhanë dhe mendon që ato duhet të përfshihen në Planin strategjik.

Në fund kryetari Daci, duke marrë parasysh diskutimet rreth kësaj çështjeje, propozoi që miratimi i Planit

strategjik të shtyhet për mbledhjen e radhës të Kuvendit dhe në ndërkohë të plotësohet me propozimet që u paraqitën. Propozimi u miratua njëzëri nga Kuvendi.

2. Në mbledhjen e dytë të Kuvendit për vitin 2018 (XCV) u shqyrtuan pikat e rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCIV të Kuvendit të Akademisë, miratimi i Programit të punës të ASHAK-ut për vitin 2019, miratimi i Planit strategjik gjithëpërfshirës 2018-2021 dhe miratimi i rregulloreve: Rregullorja për organizimin e koncerteve, Rregullorja për organizimin e ekspozitave, Rregullorja për udhëtimet zyrtare dhe Rregullorja për përdorimin e veturave zyrtare.

Kryetari Daci e hapi mbledhjen dhe më pas filloi shqyrtimi i Programit të punës me radhë sipas seksioneve. Programi i punës për vitin 2019 u miratua unanimisht dhe është pjesë përbërëse e procesverbalit.

Kuvendi më pas, po ashtu, shqyrtoi Planin strategjik gjithëpërfshirës të ASHAK-ut 2018-2021. Kryetari Daci tha se Plani strategjik po shqyrtohet për herë të dytë në Kuvend dhe se nuk e konsideron të nevojshme të hapet diskutimi për këtë pikë. Ai tha se drafti u është ndarë dy herë të gjithë anëtarëve të Akademisë për të paraqitur vërejtjet dhe sugjerimet përkatëse. Ato që i janë dërguar grupit punues janë marrë parasysh dhe janë përfshirë në draft dhe sot jemi këtu për ta miratuar atë. Pas kryetarit diskutoi

M. Kraja dhe S. Hamiti. M. Kraja në diskutimin e tij tha se ky është drafti i dytë që po shqyrtohet dhe nuk ka shumë ndryshime nga i pari. Plani strategjik është shumë evaziv dhe nuk përputhet me Ligjin dhe Statutin e Akademisë, ka fjali të tepërta që duhet të redaktohen, ndërsa S. Hamiti tha se teksti i Planit strategjik është i përgjithësuar.

Pas diskutimeve Kuvendi njëzëri e miratoi Planin strategjik gjithëpërfshirës 2018-2021. U tha që para publikimit në faqen ueb dokumenti të redaktohet nga një anëtar i Akademisë të cilin do ta caktojë Kryesia e saj.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kuvendi shqyrtoi me radhë rregulloret e përgatitura për miratim në Kuvend. Kryetari Daci tha se edhe rregulloret u janë ndarë me kohë të gjithë anëtarëve të Akademisë për të paraqitur vërejtje dhe sugjerime.

Gjatë shqyrtimit të rregulloreve për organizimin e ekspozitave dhe koncerteve diskutimin e filloi Z. Ballata, i cili propozoi që këto dy rregullore të shkrihen në një të vetme, por N. Daci dhe L. Mulliqi sqaruan se ekspozitat dhe koncertet kanë specifikat e tyre, prandaj Grupi punues e ka parë të nevojshme të jenë të ndara. Xh. Xhafa në diskutimin e tij propozoi që në Rregulloren për organizimin e ekspozitave të përfshihen vetëm ekspozitat e anëtarëve të Akademisë për shkak se Akademia nuk ka buxhet të mjaftueshëm për organizimin e

ekspozitave të autorëve nga jashtë.

Por L. Mulliqi sqaroi se ekspozitat planifikohen dhe organizohen me miratimin e organeve drejtuese të Akademisë, duke u bazuar në buxhetin e saj, prandaj nëse nuk ka mjete të mjaftueshme nuk miratohen, por në parim në rregullore duhet të përfshihen edhe autorët e jashtëm, meqë kjo gjë është e paraparë edhe me Ligjin dhe Statutin e ASHAK-ut. M. Kraja në diskutimin e tij tha se ASHAK-ut i duhen edhe rregullore të tjera për organizimin e aktiviteteve shkencore si: konferenca, simpoziume, tryeza, etj. Ai po ashtu tha se duhet të rishikohet përbërja e Grupit punues, meqë ata nuk mund të dinë për të gjitha fushat. Me këtë rast ndërhyri kryetari Daci, i cili tha se Grupi punues ka paraparë hartimin edhe të rregulloreve të tjera, ndërsa sa i përket përbërjes së Grupit ai tha se në të janë të përfshirë anëtarë të të gjitha seksioneve të cilët kanë punuar me përkushtim dhe profesionalizëm.

Në vazhdim diskutoi edhe Zejnullah Rrahmani i cili e përgëzoi Grupin punues për punën e bërë, por tha se do të ishte mirë që të gjitha aktivitetet të përfshiheshin në një rregullore të vetme.

Pas diskutimeve u miratuan njëzëri Rregullorja për organizimin e koncerteve dhe Rregullorja për organizimin e ekspozitave.

Më pas filloi shqyrtimi i Rregullores për udhëtimet zyrtare. M. Kraja propozoi

që neni 3, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 të plotësohet në fund me këtë fjali: "në koordinim me kryetarin e Akademisë". Propozimi u miratua dhe u tha që fjalia të përfshihet në Rregullore. Rregullorja më pas u miratua njëzëri.

Në fund u shqyrtua edhe Rregullorja për përdorimin e veturave zyrtare. A. Aliu propozoi që neni 2, paragrafi 1 të plotësohet si në vijim: "Kryetari i Akademisë e përdor automjetin zyrtar, për punë zyrtare, pa kufizim". S. Hamiti në diskutimin e tij tha se kjo rregullore është shumë gjithëpërfshirëse dhe në të ka gjëra shumë të thjeshta që nuk ka nevojë të sanksionohen me rregullore. Pas diskutimit të S. Hamitit reagoi kryetari Daci, i cili tha se kjo rregullore është më se e nevojshme, sepse ASHAK-u i ka dy vetura dhe vetëm një shofer. Shoferi duhet të jetë në Akademi për kryerjen e punëve që i takojnë e jo nëpër udhëtime zyrtare.

Po ashtu veturat e Akademisë mund të përdoren nga anëtarët e Akademisë, apo nga punonjësit e Administratës, me autorizime përkatëse, vetëm në raste të domosdoshme, gjithnjë në përputhje me Rregullore. Me këtë rast S. Hamiti në fjalën e tij shprehu shqetësim se kohë më parë i është dashur të udhëtojnë në Tiranë për të mbajtur ligjëratë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Ligjëratat ka qenë e parapara me Programin e punës së ASHAK-ut dhe me Protokollin ASHAK-ASHSH. Ai tha se ka udhëtuar me veturë private dhe arsyetimi që ka marrë nga ASHAK-u ka qenë mungesa e shoferit.

Pas S. Hamitit kryetari Daci sqaroi se çështja e përdorimit të veturave është qartësuar edhe në mbledhjen e Kryesisë së Akademisë. Ai tha se të gjithë duhet t'u përmbahen rregulloreve, të paraqesin me kohë kërkesat për udhëtime zyrtare, ashtu që të ketë kohë të sigurohet transporti me taksì, meqë tani e tutje udhëtimet duhet të bëhen me shërbim të taksive. Rregullorja për përdorimin e veturave zyrtare u miratua me dy vota kundër (A. Aliu dhe M. Kraja).

KRYESIA

Bazuar në kompetencat dhe obligimet e përcaktuara me Ligjin për Akademinë dhe me Statutin e saj, Kryesia e Akademisë në 13 mbledhjet e vitit 2018 është marrë me shqyrtimin e shumë çështjeve.

Në vazhdim në mënyrë kronologjike do të pasqyrohet aktiviteti i Kryesisë së Akademisë.

1. Kryesia e Akademisë gjatë vitit 2018 ka mbajtur 13 mbledhje në të cilat është marrë me shqyrtimin e çështjeve, duke u bazuar në kompetencat e parapara me Ligjin, Statutin dhe aktet e tjera normative të Akademisë.

I. Kryesia në mbledhjen I të vitit 2018, mbajtur më 10 janar, pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse shqyrtoi raportin përfundimtar të punës (janar 2016 - dhjetor 2017) për projektin shkencor "Kadastri i ndotësve të ujërave efluent

në recipient dhe trajtimi i tyre (me biosorbent dhe osmozë reverse). Raporti u miratua dhe Kryesia mori vendim për pagimin e paushallëve personave të angazhuar në projekt për vitin 2017 si më poshtë:

1. Akademik Nexhat Daci, 4.500,00€;
2. Anëtar korresp. Salih Gashi, 3.300,00€;
3. Dr. Sc. Majlinda Daci Ajvazi, 3.200,00€;
4. Dr. Sc. Bashkim Thaqi, 2.000,00€;
5. Dr. Sc. Ismet Hashani, 500,00€
6. Dr. Sc. Lulzim Zeneli, 400,00€
7. Ms. Dafina Hoxha, 1.100,00€;
8. Ms. Arta Rudi, 800,00€;
9. Mr. Bardh Begolli, 1,100,00€.

Më pas u shqyrtua edhe raporti përfundimtar i punës (janar - dhjetor 2017) për projektin shkencor: "Parametrat e jashtëm projektues të klimës për disa qytete të Kosovës". Raporti u miratua dhe u vendos që personave të angazhuar në projekt t'u paguhen paushallët për vitin 2017 si më poshtë:

1. Akademik Fejzullah Krasniqi, 3.800,00€;
2. Dr. Sc. Rexhep Selimaj, 2.500,00€;
3. Akademik Isuf Krasniqi, 1.200,00€;
4. Prof. Dr. Fehmi Krasniqi, 500,00€;
5. Inxh. i dipl. Letafete Latifi, 700,00€.

Kryesia, sipas radhës, shqyrtoi dhe miratoi raportin vjetor të punës (janar - dhjetor 2017) për projektin: "Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës (Tabloja fizike-hapësinore,

demografike dhe funksionale)", Qendrat urbane dhe mori vendim për pagimin e paushallëve për personat e angazhuar në projekt për vitin 2017 si më poshtë:

1. Akademik Hivzi islami, 2.200,00€;
2. Anëtar korresp. Frashër Demaj, 1.900,00€;
3. Prof. Dr. Fehmi Rexhepi, 1.900,00€;
4. Prof. Dr. Ibrahim Ramadani, 1,900.00€;
5. Prof. asist. Dr. Arsim Ejupi, 1,900.00€;
6. Ass. Dr. Valbon Bytyqi, 1,900.00€
7. Akademik Anton K. Berishaj, 1,500.00€;
8. Akademik Jusuf Bajraktari, 1,500.00€;
9. Dr. Qerim Kastrati, 800.00€;
10. Dr. Hazër Dana, 800.00€;
11. Prof. Ass. Dr. Ferim Gashi, 500.00€;
12. Imri Musliu, 500.00€;
13. Shqipëri Ahmetxhekaj, 500.00€;
14. Dr. Tomor Qela, 500.00€;
15. Shpend Agaj, 500.00€;
16. Bahri Hajredini, 500.00€;
17. Bajram Kafexholli, 500.00€;
18. Besart Bajrami, 500.00€;
19. Dardan Hoti, 500.00€;
20. Egzona Grajçevci, 500.00€;
21. Fatmire Krasniqi, 500.00€;
22. Faton Morina, 500.00€;
23. Hasim Kryeziu, 500.00€;
24. Leutrim Krasniqi, 500.00€;
25. Mirdita Lahi, 500.00€;
26. Muhamed Kallaba, 500.00€;
27. Naim Vlasi, 500.00€;
28. Nexhat Rexha, 500.00€;
29. Addhe Krasniqi, 500.00€;
30. Ramiz Cervadiku, 500.00€;
31. Sami Restelica, 500.00€;

32. Selim Qevani, 500.00€;
33. Veton Gashi, 500.00€;
34. Zekirja Elezi, 500.00€;
35. Amir Rexha, 500.00€;
36. Esmā Artić, 600.00€.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje, Kryesia diskutoi për çështjen e botimit të Fjalorit enciklopedik të Kosovës (FEK). Kryetari Daci në diskutimin e tij tha se deri më tani është punuar mirë dhe me seriozitet për FEK. Ai njoftoi Kryesinë se ka pasur një takim konstruktiv me akademik Rexhep Ismajlin, anëtar i Redaksisë qendrore të FEK dhe se ditëve në vijim do të mbajë një takim edhe me akademik Mehmet Krajën, kryeredaktor i FEK. Pas takimit, pasi të prezantohet një pasqyrë e punës deri më tani, do të njoftohet edhe Kryesia. Ai më pas propozoi që pasi të përfundohet Fjalori të shtypen disa kopje për Redaksinë dhe udhëheqjen e Akademisë. Në këtë mënyrë do të evitohen lëshimet eventuale para botimit dhe nuk do të përballemi me kritika nga jashtë. Diskutuan edhe J. Bajraktari, E. Basha, L. Mulliqi.

J. Bajraktari dhe E. Basha thanë se punët e FEK konsiderohen të përfunduara dhe se pajtohen që vendimet e reja për FEK të merren pasi të paraqitet një raport nga kryeredaktori. L. Mulliqi në diskutimin e tij tha se për Fjalor është punuar mjaft dhe se kryeredaktori ka punuar mirë dhe me përkushtim. Pasi të botohet mund të dalin gabimet, sepse është e natyrshme për një projekt kaq madhor, por vazhdoi ai të gjitha mund t'i parandalojmë nëse angazhohemi të

gjithë së bashku, meqë Fjalori është i të gjithëve. Ai propozoi që Fjalori të publikohet fillimisht në formën elektronike, ashtu që të merren vërejtjet dhe sugjerimet eventuale. Lidhur me këtë propozim kryetari Daci tha se publikimi elektronik mund të ketë anën pozitive dhe atë negative, prandaj duhet të mendohet mirë kjo çështje.

Pas diskutimeve u tha se pagesat për kryeredaktorin, anëtarët e Bordit dhe anëtarët e Redaksisë së FEK të paguhen edhe për muajt janar-shkurt 2018 dhe më pas ndërpriten të gjitha pagesat. Po ashtu të gjithë u pajtuan se FEK të përkrahet dhe të shtyhet përpara.

Më pas kryetari Daci njoftoi se është koha e hartimit të raporteve të punës të seksioneve për vitin 2017, prandaj duhet të fillohet me mbajtjen e mbledhjeve të seksioneve, më pas të Kryesisë dhe mbledhjes së Kuvendit në të cilën miratohet raporti i punës së Akademisë për vitin 2017. Ai kërkoi nga L. Pula të njoftojë Kryesinë për datat e mundshme për mbajtjen e mbledhjeve. Kryesia shqyrtoi datat e propozuara dhe u pajtua që mbledhjet e seksioneve të mbahen deri më 19 janar, Kryesia të mbledhet më 24 janar dhe mbledhja e Kuvendit të mbahet më 8 shkurt 2018.

Në kuadër të pikës së radhës të rendit të ditës, kryetari Daci tha se faqja ueb e Akademisë duhet të mirëmbahet dhe të përditësohet me shënimet përkatëse. U tha që Redaksisë së faqes

ueb t'i përcillet porosia nga Kryesia e Akademisë për kryerjen e punëve të sipërpërmendura.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, kryetari Daci hapi para Kryesisë disa çështje:

a) Kërkoj që Administrata e Akademisë të kryejë punët që i përkasin, duke respektuar parimin se Administrata mbështet punën e anëtarëve të Akademisë dhe duhet të jetë në funksion të tyre sa herë që kërkohet. Ai më pas kërkoj po ashtu që sekretarët e seksioneve të marrin përgjegjësitë e përcaktuara me aktet normative të Akademisë në të mirë të realizimit të punëve përkatëse;

b) Paraqiti nevojën e zëdhënësit në Akademi dhe propozoi që këtë detyrë ta ushtrojë secili sekretar për Seksionin e tij;

c) Diskutoi për Bibliotekën e Akademisë, me theks të veçantë në hapjen e saj. Ai tha se duhet të krijohen kushtet që Biblioteka të shfrytëzohet nga studiues, doktorantë dhe persona të tjerë nga jashtë dhe se me këtë çështje të merret edhe Grupi për hartimin e dokumenteve për realizimin e Planit strategjik gjithëpërfshirës;

ç) Shprehu shqetësim për mbylljen e Akademisë. Tha se disa herë ka propozuar dhe ka provuar të krijohet lidhja dhe të thellohet bashkëpunimi ndërmjet ASHAK-ut dhe UP-së, por deri më tani kjo nuk ka ndodhur. Ai më pas

propozoi që sa më parë të realizohet një takim me rektorin e UP-së dhe Grupi për hartimin e dokumenteve për realizimin e Planit strategjik gjithëpërfshirës të hartojë një draft-memorandum të bashkëpunimit ASHAK-UP;

d) Propozoi që ASHAK-u t'u bëjë ftesë përfaqësuesve të Akademisë Nacionale Gjermane të Shkencave - Leopoldina që të vizitojnë ASHAK-un në një kohë të përshtatshme.

Me propozimet e kryetarit u pajtuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë.

Njëherësh në kuadër të po kësaj pike të rendit të ditës L. Pula njoftoi Kryesinë se:

a) Kohë më parë drejtori i Bibliotekës së ASHAK-ut ka realizuar një takim dhe ka pasur kontakte përmes postës elektronike me Institutin e Shkencave të Informacionit IZUM në Maribori për përfshirjen e Bibliotekës së ASHAK-ut në sistemin kombëtar bibliografik COBISS,KS. Nga ana e IZUM-it ka gatishmëri që në fazën e parë të aftësohet një zyrtar i ASHAK-ut për katalogimin e librave. Ky proces të kryhet pa pagesë nga ana e tyre, ndërsa ASHAK-u duhet bërë një pagesë simbolike mujore;

b) Deri në fund të javës së ardhshme në Ministrinë e Financave duhet të dërgohet plani i rrjedhës së parasë dhe se për periudhën janar-qershor mund të kërkohen mjete financiare deri në

50% të vlerës totale të buxhetit. Duke marrë parasysh se nga viti i kaluar për shkak të mungesës së mjeteve financiare kanë mbetur pa u botuar disa dorëshkrime dhe se në Programin e punës për vitin 2018 janë paraparë botime të reja, projekte, aktivitete shkencore e artistike, është e nevojshme që Administrata të ketë një pasqyrë të prioriteteve të seksioneve në mënyrë që mjetet e alokuara të shpenzohen me plan.

Sa i përket çështjes së Bibliotekës, Kryesia u pajtua që puna në këtë drejtim të vazhdojë dhe sekretarja shkencore të përcjellë procesin dhe të vendosë për hapat e ardhshëm.

Lidhur më planin e rrjedhës së pasasë diskutuan M. Limani, L. Mulliqi, F. Podvorica dhe J. Pula. Të gjithë shprehën mendimin se është e nevojshme që seksionet të përcaktojnë prioritetet e tyre në mbledhjet e radhës dhe më pas Këshilli botues i Akademisë të vendosë për rrjedhën e punës.

2. Në mbledhjen II, mbajtur më 24 janar, Kryesia pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja I e Kryesisë shqyrtoi Raportin e punës dhe Raportin financiar të Akademisë për vitin 2017. U tha se vitin që shkoi janë realizuar shumë aktivitete dhe janë botuar një numër i konsiderueshëm i veprave, por kanë mbetur pa u realizuar edhe të tjera aktivitete dhe botime për shkak të shkurtimeve buxhetore. Kryetari Daci tha se raporti financiar është përgatitur mirë dhe në të janë paraqitur të gjitha

shpenzimet. L. Mulliqi në diskutimin e tij propozoi që te pjesa e shpenzimeve kapitale të precizohet se mjetet kanë të bëjnë me Qendrën Leksikografike Enciklopedike - QLE. E. Basha shtroi çështjen e mjeteve të mbetura dhe tha se në njërin anë flasim për mungesën e mjeteve financiare, ndërsa në anën tjetër shihet se ka mbetje të mjeteve të pashpenzuara. L. Pula ofroi sqarimet lidhur me këtë çështje. Ajo tha se deri në fund të vitit 2016 ka pasur mundësi të lëvizjes së mjeteve financiare nëpër kode dhe mjetet financiare të pashpenzuara brenda një kodi kanë mundur të ridestinohen për qëllime të tjera. Nga viti 2017 e në vazhdim mjetet që mbesin brenda një kategorie nuk mund të ridestinohen, por mbesin suficit. Raporti i punës dhe Raporti financiar për vitin 2017 u miratuan pa vërejtje.

Kryesia vendosi të thërrasë mbledhjen XCIV të Kuvendit të Akademisë më 8 shkurt 2018, në orën 11:00, me këtë rend të ditës: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCIII të Kuvendit të Akademisë, miratimi i Raportit të punës të ASHAK-ut për vitin 2017, miratimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2017, miratimi i Planit strategjik gjithëpërfshirës të ASHAK-ut për vitet 2018-2021, çështje vijuese.

M. Limani në diskutimin e saj njoftoi Kryesinë se në fillim është menduar që strategjia gjithëpërfshirëse të hartohet për periudhën trevjeçare, por më pas Grupi punues gjatë punës e ka parë të

arsyeshme të hartojë planin strategjik për periudhën katërvjeçare.

Në vazhdim të mbledhjes Kryesia shqyrtoi kërkesën e akademik Mehmet Krajës, kryeredaktor i FEK, për kompensim të punëve shtesë për faqosjen e FEK. Kryetari Daci tha se caktimin e paushallit përkatës ta shqyrtojë Këshilli botues i ASHAK, pas vlerësimit të punëve të kryera dhe në mbledhjen e radhës të Kryesisë të merret vendimi përkatës.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia u njoftua me kërkesën e punonjësit z. Xhemshit Brajshori. U tha që kërkesa e tij të shqyrtohet nga Grupi për hartimin e planit strategjik të Akademisë dhe pas shqyrtimit të dokumenteve dhe fakteve, punonjësit në fjalë t'i kthehet përgjigjja.

Njëherësh kryetari Daci propozoi që Grupi përkatës të shqyrtojë Rregulloren aktuale për sistematizimin e vendeve të punës, ashtu që të shikohen mundësitë për përmirësimin apo ngritjen e koeficienteve për punonjësit e Administratës, meqë Akademia është institucion i veçantë dhe punonjësit duhet të kenë trajtim meritior.

3. Në mbledhjen III, e mbajtur më 12 mars, Kryesia u mor me një varg çështjesh:

- Shqyrtoi draftin e Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet ASHAK-ut dhe Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Kryetari Daci, njoftoi

Kryesinë se gjatë takimit me rektorin e UP-së, prof. dr. Marjan Demajn në mjediset e Akademisë është biseduar për bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet ASHAK-ut dhe UP-së. Më pas ai tha se M. Limani dhe F. Podvorica e kanë përgatitur draftin e Memorandumit për shqyrtim. Diskutuan L. Mulliqi, E. Basha, M. Limani dhe pas diskutimeve u tha që drafti i Memorandumit të lekturohet dhe t'i dërgohet rektorit të UP-së që edhe atje të shqyrtohet dhe më pas të vazhdojnë procedurat për nënshkrimin e tij;

- Shqyrtoi draftin e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH), 2019-2021. L. Pula e njoftoi Kryesinë se pas kërkesës së Ministrisë së Financave, e ka përgatitur draftin e KASH-it, bazuar në Programin vjetor të punës së Akademisë dhe në draft ka paraqitur dhe ka arsyetuar kërkesat për mjete financiare shtesë, ndërsa i duhet qëndrimi i Kryesisë për: implikimet financiare për Fjalorin Enciklopedik të Kosovës (FEK) dhe vazhdimin e punës së QLE-së. Në diskutimet e tyre M. Limani dhe F. Podvorica propozuan që të kërkohej më shumë mjete shtesë për shkak se mjetet e kërkuara nuk mund të mbulojnë të gjitha botimet dhe aktivitetet që dalin nga programet e punës për vitet 2019-2021. L. Pula sqaroi se çdo kërkesë për mjete shtesë duhet të ketë arsyetimin përkatës dhe në këtë fazë ASHAK-u nuk mund ta bëjë një gjë të tillë, sepse programi i punës miratohet në baza vjetore.

Më pas u diskutua për implikimet financiare për FEK-un dhe u tha se punët për projektin në fjalë kanë përfunduar, është marrë ISBN-ja dhe së shpejti pritet që Fjalori të dorëzohet për shtyp. Për vitet 2019-2021 nuk do të ketë implikime financiare. Ndërsa për projektin e QLE-së u tha se duhet të vazhdojë puna. Kryetari Daci propozoi që për këtë çështje E. Basha të bisedojë me akademik Rexhep Ismajlin, ashtu që të përgatitet një raport me shkrim në të cilin do të paraqiten dhe kërkesat përkatëse për vazhdimin e punëve. Propozimi u miratua nga të gjithë anëtarët e Kryesisë. Pas diskutimeve Kryesia e miratoi draftin e KASH-it me disa plotësime, si këto:

- Vendosi që z. Samir Haliti t'i paguhet paushalli në vlerë prej 500,00€ për punët shtesë të FEK-ut;

- Shqyrtoi shkresat e Seksionit të Arteve:

- a) Së pari u shqyrtua propozimi për prononcimin në medie për gjendjen e kulturës në Kosovë. Teksti i prononcimit u miratua dhe u tha që prononcimi në emër të ASHAK-ut, t'u dërgohet mediave,

- b) U shqyrtua edhe propozimi për botimin e Monografisë Muslim Mulliqi. Kryesia e miratoi propozimin në fjalë dhe u tha që Seksioni i Arteve t'ia paraqesë Kryesisë propozimin për caktimin e autorit të Monografisë dhe të merret me përgatitjet për botimin e saj.

- Mori vendim që të përgatitet për botim dorëshkrimi: "Lindja dhe fëmijëria e vështirë e shtetësisë së Kosovës", me autor Nexhat Dacin, në kuadër të shënimit të 10- vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe caktoi Anton K. Berishajn e anëtarin korrespondentë Gjyljeta Mushkolajn, recensentë për vlerësimin e dorëshkrimit në fjalë;

- Shqyrtoi përgjigjen e Grupit punues për hartimin planit strategjik të Akademisë për z. Xhemshir Brajshori. Diskutuan J. Bajraktari, L. Mulliqi, M. Limani, J. Pula, F. Podvorica dhe pas diskutimeve Kryesia e miratoi përgjigjen me konstatimin se z. Brajshori do të zbatojë vendimin e Kryesisë dhe do të kryejë punët e përcaktuara.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës të kësaj mbledhjeje, Kryesia mori vendim:

- a) Që znj. Nitë Krasniqi, asistente ekzekutive, autorizohet të nënshkruajë listat e pagave për anëtarët e Akademisë deri në kthimin e punonjësës znj. Dafina Kavaja nga pushimi prindëror, me qëllim që listat e pagave të procedohen me kohë dhe në afatin e paraparë;

- b) Miratoi raportet e udhëtimeve zyrtare:

- Raportin e anëtarit korrespondent Fetah Podvorica për qëndrimin e tij në Tiranë, me qëllim të pjesëmarrjes në

konferencën shkencore “Prurjet shkencore për kërkim e zhvillim të publikimet e revistës ”Journal of Natural and Technical Sciences” dhe përparësitë e hulumtimeve në të ardhmen, më 1 shkurt 2018;

- Raportin e akademik Jusuf Bajraktarit për qëndrimin e tij në Tiranë, me qëllim të pjesëmarrjes në takimin për zbatimin e pikave të Protokollit të bashkëpunimit ASHAK-ASHSH, 2018-2020, më 18-20 shkurt 2018;

- Raportin e anëtareve korrespondente Myzafer Limani dhe Justina Pula, si dhe znj. Lendita Pula për vizitën e tyre në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë në Lubjanë, më 27 shkurt deri më 1 mars 2018.

c) Diskutoi për gjendjen e objektit të ASHAK-ut. U tha se reshjet e fundit kanë shkaktuar shumë dëme në disa kabinete dhe hapësira të Akademisë, ka probleme me mirëmbajtjen e dyerve, të dritareve dhe niveli i pastërtisë ka rënë dukshëm. Kabineti ku janë të vendosur anëtarët korrespondentë: Salih Gashi, Qamil Haxhibeqiri dhe Arsim Morina është dëmtuar shumë dhe nuk ka kushte për punë. Kryetari Daci propozoi që F. Podvorica dhe L. Pula të ndërmarrin veprimet e nevojshme për sistemin urgjent të anëtarëve të lartpërmendur në kabinete të përshtatshme. Propozimi u miratua dhe Kryesia mori vendim për sistemin e anëtarëve të lartpërmendur në kabinete të përshtatshme të SSHN-së. Po ashtu u

tha që sa më parë të caktohet një takim me Ministrin e MAP-it, ku do të kërkohet marrja e masave urgjente për sanimin e gjendjes.

ç) U njoftua nga L. Pula se Vendimi për pagesat e të angazhuarve në projektin: “Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës (Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale)”, Qendrat urbane, ka pësuar dy ndryshime të vogla, të cilat janë miratuar nga kryetari Daci.

4. Në mbledhjen IV, mbajtur më 28 mars, Kryesia diskutoi për botimin e FEK-ut. Kryetari Daci e njoftoi Kryesinë se kanë përfunduar të gjitha punët për FEK-un dhe tani Kryesia do të marrë vendimin përfundimtar për botimin e tij. Ai kërkoi nga M. Limani që në cilësinë e Kryesueses së Këshillit botues të ASHAK-ut të njoftojë Kryesinë për rrjedhën e punës. M. Limani në diskutimin e saj njoftoi se Këshilli botues i ASHAK-ut ka mbajtur mbledhjen e rregullt dhe ka shqyrtuar të gjitha specifikimet teknike të FEK-ut, të paraqitura në formularët përkatës, të nënshkruar nga kryeredaktori akademik Mehmet Kraja. Këshilli botues i ka miratuar njëzëri shënimet e kryeredaktorit dhe i propozon Kryesisë që fjalori të miratohet për botim dhe tirazhi të jetë 1000 kopje. Kopjet e formularëve u janë bashkëlidhur këtij procesverballi.

Në diskutimin e tij L. Mulliqi edhe kësaj radhe shprehu qëndrimin që FEK-u të lëshohet për një kohë të caktuar në

formë elektronike në mënyrë që të kenë mundësi të korigjohen gabimet eventuale. Diskutuan më pas edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe u tha se punët për FEK-un tani më kanë përfunduar dhe se nuk ka kohë të shtyhet botimi.

Pas diskutimeve Kryesia mori vendim që të miratohet për botim FEK-u në 1000 kopje.

Kryesia shqyrtoi draftin e plotësuar të Planit strategjik gjithëpërfshirës të ASHAK-ut për vitet 2018-2021. Për rrjedhën e punës, për plotësimin e draftit të Planit strategjik, kryetari Daci ia kaloi fjalën M. Limanit, kryesuese e Grupit punues për hartimin e Planit strategjik gjithëpërfshirës 2018-2021. M. Limani e njoftoi Kryesinë se Grupi punues, pas mbledhjes së Kuvendit të Akademisë, me akt përcjellës iu ka dërguar edhe një herë draftin e Planit strategjik të gjithë anëtarëve të Akademisë për të dhënë vërejtjet dhe sugjerimet eventuale. Pas kalimit të afatit të paraparë, Grupi punues në punëtorinë e mbajtur në Durrës (15-18 mars) ka punuar në draftin e parë në të cilin i ka përfshirë të gjitha sugjerimet e dhëna në mbledhjen e Kuvendit dhe ato që kanë ardhur në ndërkohë nga anëtarët e Akademisë. Tani i mbetet Kryesisë të shqyrtojë draftin e plotësuar dhe të vendosë ta dërgojë për miratim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Akademisë. Në diskutimin e tij E. Basha paraqiti disa propozime të cilat tha se do t'i përpilojë me shkrim dhe do t'ia dërgojë Grupit punues. Me

këtë rast M. Limani e falënderoi E. Bashën për bashkëpunim dhe tha se çdo propozim deri në miratimin përfundimtar të Planit strategjik është i mirëseardhur dhe do të përfshihet në draft, meqë qëllimi është që Plani strategjik të jetë sa më i plotë.

Kryesia u pajtua që propozimet e E. Bashës të përfshihen në draft dhe më pas drafti t'i dërgohet për miratim Kuvendit të Akademisë.

Në kuadër të pikës IV të rendit të ditës: Njoftim për Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë për pagesën e borxhit ndaj Kompanisë Ujësjiellësi Rajonal “ Prishtina, kryetari Daci kërkoi nga L. Pula ta njoftojë më gjerësisht për çështjen në fjalë. L. Pula e njoftoi Kryesinë se në fillim të vitit 2016 ASHAK-u ka pranuar Urdhrin për caktimin e përmbarimit PNR. 89/1 të datës 22.1.2016, sipas Propozimit për Përmbarim të Kreditorit: Kompania Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina” sh.a., sipas dokumentit autentik - ekstraktit nga librat e kontabilitetit për një borxh . E gjithë kjo ka ndodhur në vitet 2002-2003 në objektin e vjetër të Akademisë. Pas pranimit të dokumentit të lartcekur, ASHAK-u menjëherë ka ndërmarrë veprimet konkrete. Janë realizuar takime me udhëheqës të Kompanisë Ujësjiellësi, por nuk ka pasur rezultate. Më pas sipas Ligjit është bërë prapësimi, por Gjykata Themelore në Prishtinë ka nxjerr Aktvendimin me të cilin refuzohet prapësimi nga ASHAK-u, me mundësi të parashtimit të ankesës në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Duke

marrë parasysh se ASHAK-u nuk ka pasur dëshmi me shkrim, por vetëm thuhet se në atë kohë janë marrë vesh me Kompaninë e Ujësjellësit gojarisht, nuk ka pasur bazë për vazhdim me ankesë në Gjykatën e Apelit dhe si përfundim ASHAK-u është dashur të tërhiqet nga ankesa dhe të deklarohet për pagimin e borxhit në vlerë prej 2.646,45 euro dhe shpenzimet e tjera sipas ligjeve përkatëse. Ajo më pas tha se për çështjen në fjalë është dashur të reagohej më shpejt me qëllim që vlera e borxhit mos të shtohet dhe njoftoi Kryesinë se borxhi i paguar ka arritur vlerën 3.163,96€, meqë janë shtuar edhe shpenzimet e tjera, sipas ligjeve përkatëse.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia:

a) Caktoi anëtar korrespondent Arsim Bajramin në vend të akademik Anton. K. Berishajt, recensent për vlerësimin e dorëshkrimit (monografisë): "Lindja dhe fëmijëria e vështirë e shtetësisë së Kosovës". Akademik Berishaj u lirua nga angazhimi i recensentit për shkak të obligimeve të shumta që i ka gjatë kësaj periudhe në Universitet;

b) U njoftua nga L. Pula për ftesën që i ka arritur ASHAK-ut për pjesëmarrje në Panairin e Librit në Shkup. L. Pula e njoftoi Kryesinë se pagesat e shpenzimeve për panairin bëhen nga kodi Shërbime kontraktuese dhe se mjetet financiare janë planifikuar. Por duke qenë se në mbledhjen e fundit të Kryesisë u diskutua çështja e

angazhimit të një punonjësi në QLE, L. Pula sqaroi se pagesa për punonjësin në fjalë duhet të realizohet nga i njëjti kod dhe nëse realizohet pjesëmarrja në panair nuk mbesin mjete financiare për angazhimin e punonjësit në QLE për arsye se në fund të vitit 2017 Kryesia nuk ka marrë vendim për vazhdimin e punës në QLE.

Diskutuan N. Daci, E. Basha, M. Limani dhe pas diskutimeve u tha se, meqë deri më tani nuk ka kërkesë nga Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, për QLE-në ASHAK-u të marrë pjesë në Panairin e Librit në Shkup dhe me rishikim të buxhetit të kërkohej mjete financiare shtesë për pagesën e një apo më shumë punonjësve në QLE;

c) U njoftua nga L. Pula se Autoriteti Qendror i Prokurimit (AQP) është duke përgatitur tenderin për shtypjen e librave, që e obligon edhe ASHAK-un, të shfrytëzojë kontratën e tyre. Ajo më pas tha se e ndjen për obligim të njoftojë Kryesinë për çështjen në fjalë, meqë duke marrë parasysh specifikat e librave të ASHAK-ut mund të ketë probleme në kualitetin e librave që shtypen. Më pas diskutuan me radhë të gjithë anëtarët e Kryesisë dhe pas diskutimeve u tha që ASHAK-u t'i drejtohet me shkrim AQP-së dhe të kërkojë nga ata që, brenda mundësive ligjore, të mos e përfshijnë ASHAK-un në prokurimin qendror të shtypjes së librave;

ç) U njoftua nga kryetari Daci për ftesën e International Human Rights Network;

U tha që ftesa t'i dërgohet për shqyrtim Komisionit për marrëdhënie ndërkombëtare të ASHAK-ut, i cili do të caktojë edhe përfaqësuesin e tij;

d) Miratoi këto raporte të udhëtimeve zyrtare:

- Raportin e akademik Jusuf Bajraktarit dhe anëtarit korrespondent Frashër Demaj për qëndrimin e tyre në Tiranë, me qëllim të pjesëmarrjes në mbledhjen e parë të Sekretariatit teknik dhe të konstituimit të Komitetit Shkencor për përgatitjen e Konferencës Albanologjike kushtuar Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, më 1-2 mars 2018;

- Raportin e delegacionit të ASHAK-ut për qëndrimin e tyre në Tiranë, me ftesë të ASHSH-së, me qëllim të pjesëmarrjes në takimet në kuadër të bashkëpunimit ASHAK-ASHSH, më 8-11 mars 2018;

- Raportin e akademik Jusuf Bajraktarit dhe anëtarit korrespondent Frashër Demaj për qëndrimin e tyre në Tiranë, me qëllim të pjesëmarrjes në mbledhjen e dytë të Sekretariatit teknik dhe të konstituimit të Komitetit Shkencor për përgatitjen e Konferencës Albanologjike kushtuar Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, më 8-9 mars 2018;

- Raportin e akademik Jusuf Bajraktarit, akademik Rexhep Ismajlit dhe anëtarit

korrespondent Frashër Demaj për qëndrimin e tyre në Tiranë, me qëllim të pjesëmarrjes në mbledhjen e tretë të Sekretariatit teknik dhe të konstituimit të Komitetit Shkencor për përgatitjen e Konferencës Albanologjike kushtuar Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, më 15-16 mars 2018.

5. Në mbledhjen V të datës 18 prill, si zakonisht pas miratimit të procesverbalit, Kryesia shqyrtoi recensionin për vlerësimin e dorëshkrimit "Lindja e vështirë e shtetësisë së Kosovës". J. Bajraktari tha se recensionin e ka punuar mirë, por propozoi të bëhen disa plotësime në mënyrë që recensionin të përgatitur të jetë sipas standardeve të ASHAK-ut, që ka të bëjë me pjesën hyrëse dhe atë përfundimtare. Propozimi u miratua dhe Kryesia njëzëri miratoi për botim dorëshkrimin në fjalë në bazë të recensioneve pozitive të anëtarëve korrespondentë Arsim Bajrami dhe Gjyljeta Mushkolaj. U tha që dorëshkrimi të dorëzohet për shtyp;

Kryesia në vazhdim diskutoi për rrjedhën e veprimtarisë botuese të Akademisë për këtë vit. Kryetari Daci njoftoi se edhe këtë vit gjendja financiare nuk është e mirë. Ka shumë dorëshkrime të gatshme dhe të tjera që priten të dorëzohen gjatë vitit, por nuk ka mjete financiare të mjaftueshme. Ai tha se me rishikim të buxhetit do të kërkojmë mjete shtesë dhe kërkoi nga sekretarët e seksioneve t'i bëjnë gati kërkesat me shkrim dhe me arsyetime të qëndrueshme për seksionet e tyre

dhe më pas kërkesat t'i dërgohen Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës, kur të bëhet rishikimi i buxhetit. Kryetari Daci apeloi te sekretarët e seksioneve që të përcjellin rrjedhën e veprimtarisë botuese në seksionet përkatëse, ashtu që të gjitha librat të përgatiten dhe të shtypen sipas standardeve të përcaktuara me aktet normative të Akademisë dhe gjithnjë sipas vendimeve të Këshillit botues të ASHAK-ut. Diskutuan me radhë të gjithë anëtarët e Kryesisë dhe u tha se mungesa e mjeteve financiare vitin e kaluar ka bërë që shumë botime dhe projekte të barten për këtë vit, prandaj duhet të bëhen përpjekje të kërkojnë mjete financiare shtesë në mënyrë që të përmbushet plani i botimeve. Kryetari Daci diskutoi edhe për botimin e librit Muslim Mulliqi - Monografi. Ai kërkoi nga L. Mulliqi ta njoftojë Kryesinë se deri ku kanë arritur punët për përgatitjen e Monografisë. L. Mulliqi e njoftoi Kryesinë se ka biseduar dhe ka kontaktuar me familjen e akademik Muslim Mulliqit dhe janë pajtuar të hartojnë dhe të nënshkruajnë marrëveshje reciproke ku do të përcaktohen obligimet e secilës palë. Ai më pas tha se për këtë e ka njoftuar sekretaren e Akademisë dhe se ajo e ka përgatitur një draft të marrëveshjes. Më pas L. Pula ua ndau të gjithë anëtarëve të Kryesisë kopjen e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet ASHAK-ut dhe familjes së Muslim Mulliqit, që e përfaqëson bashkëshortja, znj. Resmije Mulliqi. Pas leximit të draftit të Marrëveshjes në fjalë, Kryesia u pajtua me pikat e paraqitura. U tha se marrëveshja duhet

të nënshkruhet pa ndryshime, por vetëm duhet të plotësohet me emrin e autorit.

Kryesia pas diskutimeve vendosi që në këtë fazë në shtyp të shkojnë dorëshkrimet: "Lindja e vështirë e shtetësisë së Kosovës" (meqë lidhet me këtë vit jubilar), "Muslim Mulliqi-Monografi" dhe periodikët, ndërsa dorëshkrimet e tjera të presin deri në marrjen e një vendimi të ri, pas rishikimit të buxhetit.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, kryetari Daci njoftoi se është koha që sekretarët e seksioneve të fillojnë përgatitjet për Programin e punës së Akademisë për vitin 2019. Ai tha se deri në fillim të qershorit do të ishte mirë të përfundojnë mbledhjet e seksioneve për Programin e punës. Këtë vit duhet të zbatojmë Rregulloren për veprimtarinë botuese dhe të miratohen vetëm dorëshkrimet e gatshme. Kjo gjë duhet të respektohet domosdoshmërisht. Pra, në Kuvendin e Akademisë do të miratohen vetëm dorëshkrimet e gatshme.

6. Në mbledhjen VI, mbajtur më 23 maj, Kryesia u njoftua me Qarkoren e parë buxhetore (kufijtë e lejuar buxhetor 2019-2021). L. Pula njoftoi Kryesinë se buxheti i lejuar për vitet 2019-2021 është i njëjtë dhe se Qarkorja duhet të hartohet duke iu përmbajtur kufijve të caktuar. Ajo më pas tha se jashtë kufijve mund të paraqiten kërkesa të veçanta me arsyetime përkatëse. Kryetari Daci më

pas propozoi që sekretarja shkencore, bashkë me sekretarët e seksioneve të punojnë në shpërndarjen e buxhetit nëpër kode përkatëse, sipas Qarkores së parë buxhetore 2019-2021 dhe më pas dokumentin e plotësuar. Sekretarja e Akademisë në bashkëpunim me Departamentin e buxhetit dhe të financave ta finalizojnë për ta dorëzuar në Ministrinë e Financave. Ai po ashtu tha se sekretarët e seksioneve t'i përgatisin kërkesat për mjete shtesë, me arsyetimet përkatëse për vitin 2019. M. Limani në diskutimin e saj tha se pajtohet me propozimin e kryetarit meqë në mbledhjen e fundit të Kryesisë është marrë qëndrim që mbledhjet e seksioneve për miratimin e programeve të punës të përfundojnë në fillim të qershorit, propozoi që së pari të mbahen mbledhjet e seksioneve dhe më pas ajo bashkë me sekretarët e seksioneve të mbledhen më së largu deri më 8 qershor për të punuar në hartimin e dokumentit përkatës në mënyrë që i njëjti të paraqitet për miratim në mbledhjen e radhës të Kryesisë deri më 13 qershor.

Kryesia më pas shqyrtoi këto rregullore: Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe Rregulloren për rendin shtëpiak në ndërtesën e ASHAK-ut. E. Basha në diskutimin e tij tha se materialet janë ndarë me vonesë dhe se nuk ka pasur kohë t'i lexojë, por kryetari Daci dhe M. Limani thanë se rregulloret janë hartuar kohë më parë, janë lexuar dhe përpunuar edhe në Punëtorinë e mbajtur në Durrës, por nëse E. Basha ka ndonjë plotësim mund

t'ia dërgojë me shkrim L. Pulës. E.

Basha u pajtua me propozimin e dhënë dhe tha se nëse ka ndonjë sugjerim do t'ia dërgojë L. Pulës.

Gjatë shqyrtimit të Rregullores për rendin shtëpiak në ndërtesën e ASHAK-ut, kryetari Daci lidhur me nenin 16 për veshjen dhe paraqitjen e punonjësve tha se për vitin 2019 të planifikohen mjetet në mënyrë që të pajisen me uniformë zyrtare këta punonjës: Vozitësi, punonjësi në Librari/reception dhe punëtori teknik.

Pas diskutimeve Kryesia njëzëri miratoi rregulloret e lartcekura.

Kryesia, në kuadër të kësaj mbledhjeje, diskutoi për rrjedhën e punës të shtypjes së Fjalorit enciklopedik të Kosovës (FEK) dhe kryetari Daci ia kaloi fjalën M. Limanit për të dhënë sqarimet e nevojshme.

M. Limani njoftoi se më 19 prill ASHAK-u e ka dërguar në shtyp FEK-un. Pas pranimit të kopjes së parë, me sugjerim të kryeredaktorit akademik Mehmet Kraja, është kërkuar të ndërpritet shtypi dhe po atë ditë përmes telefonit është njoftuar menjëherë shtypshkronja që ta ndërpresë punën. Kërkesa për ndërprerjen e punës ka rrjedhur për shkak të disa gabimeve jo në përmbajtje, por për disa çështje teknike të librit. Kjo çështje më pas është diskutuar brenda Akademisë me strukturat drejtuese dhe më 14 maj është mbajtur mbledhja e Këshillit botues të ASHAK-ut në cilën është

shqyrtuar çështja në fjalë. Në mbledhje është propozuar që një delegacion prej tre vetash (Myzafere Limani, Mehmet Kraja dhe Lendita Pula) të realizojnë takim me përfaqësuesit e shtypshkronjës “Focus Print” në Shkup. Delegacioni ka qëndruar në Shkup më 18 maj 2018 dhe pas takimit me përfaqësuesin e shtypshkronjës në fjalë janë sqaruar të gjitha paqartësitë. Delegacioni në Shkup ka parë për së afërmi versionin e përpunuar të FEK-ut dhe janë pajtuar me të gjitha ndryshimet teknike. Delegacioni ka marrë qëndrim që puna të vazhdojë.

Në vazhdim Kryesia shqyrtoi shkresën për pagesat e Antologjisë Poetët akademikë. Kryesia vendosi të paguhen paushallët për dizajnin dhe faqosjen e botimit shqip të Antologjisë Poetët akademikë, i realizuar në kuadër të Marrëveshjes së bashkëpunimit ASHAK-ASHAM, si në vijim:

1.Koço Fidanovskit i paguhet paushalli në vlerë prej 200,00 € bruto dhe

2.Bane Galiqit i paguhet paushalli në vlerë prej 200.00 € bruto.

Po ashtu u tha se duhet të realizohen edhe pagesat e tjera sipas shënimeve të koordinatorit të projektit në fjalë E. Basha dhe në përputhje me Rregulloren për honorarët e veprimtarisë botuese të ASHAK-ut.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës:

a) Kryetari Daci diskutoi për çështjen e Shënimi të aktiviteteve shkencore: Viti i Gjergj Kastriotit - Skënderbeut dhe 140-vjetori i Lidhjes së Prizrenit. - Raporti ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ASHAK-ut. Ai paraqiti para Kryesisë shkresën e dërguar në ASHAK nga Zyra e Kryeministrit dhe shkresën që më pas nënkryetari i Akademisë akademik Jusuf Bajraktari ia ka dërguar Zyrës së Kryeministrit. Ai shprehu shqetësim për mënyrën e komunikimit dhe kërkoi që një gjë e tillë të mos përsëritet. Kryetari Daci tha se Akademinë e përfaqëson kryetari i saj, ndërsa kur ka raste të tilla ato duhet të diskutohen në mbledhje të Kryesisë dhe aty merren vendimet. J. Bajraktari në diskutimin e tij tha se e gjithë rrjedha e komunikimit është e pasqyruar në letrën e tij. Ai tha se kërkesa e tij në takimin që ka pasur në Qeveri ka pasur për qëllim që ASHAK-u të respektohet si institucioni më i lartë i shkencës dhe i artit dhe logoja e tij të jetë e para dhe jo siç ka vepruar Qeveria, duke e vendosur Institutin e Historisë para ASHAK-ut. Kryetari Daci më pas tha se ai do t'i drejtohet me kërkesë zyrtare Kryeministrit të Republikës së Kosovës që ta vendosë ASHAK-un aty ku i takon si institucion. Ai po ashtu tha se do të jetë mirë që aktivitetet e lartpërmendura të realizohen bashkë me Qeverinë.

b) Kryesia miratoi këto raporte të udhëtimeve zyrtare:

- Raportin e punëtorisë së Grupit punues për hartimin e dokumenteve që

dalin nga Plani strategjik gjithëpërfshirës të mbajtur në Durrës më 15-18 mars 2018;

- Raportin e punëtorisë së Kryesisë së Akademisë dhe Grupit punues për hartimin e dokumenteve që dalin nga Plani strategjik gjithëpërfshirës të mbajtur në Durrës më 3-6 maj 2018;

- Raportin e drejtorit të Departamentit të Bibliotekës dhe Arkivit për qëndrimin në Shkup, me qëllim të pjesëmarrjes në Panairin e 30-të Ndërkombëtar të Librit “Shkupi 2018” më 3-9 maj 2018 dhe

- Raportin e akademikëve Jusuf Bajraktari, Hivzi Islami dhe anëtarit korrespondent Frashër Demaj për qëndrimin e tyre në Tiranë më 20-21 maj 2018.

c) Kryesia vendosi të mbahet punëtorja për punonjësit e Shërbimit profesional, administrativ e teknik (SHPAT) të ASHAK-ut më 30 maj -2 qershor 2018 në Tiranë;

ç) L. Pula njoftoi Kryesinë me planin e shfrytëzimit të pushimeve vjetore . Ajo tha se pjesa më e madhe e stafit do të shkojnë në pushim vjetor gjatë muajit gusht, meqë në këtë kohë aktivitetet në Akademi janë më të pakta. Për shkak të numrit të vogël të stafit, si dhe mbajtjes së rregullit të bufësë, ajo propozoi që gjatë muajit gusht bufeja të mbyllet. Propozimi u përkrah nga Kryesia.

Njëherësh në kuadër të po kësaj pike të rendit të ditës kryetari Daci kërkoi që të gjithë anëtarët e Akademisë t'i respektojnë rregulloret e ASHAK-ut, si dhe procedurat administrative lidhur me udhëtimet zyrtare. Kërkesat për udhëtime zyrtare të paraqiten me kohë, në të kundërtën mund të vjen deri te anulimi i udhëtimit zyrtar. Po ashtu ai tha se, meqë ASHAK-u e ka vetëm një vozitës dhe ai duhet të jetë prezent në Akademi gjatë orarit të punës, udhëtimet e tjera të organizohen me taksi apo me vetura private. Ata që udhëtojnë me vetura private të paraqesin faturën e karburantit të shpenzuar, që t'iu bëhet kompensimi. Veturat e Akademisë nuk bën të përdoren nga askush tjetër pa leje paraprake.

7. Në mbledhjen VII të datës 13 qershor, Kryesia shqyrtoi dhe diskutoi për çështjet si në vijim:

- Shqyrtoi draftin e shpërndarjes së buxhetit për shpenzim sipas Qarkores së parë buxhetore 2019-2021. U tha që shpërndarja e buxhetit për vitin 2019 nuk mund të ketë shumë ndryshime nga viti 2018, meqë buxheti është i njëjtë. Diskutuan me radhë të gjithë anëtarët e Kryesisë dhe pas diskutimeve u tha që sekretarja e Akademisë bashkë me Departamentin për buxhet dhe financa të hartojnë draftin e fundit të shpërndarjes së buxhetit dhe kërkesën për mjete shtesë. Këto dokumente më pas t'iu dërgohet të gjithë anëtarëve të Kryesisë përmes postës elektronike dhe

nëse ka propozime eventuale, ato të përfshihen në draft dhe në kërkesë. Më pas dokumentet finale të dërgohen sipas procedurave përkatëse në Ministrinë e Financave të Republikës së Kosovës;

- Shqyrtoi Programin e punës të ASHAK-ut për vitin 2019, me radhë sipas seksioneve. Gjatë shqyrtimit të Programit të punës të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë(SGJL), kryetari Daci tha se Programi ka mjaft propozime, ndërsa të gjithë jemi në dijeni se buxheti i ASHAK-ut nuk mund t'i mbulojë të gjitha. Ai kërkoi nga E. Basha që Seksioni i GJL, ta ndryshojnë qasjen dhe të caktojë prioritetet, meqë ka vite që prin me propozime dhe tani është koha që edhe seksionet e tjera të realizojnë propozimet e tyre. Më pas u shqyrtuan me radhë edhe programet e punës së seksioneve të tjera të ASHAK-ut. Diskutuan të gjithë anëtarët e Kryesisë dhe u tha që të bëhen disa plotësime në mënyrë që të hiqen vlerat financiare të projekteve dhe të plotësohet programi i punës së Seksionit të Arteve me arsyeime përkatëse;

- Vendosi të thërrasë mbledhjen XCV të Kuvendit të Akademisë më 28 qershor 2018, në orën 11:00 dhe caktoi këtë rend të ditës: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCIV të Kuvendit të Akademisë, miratimi i Programit të punës të ASHAK-ut për vitin 2019, miratimi i Planit strategjik gjithëpërfshirës për vitet 2018-2021, miratimi i rregulloreve si: Rregullorja

për organizimin e koncerteve, Rregullorja për organizimin e ekspozitave, Rregullorja për udhëtimet zyrtare dhe Rregullorja për përdorimin e veturave zyrtare dhe çështje vijuese;

- Shqyrtoi raportin dhe kërkesën e akademik Mehmet Krajës, kryeredaktor i Fjalorit enciklopedik të Kosovës. U tha që kërkesa në fjalë t'i dërgohet për shqyrtim Këshillit botues të ASHAK-u dhe më pas Këshilli t'i propozojë Kryesisë miratimin e kërkesës dhe vlerën e paushallit.

Kryesia po ashtu vendosi të paguhen paushallët për udhëheqësin artistik dhe anëtarët e orkestrit të interpretimit të pikës artistike "Marshi i bashkimit" në Konferencën shkencore ndërkombëtare "Lidhja shqiptare e Prizrenit" (140 vjet mbas)", si më poshtë:

1. Zeqirja Ballata - udhëheqës artistik, 150 €
2. Enkelejda Zajmi Gorani, 70 €
3. Besa Ahmeti, 70 €
4. Astrit Mustafa, 70 €
5. Bledar Bujupi, 70 €
6. Avni Krasniqi, 70 €
7. Albin Abazi, 70 €
8. Meriton Ferizi, 70 €

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia shqyrtoi:

a) Raportin e punës së Bibliotekës së ASHAK-ut. Kryetari Daci tha se propozimet e paraqitura në raport duhet të analizohen mirë. Ç'do gjë

duhet të bëhet në koordinim me Ministrinë e Administratës Publike dhe me vendim të Kryesisë;

b) Miratoi këto raporte të udhëtimeve zyrtare:

- Raportin e akademik Rexhep Ismajlit për qëndrimin e tij në Akademinë e Shkencave të Austrisë në Vjenë më 23 prill-23 maj 2018;

- Raportin e delegacionit të ASHAK-ut (anëtares korrespondente Myzafere Limani, akademik Mehmet Krajës dhe znj. Lendita Pula) për qëndrimin e tyre në Shkup më 18 maj 2018;

- Raportin e akademik Rexhep Ismajlit për qëndrimin e tij në Tiranë më 24-25 maj 2018 me qëllim të pjesëmarrjes në ligjëratat e organizuara nga ASHSH në kuadër të vitit jubilar për Skënderbeun dhe pjesëmarrjes në homazhe me rastin e vdekjes së akademik Koleç Topalli;

- Raportin e Punëtorisë të organizuar për punonjësit e Shërbimit Profesional, Administrativ e Teknik të ASHAK-ut në Tiranë më 30 maj - 2 qershor 2018.

c) U njoftua me raportin e mbajtjes së Konferencës shkencore ndërkombëtare "Lidhja e Prizrenit (140 vjet mbas);

ç) Shqyrtoi dhe e miratoi kërkesën e Këshillit organizativ të Simpoziumit shkencor ndërkombëtar "Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit"

për realizimin e pagesës për anëtarin korrespondent Gjyljeta Mushkolaj;

d) Shqyrtoi dhe i miratoi kërkesat e Seksionit të Shkencave Shoqërore (M. Kullashit dhe J. Pulës) për kompensimin e biletave të aeroplanit për mysafirët që do të marrin pjesë në dy aktivitete shkencore të Akademisë, përkatësisht SSHSH-së;

dh) Diskutoi edhe kësaj radhe për përditësimin e faqes ueb të ASHAK-ut. Justina Pula në diskutimin e saj tha se faqja ueb e ASHAK-ut nuk po përditësohet fare; prej fillimit të vitit 2018 e deri më tani ka pasur shumë aktivitete, vizita të rëndësishme të kryetarit dhe të anëtarëve të Akademisë jashtë vendit, disa anëtarë të Akademisë kanë mbajtur edhe ligjërata të rëndësishme jashtë vendit, ka edhe ngjarje të tjera që kanë ndodhur, por fatkeqësisht faqja ueb mbetet e varfër me informacione. Po ashtu edhe te pjesa e botimeve kanë mbetur shënimet e vjetra. Me diskutimin e J. Pulës u pajtuan të gjithë anëtarët e Kryesisë. U tha se nëse me Ligjin e buxhetit për vitin 2019 miratohen pozitat e reja, ashtu siç është kërkuar, menjëherë të fillojnë procedurat për angazhimin e një punonjësi për ueb faqen. Ndërsa derisa nuk realizohet kjo, të angazhohet një punonjës nga Administrata i cili do të koordinojë punën ndërmjet sekretarëve të seksioneve dhe Redaksisë së faqes ueb të ASHAK-ut. U tha që Kryesia e ngushtë të caktojë punonjës in që do të kryejë punët në

fjalë deri në pranimin e një punonjësi të ri;

e) Vendosi që z. Xhemshit Brajshori të zhvendoset në zyrën 308, meqë tani atij i është lëshuar Aktemërimi i ri (sipas Rregullores për organizimin e brendshëm të ASHAK-ut), të cilin e ka pranuar dhe e ka nënshkruar brenda afateve ligjore dhe më nuk është pjesë e Departamentit të përkrahjes profesionale dhe teknologjisë së informacionit.

8. Në mbledhjen VIII të Kryesisë të datës 5 shtator, Kryesia i shqyrtoi edhe një herë rregulloret: Rregulloren për organizimin e koncerteve, Rregulloren për organizimin e ekspozitave, Rregulloren për udhëtimet zyrtare dhe Rregulloren për përdorimin e veturave zyrtare. L. Pula e njoftoi Kryesinë se në mbledhjen e Kuvendit të Akademisë (28 qershor), Rregullorja për organizimin e koncerteve dhe Rregullorja për organizimin e ekspozitave janë miratuar pa vërejtje. Rregullorja për udhëtimet zyrtare është miratuar, por është propozuar që neni 3, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 të rishikohet. Po ashtu edhe Rregullorja për përdorimin e veturave zyrtare është miratuar me propozimin që neni 2, paragrafi 1 të rishikohet.

Diskutuan shumica e anëtarëve të Kryesisë dhe u vendos që Rregullorja për udhëtimet zyrtare të plotësohet sipas propozimit të paraqitur në Kuvend dhe bashkë me rregulloret e tjera Rregullorja për përdorimin e

veturave zyrtare, Rregullorja për organizimin e koncerteve dhe Rregullorja për organizimin e ekspozitave të nënshkruhen sot. Ato hyjnë në fuqi 8 ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i Akademisë, pra më 13 shtator 2018.

Njëherësh Kryesia vendosi që Plani strategjik gjithëpërfshirës i miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Akademisë të redaktohet nga E. Basha para se të publikohet në faqen ueb të ASHAK-ut.

Në vazhdim Kryesia shqyrtoi shkresën e Redaksisë Qendrore të Fjalorit enciklopedik të Kosovës për pagimin e honorarit për akademik Mehmet Krajën, për punët e kryera në cilësinë e redaktorit përgjegjës të FEK.

Diskutuan me radhë të gjithë anëtarët e Kryesisë. Kryetari Daci tha se M. Kraja ka bërë punë të jashtëzakonshme, por kjo Kryesi nuk mund të marrë vendim dhe të caktojë vlerë të honorarit për punët në cilësinë e redaktorit përgjegjës, meqë nuk ka vendim për angazhimin e M. Krajës si redaktor përgjegjës. J. Bajraktari po ashtu lavdëroi M. Krajën për punën e bërë, por siç tha ai në asnjë vendim të organeve kompetente nuk figuron angazhimi i M. Krajës si redaktor përgjegjës dhe se në vendimet që janë marrë për të angazhuarit të FEK-ut shkruan se “Personat me më shumë angazhime në Enciklopedi do të paguhen vetëm për njërin prej tyre”. M. Limani sqaroi rrjedhën e shqyrtimit të kërkesës së M. Krajës, duke thënë se

sipas rekomandimit të Kryesisë, Këshilli botues në mbledhje të rregullt e ka shqyrtuar me kujdes raportin e M. Krajës për punët e kryera në cilësinë e redaktorit përgjegjës të Fjalorit enciklopedik të Kosovës (FEK) dhe kërkesën për kompensimin e honorarit përkatës. Këshilli botues po ashtu i ka shqyrtuar të gjitha vendimet e Kryesisë dhe dokumentet e tjera që nga fillimi i punës për FEK dhe meqë nuk ka gjetur vendim për caktimin e M. Krajës në pozitën e redaktorit përgjegjës dhe duke marrë parasysh se shumica e anëtarëve të Këshillit botues nuk kanë qenë pjesë e Akademisë në kohën kur janë marrë vendimet për FEK i është drejtuar me shkrim Redaksisë Qendrore të FEK-ut për të marrë sqarime shtesë. Ajo tha se Redaksia Qendrore e ka dhënë arsyetimin, të cilin e kemi të gjithë sot në materialet e mbledhjes.

L. Mulliqi në diskutimin e tij tha se M. Kraja ka bërë punë të madhe dhe të vlefshme, mungesa e një vendimi është pasojë nga e kaluara dhe sot kjo Kryesi nuk ka bazë për ta miratuar kërkesën në fjalë. Ai apeloj që tani e tutje të jemi më të kujdesshëm në marrjen e vendimeve që kanë implikime financiare. E. Basha sqaroi për punën që M. Kraja ka bërë, duke thënë se ai ka filluar si kryeredaktor, por gjatë rrugës është paraqitur nevoja për kryerjen e punëve edhe në cilësinë e redaktorit përgjegjës dhe se këtë e ka vërtetuar edhe Redaksia Qendrore në shkresën e saj. Ai propozoi që kjo çështje të rishikohet duke e analizuar punën e bërë.

Kryesia pas diskutimeve vendosi të refuzojë kërkesën në fjalë, me arsyetimin se nuk ka vendim për angazhimin e M. Krajës në cilësinë e redaktorit përgjegjës të FEK-ut dhe se kjo pozitë nuk ka qenë e paraparë në strukturën organizative të FEK-ut.

Në vazhdim të mbledhjes, Kryesia e caktoi datën e promovimit të Fjalorit enciklopedik të Kosovës më 25 shtator 2018. U tha që të fillojnë përgatitjet për hartimin e listës së personave që duhet të ftohen në ceremoninë e promovimit dhe të hartohet lista e institucioneve dhe individëve të cilëve do t’iu dhurohet nga një kopje e FEK-ut.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia:

a) Miratoi propozimin e Këshilli botues të ASHAK-ut dhe mori vendim që në mbështetje të Rregullores për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese të ASHAK-ut, neni 4, z. Valbon Bytyqi në cilësinë e dizajnerit të botimit “Vendbanimet e Kosovës - qendrat urbane”, vëllimi I, t’i paguhet paushalli në vlerë prej 600,00€;

b) Miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të akademik Jusuf Bajraktarit me bashkëpunëtorë (akademik Hivzi Islamit dhe anëtarit korrespondent Frashër Demajt) për qëndrimin e tyre në Tiranë më 20-22 qershor 2018;

c) Miratoi raportin e L. Pulës, V. Hykollit, H. Maliqit dhe F. Nakës për

qëndrimin e tyre në Tiranë në ASHSH më 28-30 qershor;

ç) Shqyrtoi njoftimin e akademik Rexhep Ismajlit për udhëtimin e tij në SHBA me qëllim të pjesëmarrjes në takimin solemn të organizuar nga Akademia Amerikane e Arteve dhe e Shkencave, me rastin e zgjedhjes së tij anëtar i jashtëm i nderit i saj. Diskutuan të gjithë anëtarët e pranishëm dhe që të gjithë u shprehën se anëtarësimi i akademik Ismajlit në Akademinë Amerikane të Arteve dhe të Shkencave i bën nder Akademisë sonë. L. Mulliqi në diskutimin e tij tha se pjesëmarrja e anëtarëve të Akademisë në ngjarje jashtë vendit duhet të përkrahet, meqë kjo ndihmon në hapjen e Akademisë. Më pas njëzëri u vendos që akademik Ismajlit t'i mbulohen të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit nga ASHAK-u;

d) L. Pula njoftoi Kryesinë se nga departamentet ka pranuar raportet për menaxhimin e rrezikut dhe deri më tani nuk ka pasur rreziqe.

dh) Shqyrtoi kërkesën e z. Alban Bytyçi, shofer-korrier. L. Pula sqaroi se kërkesa është paraqitur sot pak para fillimit të mbledhjes. Ajo e paraqiti para Kryesisë Qarkoren Administrative nr. 01/2014 të Ministrisë së Administratës Publike të Republikës së Kosovës, të cilën duhet ta zbatojnë të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Kryetari Daci kërkoj që sekretarja shkencore të shqyrtojë edhe një herë

dokumentacionin dhe z. Bytyçi t'i kthehet përgjigje me shkrim.

Njëherësh në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës L. Mulliqi propozoi që të gjitha komisionet e ASHAK-ut t'i raportojnë çdo gjashtë muaj Kryesisë për aktivitetet e tyre dhe kryetari Daci kërkoj të lidhet marrëveshje me kompani të shërbimeve të transportit (taxi), kështu që në rast nevojë ASHAK-u të ketë zgjidhjen e duhur.

9. Në mbledhjen IX të mbajtur më 19 tetor, Kryesia shqyrtoi draftin e shpërndarjes së buxhetit për shpenzim sipas Qarkores së dytë buxhetore për vitet 2019-2021. L. Pula njoftoi se shpërndarja e buxhetit sipas Qarkores së dytë ka disa ndryshime nga ajo e para, meqë janë miratuar mjetet në vlerë financiare prej 20.000,00 € për kategorinë mallra dhe shërbime dhe tri pozita të reja pune. Ajo po ashtu njoftoi se në kategorinë shpenzime kapitale janë miratuar mjetet në vlerë prej 62.000,00€. Kjo vlerë e mjeteve financiare figuron edhe për vitet 2020 dhe 2021 (edhe pse nga ASHAK-u nuk janë kërkuar për vitet 2020 dhe 2021), por tani për tani janë shënime preliminare që mund të ndryshojnë. Ajo më pas njoftoi se në draft është përfshirë edhe kërkesa e Komisionit për blerjen e veprave artistike, pas miratimit përmes postës elektronike nga Kryesia e Akademisë.

Diskutuan me radhë të gjithë anëtarët e Kryesisë dhe Shpërndarja e buxhetit

sipas Qarkores së dytë buxhetore për vitet 2019-2021 u miratua njëzëri.

10. Mbledhja X u mbajt më 24 tetor. Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia shqyrtoi kërkesën e Gazetës Infokusi për lejimin e qasjes në dokumente publike për çështjet financiare lidhur më Fjalorin enciklopedik të Kosovës. Kryetari Daci në diskutimin e tij theksoi se kohëve të fundit ka reagime dhe shkrime nga më të ndryshmet për FEK-un. Për Fjalorin është punuar me shumë mund dhe përkushtim dhe Akademia nuk mund të lejojë që të njolloset puna e bërë. Ai po ashtu tha se nuk mund t'u jepen dokumente dikujt pa e ditur se kush janë, çfarë qëllimi kanë dhe se ato mund të keqpërdoren. Raportet vjetore të punës së Akademisë janë transparente, të paraqitura në revistën Vjetari, e cila është e publikuar në faqen ueb të ASHAK-ut. Ai më pas kërkoi nga L. Pula të njoftojë për rrjedhën e kërkesës në fjalë. L. Pula e njoftoi Kryesinë se kërkesa ka ardhur në adresën e ASHAK-ut në formë elektronike dhe sipas Ligjit në fuqi për qasje në dokumente publike të drejtë për qasje në dokumente publike ka çdo person fizik dhe juridik. Ajo po ashtu njoftoi se sot është afati i fundit ligjor t'i kthehet përgjigje kërkuarit, në të kundërtën ai e rezervon të drejtën për paraqitjen e ankesës në institucionet e parapara me Ligjin përkatës. M. Limani në diskutimin e saj propozoi që zyrtari për qasje në dokumente publike të kërkojë nga Gazeta Infokus të identifikohet, duke e paraqitur certifikatën e biznesit, emrin e pronarit, nr. e letërnjoftimit të tij, si

dhe të paraqesë kërkesë zyrtare të protokolluar dhe të vulosur. Propozimi u përkrah në parim nga të gjithë anëtarët e Kryesisë, por L. Mulliqi shprehu shqetësimin e tij se me kaq mund të marrë fund kjo çështje! Më pas Kryetari Daci propozoi që pasi Gazeta Infokus të sjellin shënimet e kërkuara, t'iu kthehet përgjigja me shënim që t'i referohen Vjetarit të publikuar në faqen ueb të ASHAK-ut.

Pas diskutimeve Kryesia mori vendim që:

I. Gazetës Infokusi t'i kthehet përgjigja në kërkesën e tyre, me shënim që t'i kërkojnë shënimet si: certifikata e biznesit që dëshmon se janë të regjistruar si biznes, emri i pronarit dhe numri i letërnjoftimi, si dhe shkresa zyrtare e vulosur dhe e protokolluar.

II. Pasi t'i sjellin dokumentet e kërkuara me të cilat identifikohen si person juridik të njoftohen se shënimet mund t'i gjejnë në revistën e ASHAK-ut Vjetari, e cila është e publikuar në faqen ueb të Akademisë dhe në të përfshihen raportet e punës dhe raportet financiare të Akademisë.

Më pas Kryesia diskutoi për realizimin e pagesave të mbetura për redaktorët e redaksive të fushave dhe pagesës shtesë për kryeredaktorin e Fjalorit të enciklopedisë së Kosovës. Diskutuan shumica e anëtarëve të Kryesisë dhe pas diskutimeve Kryesia mori vendim:

I. Të realizohen pagesat e mbetura për redaktorët e redaksive të fushave dhe për punët shtesë të kryeredaktorit të Fjalorit enciklopedik të Kosovës (FEK) .

II. Kryeredaktori të hartojë raportin final me shënimet për shumën e pagesave për të gjithë redaktorët e redaksive të fushave veç e veç dhe për punët e tij shtesë.

III. Raporti t’i dorëzohet Këshillit botues të ASHAK-ut, i cili më pas i paraqet Kryesisë për miratim propozimin përfundimtar me shumat përkatëse .

Në vazhdim Kryesia:

- Shqyrtoi propozimin e Këshillit botues të ASHAK-ut dhe mori vendim që z. Zeni Ballazhi t’i paguhet shuma bruto prej 300,00€ për punën që ka bërë në cilësinë e dizajnerit grafik dhe z. Enver Bylykbashit t’i paguhet shuma bruto prej 300,00€ për punën që ka bërë në cilësinë e fotografit për katalogun për ekspozitën e akademik Tahir Emrës, botim i ASHAK-ut;

- Miratoi propozimin e Komisionit për blerjen e veprave artistike dhe bazuar në Rregulloren për blerjen e veprave artistike të ASHAK-ut mori vendim të blehen veprat artistike, si më poshtë:

1. “Peizazh i gjelbër ”, pikturë e autorit Muslim Mulliqi, dimension 100 x 80 cm, vaj në pëlthurë, 1993, me çmim prej 5.000,00€ dhe

2. “Krijimi i jetës XX”, dimension 70 x 50, litografi në gurë, (5/10), e autorit Basri Mekolli me çmim prej 500,00€.

L. Pula njoftoi Kryesinë se autori Basri Mekolli e ka dhuruar një grafikë për fondin e ASHAK-ut.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, Kryesia:

a) U njoftua nga kryetari Daci për marrëveshjen dhe protokollin me akademitë e Malit të Zi dhe të Kroacisë. Kryetari me këtë rast tha se gjatë vizitës që ka pasur në Mal të Zi ka biseduar me kryetarin e Akademisë Malazeze për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy akademive. Po ashtu aty ka takuar edhe sekretarin gjeneral të Akademisë Kroate me të cilin gjithashtu janë dakorduar për bashkëpunim. Ai tha se ASHAK-u do të përgatisë draftet e marrëveshjeve dhe ato do t’iu dërgohen dy akademive. Më pas do të merren parasysht edhe propozimet e tyre dhe bashkërisht me Kryesinë do të vendosim për hapat e radhës;

b) Vendosi që anëtarët e Kryesisë së Akademisë: akademik Jusuf Bajraktari, nënkryetar, anëtare korrespondente Myzafer Limani, sekretare shkencore, anëtare korrespondente Justina Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe anëtari korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve të pajisen me laptopë, ndërsa një laptop t’i mbetet në shfrytëzim Administratës, përkatësisht DPPTIK-ut

për realizimin e punëve të përbashkëta administrative;

c) Miratoi raportet e udhëtimeve zyrtare:

- Raportin e akademik Rexhep Ismajlit për qëndrimin e tij në SHBA më 3-13 tetor 2018 me rastin e pjesëmarrjes në aktin e shpalljes së anëtarëve të rinj të zgjedhur në Akademinë Amerikane të Arteve dhe të Shkencave. Me këtë rast kryetari Daci e njoftoi Kryesinë se akademik Ismajli i ka bërë ftesë kryetarit të kësaj Akademie për ta vizituar Akademinë tonë. Ai tha se kjo është nder për të gjithë ne;

- Raportin e akademik Jusuf Bajraktarit dhe anëtari korrespondent Frashër Demajt për qëndrimin e tyre në Tiranë më 9-10 shtator 2018, me qëllim të pjesëmarrjes në ligjëratat kushtuar Gjergj Kastriotit –Skënderbeut;

- Raportin e akademikëve Jusuf Bajraktari, Hivzi Islami dhe anëtarit korrespondent Frashër Demaj, për qëndrimin e tyre në Tiranë më 3-4 tetor, me qëllim të pjesëmarrjes në ligjëratat kushtuar Gjergj Kastriotit – Skënderbeut;

- Raportin e anëtares korrespondente Justina Pula për qëndrimin e saj në Tiranë më 19-20 shtator, me qëllim të pjesëmarrjes në konferencën në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut.

ç) Diskutoi për përrurimin e Fjalorit enciklopedik të Kosovës në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi. Kryetari Daci tha se një gjë e tillë është e panevojshme, meqë FEK nuk është botim i dalë nga bashkëpunimi me akademi apo institucione të tjera jashtë vendit, por është vetëm i ASHAK-ut.

d) Diskutoi për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ASHAK-u në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport. L. Pula e njoftoi Kryesinë se në fund të takimit është kërkuar që ASHAK-u të dërgojë Raportin dhe Programin e punës. U tha që mos t'u dërgohet asgjë pa e kërkuar ata vetë me shkrim.

dh) Diskutoi për kërkesën e punonjësit z. Alban Bytyçi, shofer-korrier i Akademisë. Për z. Bytyçi u paraqitën disa vërejtje për sjelljet e tij jo korrekte. U tha se sjelljet e tij po dëmtojnë imazhin e Akademisë dhe se mund të sjellin edhe pasoja më të mëdha. Diskutuan edhe M. Limani, J. Bajraktari, L. Mulliqi dhe pas diskutimeve Kryesia e miratoi përgjigjen për z. Bytyçi si më poshtë:

“I nderuar z. Bytyçi,

Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe e Arteve të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2018 e ka shqyrtuar kërkesën tuaj nr. 660, dt. 04.09.2018 dhe duke u bazuar në aktet normative që rregullojnë çështjen në fjalë konstaton si në vijim:

1. Kërkesa për ndryshimin e emërimit të pozitës së punës nuk mund të realizohet, meqë nuk ka bazë ligjore. Emërtimet dhe statusi i të punësuarve në të gjitha institucionet e vendit përcaktohen me rregullore dhe akte normative të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe janë obligative për të gjitha institucionet. Në Katalogun e vendeve të punës në Shërbimin Civil nuk përfshihet pozita e shoferit e as ndonjë pozitë tjetër ekuivalente. Pozita e shoferit-korrierit rregullohet me Ligjin e punës, sipas Qarkores Administrative nr. 01/2014 të Ministrisë së Administratës Publike të Republikës së Kosovës;

2. Zhvendosja në zyre tjetër konsiderohet e panevojshme, zyra ekzistuese nuk është e dëmshme për qëndrim, meqë shoferi-korrieri nuk mund të qëndrojë gjatë në zyrë, puna e tij lidhet me lëvizje brenda dhe jashtë institucionit;

3. Kryesia po ashtu në mbledhjen përkatëse ka diskutuar edhe për sjelljet tuaja jokorrekte dhe kërkon që të shmangeni nga sjelljet e tilla. Në të kundërtën, në rast të përsëritjes së sjelljeve të tilla, do të kërkohet që ndaj jush të ndërmerren masa disiplinore sipas akteve normative përkatëse”.

11. Në mbledhjen XI të datës 8 nëntor Kryesia shqyrtoi kërkesën e Zyrës Ligjore të Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese - BIRN për lejimin e qasjes në dokumente publike. Në diskutimin e tij kryetari Daci tha edhe një herë se

puna për Fjalorin enciklopedik të Kosovës ka përfunduar me sukses, është bërë punë e madhe, ndërsa shtoi se në raste të projekteve të tilla madhore gabimet ndodhin, por ato mund të përmirësohen në të ardhmen. Shpenzimet për FEK, sikundër edhe të gjitha shpenzimet e tjera të ASHAK-ut, janë të pasqyruara në raportet vjetore të punës së Akademisë të paraqitura në revistën Vjetari, e cila është e publikuar në faqen ueb të ASHAK-ut. Diskutuan me radhë edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe pas diskutimeve u tha që deri të hënën Departamenti për buxhet dhe financa të përgatisë raportin me shkrim për shpenzimet e FEK-ut dhe të martën të mbledhet Kryesia, ta shqyrtojë dhe më pas të njoftohet kërkuesi, në këtë rast BIRN-i.

L. Mulliqi propozoi që raporti që do të përgatitet të miratohet nga Kryesia dhe të publikohet në faqen ueb të Akademisë. Propozimi u përkrah edhe nga anëtarët e tjerë të Kryesisë.

12. Mbledhja XII u mbajt më 13 nëntor. Në këtë mbledhje Kryesia:

- Shqyrtoi raportin e shpenzimeve për Fjalorin enciklopedik të Kosovës, përkatësisht tabelën me shënime financiare dhe raportin me shkrim që lidhet me tabelën.

U tha që këto dy dokumente të publikohen sot në faqen ueb të ASHAK-ut, ndërsa nesër, më 14 nëntor, zyrtari për qasje në dokumente publike këto dokumente bashkë me akt përcjellës të

nënshkruar, të protokolluar dhe të vulosur t'ia dërgojë në kopje fizike, me postë, Zyrës Ligjore të Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese - BIRN.

- Shqyrtoi propozimin e Këshillit botues të ASHAK-ut. Kryetari Daci, në diskutimin e tij tha se Fjalori enciklopedik i Kosovës ka përfunduar me sukses si projekt dhe me këtë rast duhet të përfundojnë edhe të gjitha obligimet financiare për redaktorët e fushave dhe për punët shtesë të kryeredaktorit. M. Limani në diskutimin e saj sqaroi para Kryesisë se Këshilli botues e ka shqyrtuar me kujdes raportin e M. Krajës dhe i propozon Kryesisë që në mbështetje të Rregullores për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese të ASHAK-ut, neni 2, paragrafi 6 dhe Vendimit nr.964/3, dt. 31.12. 2014, të realizohen pagesat (honorarët) e mbetura për redaktorët e fushave të FEK-ut, sipas kërkesës nr. 968, dt. 9.11.2018 dhe pagesa e honorarit për punët shtesë të akademik Krajës në cilësinë e kryeredaktorit të FEK-ut.

Akademik Krajës t'i paguhet honorari në vlerë prej 7.450,00 € për redaktimin e 745 zërave dhe paushalli për punët shtesë të kryeredaktorit në vlerë prej 7.500,00 €. Pra, gjithsej t'i paguhet 14.950,00 €.

Vlera e honorarëve për redaktorët e fushave të FEK-ut është 16.350,00 €.

Vendimit t'i bashkëngjiten këto dokumente:

- Raporti i akademik M. Krajës, dt. 4 qershor 2018;

- Shkresa e Redaksisë Qendrore e FEK-ut, dt. 2 korrik 2018;

- Arsyetimi i M. Krajës dërguar përmes postës elektronike, dt. 4 shtator 2018;

- Raporti përfundimtar i M. Krajës nr. 968, dt. 9.11.2018.

J. Bajraktari në diskutimin e tij tha se herën e parë është refuzuar kërkesa e M. Krajës, meqë nuk ka pasur vendim për angazhimin e tij në cilësinë e redaktorit përgjegjës, por meqë tani propozimi është që ai të kompensohet për punët shtesë në cilësinë e kryeredaktorit, gjërat janë të qarta. Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe pas diskutimeve Kryesia e miratoi propozimin e Këshillit botues.

- Shqyrtoi kërkesën e akademik Mehmet Krajës për digjitalizimin e Fjalorit enciklopedik të Kosovës. Diskutuan shumica e anëtarëve të Kryesisë dhe pas diskutimeve u vendos që për një kohë të caktuar të jetë në qarkullim vetëm kopja fizike, ndërsa vendimi për digjitalizim dhe publikimi në faqen ueb të ASHAK-ut të merret në të ardhmen nga Kryesia e ASHAK-ut.

Dhe në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia:

a) Miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të akademikëve Jusuf Bajraktari, Anton K.

Berishaj dhe anëtarëve korrespondentë Kujtim Shala dhe Frashër Demaj për qëndrimin e tyre në Tiranë, më 1-2 nëntor, me qëllim të pjesëmarrjes në aktivitetin përfundimtar në kuadër të shënimit të Vitit Jubilar për Gjergj Kastriotin - Skënderbeun;

b) Vendosi që Grupi punues për hartimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme për realizimin e Planit strategjik gjithëpërfshirës për vitet 2018-2021 të hartojë listën e rregulloreve të cilat i mungojnë ASHAK-ut dhe menjëherë të fillojë hartimin e drafteve të rregulloreve (për organizimin e aktiviteteve shkencore, për sistematizimin, për faqen ueb, etj., të cilat më pas do t'i kalojnë procedurat e rregullta deri në miratimin përfundimtar nga Kuvendi i Akademisë;

c) Diskutoi për propozimin e L. Mulliqit që komisionet e ASHAK-ut të raportojnë me shkrim para Kryesisë për punën e tyre. Propozimi u miratua dhe Kryesia mori vendim që të gjitha komisionet dhe grupet punuese të ASHAK-ut të hartojnë raport vjetor të punës për vitin 2018, ndërsa nga viti 2019 e tutje të raportojnë në baza gjashtëmujore.

ç) Diskutoi për faqen ueb të ASHAK-ut. J. Pula paraqiti vërejtjet e Seksionit të Shkencave Shoqërore, me ç' rast disa aktivitete të rëndësishme të Seksionit që janë realizuar me shumë sukses nuk janë publikuar në faqen ueb. Kryetari Daci në fjalën e tij tha se pajtohet plotësisht me qëndrimin se faqja ueb

ka mangësi. Ai propozoi që deri në angazhimin e një zyrtari sekretarët e seksioneve të përcjellin aktivitetet e seksioneve të tyre, të përgatisin tekstet - njoftimet dhe ato më pas secili t'ia dërgojë Drejtorit të DPPTIK-ut z. Ali Caka për publikim;

d) U njoftua nga L. Pula se më dt. 12.11.2018 ASHAK-u ka pranuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës (lënda C.nr. 249/11), sipas të cilit ASHAK-u obligohet t'i paguajë borxhin z. Shaip Olluri, ish punonjës në ASHAK në vlerë të një banese me rreth 62 m². Ajo tha se për këtë çështje nuk ka fare njohuri dhe e njoftoi Kryesinë për procedurat e mëtejme. Kryetari Daci propozoi që lidhur me këtë çështje ASHAK-u t'i drejtohet me shkresë zyrtare z. Zija Bylykbashi, ish sekretar i ASHAK-ut dhe të kërkojë ndihmën e tij, meqë rasti i përket kohës kur ai ka qenë sekretar. M. Limani propozoi që për këtë çështje ASHAK-u të angazhojë avokat. Të dy propozimet u miratuan nga Kryesia. L. Pula në fund tha se nga nesër do të merret me çështjen në fjalë dhe për çdo veprim do ta njoftojë Kryesinë.

13. Mbledhja e fundit e Kryesisë (XIII) u mbajt më 20 dhjetor. Në këtë mbledhje Kryesia shqyrtoi shkallën e realizimit të Programit të punës të ASHAK-ut për vitin 2018. M. Limani në diskutimin e saj propozoi që te raporti i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (SGJL), te pika 6, (botimet) Sabri Hamiti: "Testamenti", në vend të fjalës botohet të shkruhet shtypet. Arsyeja është të

precizohet jo botim, por shtyp, sepse pavarësisht që libri është shtypur me donacion, autorësia është paguar nga ASHAK-u. Ajo po ashtu e komentoi shkresën e E. Bashës, bashkëlidhur shkallës së realizimit të programit të punës të SGJL-së dhe tha se Këshilli botues në bazë të disponimit të mjeteve financiare e ka bërë renditjen e shtypjes së dorëshkrimeve. Pra është vendosur bashkërisht në Këshill, meqë nuk ka pasur zgjidhje tjetër, sepse prioritet i është dhënë shtypjes së Fjalorit enciklopedik të Kosovës. Ajo propozoi që në fillim të vitit 2019 nga DPPTIK të bëhet lista me dorëshkrimet e gatshme për botim, pra ato të cilat i kanë kaluar të gjitha procedurat e rregullta, për të cilat janë plotësuar shkresat, sepse siç tha ajo, nuk do ta procedojë asnjë dorëshkrim për botim pa i plotësuar të gjitha shkresat përkatëse.

Për çështjen e shtypjes së dorëshkrimeve diskutoi edhe J. Pula, e cila në fjalën e saj se tha duhet të jemi të përkushtuar që asnjë dorëshkrim të mos shkojë në shtyp pa i plotësuar kërkesat ligjore.

Kryetari Daci në diskutimin e tij tha se SGJL ka shumë propozime në kuadër të veprimtarisë botuese dhe se gjithnjë ka qenë seksioni më i privilegjuar. Tani është koha që të ketë harmonizim dhe t'u lihet hapësirë edhe seksioneve të tjera, meqë nuk mundet vetëm një seksion, siç ka ndodhur deri më tani me SGJL-në, të propozojë dhe të kërkojë me ngulm realizimin e propozimeve të

veta . Ai po ashtu tha se revista Studime është revistë e mirë dhe ka mjaft materiale, por do të ishte mirë të fillohet me botimin e saj edhe në gjuhë ndërkombëtare, ashtu siç është botuar numri i fundit i revistës Kërkime.

L. Mulliqi propozoi që raporti i punës të shoqërohet edhe me vlera financiare, të cilat i posedon Departamenti i financave, sepse tani e kemi rastin në Seksionin e Arteve, që koncerti i akademik Rauf Dhomit nuk është realizuar për shkak të mungesës së mjeteve financiare dhe si sekretar i Seksionit më është dashur të ofroj sqarime para Seksionit për këtë çështje. Ai po ashtu propozoi që të ketë një harmonizim të mjeteve financiare ndërmjet seksioneve. Me propozimin u pajtua edhe kryetari Daci, i cili kërkoj që raportet e punës dhe propozimet për programet e punës të shoqërohen patjetër edhe me vlera financiare.

Kryetari Daci e vazhdoi diskutimin duke u ndërlidhur me disa çështje të punëve në Akademi. Ai tha se po mundohet të shtyjë përpara disa punë duke qenë i hapur për bashkëpunim dhe se nuk ka hasur në gatishmëri nga ana e disa anëtarëve të Akademisë, por përkundrazi ka thashetheme se kryetari nuk po konsultohet. Fjala është për Këshillin për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe kryetarin e Këshillit akademik Rexhep Ismajlin. Ai tha se asnjë organ përveç Kryesisë dhe Kuvendit nuk merr vendime. Praktika e deritanishme duhet të ndërpritet, bashkëpunim dhe konsulta mund të

ketë gjithnjë në drejtim të mbarëvajtjes së punëve, por vendimet i merr vetëm Kryesia dhe Kuvendi i Akademisë.

J. Bajraktari në diskutimin e tij lidhur me fjalën e kryetarit tha se në mbledhje të Kryesisë vazhdimisht po flitet dhe po etiketohen me emra disa nga anëtarët e Akademisë, për një apo tjetër arsye. Nuk është mirë të rëndohen mbledhjet e Kryesisë me përvoja individuale nga e kaluara, veprimtaria e Akademisë duhet të jetë institucionale e jo individuale. Ai i luti anëtarët e Kryesisë e posaçërisht kryetarin që gjatë diskutimeve të kenë konsideratë dhe të mos flasim me emra në mbledhje zyrtare pa argumente, meqë në këtë mënyrë mund të krijohet hapësira për manipulim të fakteve.

Për çështjen e bashkëpunimit ndërkombëtar diskutoi J. Pula, e cila tha se dy anëtarë të Akademisë të Seksionit të Shkencave Shoqërore janë anëtarë të Këshillit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe se në një nga mbledhjet e seksionit është diskutuar kjo çështje. Janë dhënë vërejtje që Këshilli nuk ka informacione dhe se disa punë (komunikime) janë kryer pa u vënë në dijeni Këshilli. Me diskutimin e J. Pulës u pajtua edhe E. Basha dhe tha se edhe në SGJL janë dhënë këto vërejtje. Kryetari Daci tha se nuk është në dijeni për këto vërejtje, meqë ato duhet të adresohen me shkrim dhe se ai deri më tani nuk ka pranuar asgjë. M. Limani në diskutimin e saj tha se Këshilli deri më tani ka mbajtur vetëm tri takime dhe se ndoshta do të duhej

të hartohet një rregullore e cila do t'i përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia:

a) Miratoi këto raporte të udhëtimeve zyrtare:

- Raportin e akademik Rexhep Ismajlit për qëndrimin e tij në Tiranë më 19-20 shtator me qëllim të pjesëmarrjes në aktivitetin e ndarjes së çmimit për veprën më të mirë dhe të vlerësimeve të veprave të personaliteteve të merituar në studimet për Skënderbeun dhe mesjetën shqiptare;

- Raportin e anëtares korrespondente Gjyljeta Mushkolaj për qëndrimin e saj në Bruksel me qëllim të pjesëmarrjes në seminarin e organizuar nga ALLEA më 16-18 tetor;

- Raportin e anëtarit korrespondent Luan Mulliqi për qëndrimin e tij në Tiranë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë më 14-16 nëntor;

- Raportin e akademik Mehmet Kraja për qëndrimin e tij në Tiranë me rastin e promovimit të romanit të tij "Prishtina" më 15-17 nëntor;

- Raportin e delegacionit në përbërje prej Lendita Pulës, Hilmi Zogjanit dhe Rejhane Islamit për pjesëmarrjen në Konferencën tradicionale ndërkombëtare COBISS, e organizuar

nga IZUM në Maribor, më 27-30 nëntor.

b) U njoftua nga L. Pula për menaxhimin e rrezikut për vitin 2017. Ajo e njoftoi Kryesinë se Grupi punues për menaxhimin e rrezikut i ASHAK-ut, gjatë vitit ka mbajtur takimet e rregullta, ka raportuar me kohë dhe se është rishikuar regjistri i rrezikut për periudhën janar-dhjetor 2017.

c) Miratoi vendimin për shpenzimet telefonike për drejtuesit dhe punonjësit e ASHAK-ut për vitin 2019.

ç) Diskutoi për dizajnin e kartolinave (urimeve) të ASHAK-ut të cilat bëhen çdo fundvit. Kryetari Daci tha se do të ishte mirë që ato të ndryshohen (freskohen), duke u fokusuar më shumë në të ardhmen, por L. Mulliqi sqaroi se dizajnin e ka bërë vetë ai duke i përfshirë në kartolina veprat artistike të të gjithë anëtarëve të Akademisë dhe se për punë profesionale ai mban përgjegjësi. Ai në fund shtoi se këto punë është mirë t'u lihen në duar vetëm profesionistëve.

d) Vendosi që më 31 dhjetor të mos punohet. U tha, meqë është natë feste, dalja në punë vetëm në orët e paradites nuk ka efekt.

AKTIVITETET E REALIZUARA NGA KRYESIA E AKADEMISË

MONOGRAFIA E AKADEMIK NEXHAT DACIT "LINDJA E VËSHTIRË E SHETËSISË SË KOSOVËS"

Në kuadër të shënimit të 10-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës është botuar monografia "Lindja e vështirë e shtetësisë së Kosovës" e autorit akademik Nexhat Daci.

Monografia është miratuar për botim në mbledhjen e Kryesisë së Akademisë, mbajtur më 18 prill 2018, dhe është përvuruar më 15 tetor 2018 në mjediset e Akademisë.

SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

PROJEKTE

1. Fjalori enciklopedik i Kosovës. – Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut. U dorëzua në shtyp në pjesën e parë të vitit 2018. Doli nga shtypi nga mesi i vitit dhe u promovua me 25 shtator 2018. U mbyll një fazë e punës që zgjati rreth 5 vjet dhe tashmë Fjalori enciklopedik i Kosovës është në qarkullim. Pritet funksionalizimi i një redaksie e cila do të merrej me evidentimin e lëshimeve eventuale apo me plotësimin me zëra të tjerë deri në ribotimin e tij.

2. Këshilli Ndërkademi për Gjuhën Shqipe. – Sado që formalisht figuron në

Protokollin e fundit të bashkëpunimit shkencor midis ASHAK dhe ASHSH (2018-2020), puna e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe praktikisht ka përfunduar. Në Programin e punës të Seksionit për vitin 2019 është paraparë botimi i materialeve të këtij Këshilli, të cilat janë duke u përgatitur dhe planifikohen të dorëzohen në pjesën e parë të vitit 2019, pas marrëveshjes me ASHSH-në.

3. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX. – I paraparë të finalizohet me fundin e vitin 2017 dhe të botohet brenda vitit 2018, Leksiku shqip i revistës “Përparimi” 1955-1968, dorëshkrimi tashmë është i gatshëm dhe pret radhën për shtyp. Ishte menduar të dilte në fillim të vitit 2018, por për shkak të çrregullimit të planit të botimit ka mbetur në dorëshkrim, i faqosur dhe i shtypur në maket libri. Në dhjetor 2018 është publikuar në faqenueb e ASHAK-ut. Mund të thuhet se janë kapërcyer disa nga vështirësitë rreth aftësisë teknike, profesionale të Qendrës Leksikografike Enciklopedike, me sigurimin e skanerit të ri dhe vënien e tij në punë, por gjatë vitit 2018 nuk janë angazhuar kuadro që merren me drejtimin e punëve të cilëve u skadoi kontrata në fund të 2017-ës. Për vitin 2019 është kërkuar të vazhdohet puna dhe të pranohet stafi i kualifikuar.

4. Vepra e plotë e Norbert Joklit. – Gjatë vitit 2017 kishte dalë vëllimi i dytë i veprës së albanologut të shquar austriak Norbert Jokl Studime krahasuese për gjuhën shqipe

(Historisch-Vergleichende untersuchungen über das Albanische), përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli dhe prof. dr. Heiner Eichner, i paraparë me programin e Seksionit. Për vitin 2018 parashihej të botohej vëllimi i tretë Hulumtime linguistike – kulturo-historike në fushë të shqipes (Linguistisch-kulturohistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen), i përkthyer nga origjinali. Dorëshkrimi tashmë është finalizuar dhe është i gatshëm për shtyp. Projekti do të vazhdojë me mbledhjen, sistemimin, përkthimin dhe botimin e kontributeve të tjera të Joklit, me qëllim që vepra e tij të dalë sa më e plotë.

5. Korpusi i shqipes së folur në Kosovë. - Projekti, planin e detajuar të të cilit e kemi paraqitur dhe aprovuar, ka qenë në fazën e trajnimit të kuadrit që do të përfshihet në punën në terren. Gjatë marsit 2018, dy profesorë të Universitetit Humboldt nga Berlina kanë mbajtur trajnim njëjavor në Prishtinë me një grup profesorësh, gjuhëtarësh e ekspertësh të teknologjisë informative. Në qershor një pjesë e këtij kuadri është aftësuar në Berlin. Trajnimet janë realizuar me bashkëpunimin e Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Humboldt, në projektin e përbashkët për korpuset, me theks të veçantë korpuset e folura. Trajnimet do të vazhdojnë, sërish në bashkëpunim me Universitetin e Humboldt. Është paraparë një uorkshop në Prishtinë, në mjediset e Akademisë. Në këtë periudhë bëhet intervistimi dhe përzgjedhja e redaktorëve dhe e

personave që do të mbledhin materialet në terren. Kjo realizohet në bashkëpunim edhe me institucione të tjera - përveç Universitetit të Prishtinës do të përfshihen Instituti Albanologjik, si dhe mësimdhënës e studentë nga Prizreni, Gjakova e Gjlani. Bartës të projektit janë: Bardh Rugova, Rexhep Ismajli, Mehmet Halimi.

6. Projekti për leksikonin e termave të gjuhësisë. - Ka përfunduar pjesa e fonetikës dhe është dorëzuar dorëshkrimi për faqosje e finalizim grafik. Leksikoni i termave të fonetikës ka gjithsej 450 zëra. Botimi është paraparë në Programin e punës së SGJL-së për vitin 2019 dhe libri mund të hyjë në shtyp në muajt e parë të vitit. Janë duke u përgatitur zërat e gjuhësisë funksionale dhe të sociolinguistikës. Kjo pjesë do të ketë mbi 1000 zëra, më shumë se një e treta e të cilëve tashmë janë hartuar. Ende nuk ka filluar puna rreth termave të gramatikës. Fjalorët e fushave të veçanta janë autoriale dhe botohen veç e veç për çdo fushë. Bartës të projektit janë Rexhep Ismajli e Bardh Rugova.

TUBIME SHKENCORE

1. Romani shqiptar, fillimi i shekullit XXI, Konferencë shkencore, e organizuar nga Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK-ut në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, mbështetur në Protokollin për bashkëpunim shkencor midis dy akademive. Konferencën e përgatiti Këshilli organizues i përbërë nga Sabri

Hamiti, Ali Aliu, Floresha Dado, Bashkim Kuçuku dhe Kujtim Shala. U mbajt, siç ishte paraparë, me 10 tetor 2018. Ishin paraqitur 21 referues, që kishin dërguar titujt e kumtesave dhe abstraktet, të cilët u publikuan bashkë me programin e punës. Në Konferencë u paraqiten 15 referues. Pesë pjesëmarrës nuk erdhën për arsye të ndryshme (rast vdekjeje, angazhime të tjera, sëmundje...), ndërsa një prej tyre e dërgoi kumtesën. Aktiviteti u mbajt me dy seanca të ngjeshura. Konferenca mbledhi kritikë, studiues e dijetarë të letërsisë për trajtim të shumanshëm të zhanrit të romanit shqiptar të fillimit të shekullit XXI dhe u vlerësua e suksesshme, në kornizat e asaj që pritej. Gjatë kësaj periudhe janë mbledhur kumtesat (gjithsej 17) dhe është finalizuar e dorëzuar një dorëshkrim prej 234 faqesh me materialet e Konferencës që është paraparë të botohet në pjesën e parë të vitit 2019.

BOTIME

1. Irena Sawicka, Karolina Dargiel, **Struktura e rrokjes shqipe**. – Ka dalë nga shtypi libri i prof. dr. Irena Sawicka, studiuese e gjuhës shqipe dhe e gjuhëve të tjera të Ballkanit nga Polonia, autore e monografive të rëndësishme për studimet e Ballkanit, e studimeve për shqipen, e njohur sidomos për monografitë dhe studimet e veçanta në fushën e fonetikës, me bashkautorë Karolina Dargiel, studiuese e re në fushën e fonetikës dhe të shqipes. Është hera e parë që për këtë

problematikë kemi një studim të gjerë monografik, i shkruar shqip, me vështrime komplekse nga aspekte të ndryshme dhe me shqyrtime nëpër rrjetin e begatshëm teorik e konkret të shqipes. Për shkak të mungesës së mjeteve, shtypin e mori përsipër si donacion shtypshkronja “Timegate”. Më 23 nëntor në mjediset e ASHAK u bë dhe përrurimi i veprës në praninë e Irena Sawickas, për të cilën folën Rexhep Ismajli, Bardh Rugova dhe autorja.

2. Wilfried Fiedler, *Vergleichende Grammatik der Balkansprachen*.

(Morphosyntaktisch-typologische vergleich des Albanischen mit den anderen Balkansprachen). Teil I: Das Verbalsystem [Gramatikë e krahasuar e gjuhëve Ballkanike (Krahasim morfosintaksor-tipologjik i shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit). Pjesa I: Sistemi foljor]. - Dorëshkrim i autorit të dy monografive të mëdha të botuara te ne, të dyja të vlerësuara si vepra me rëndësi të autorit, sot nga më të shquarit në albanistikë. Vepra e shkruar gjermanisht, e shoqëruar me parathënie shqip e gjermanisht, doli nga shtypi gjatë muajit nëntor. Ky libër do të ketë rëndësi të madhe për studimet ballkanistike dhe do të shërbejë si bazë e referencës në këto studime.

3. *Në 100-vjetorin e Akademik Idriz Ajetit* / Materialet e Konferencës jubilarë-shkencore të mbajtur në Prishtinë (ASHAK) me rastin e 100-vjetorit të lindjes së akademik Idriz

Ajeti më 27 janar 2017. - Materialet e Konferencës jubilarë-shkencore për këtë jubile të rrallë, mbajtur në Prishtinë, me praninë e akademik Ajetit, organizuar nga ASHAK dhe ASHSH, të përgatitura nga akademik Rexhep Ismajli, u desh të botohen në pjesën e dytë të vitit 2018, për arsye tashmë të njohura të vonësive të shtypit. E përgatitur nga Këshilli organizues (H. Islami, A. Aliu, E. Basha, E. Lika, K. Topalli dhe R. Ismajli) dhe e drejtuar nga Rexhep Ismajli, Konferenca kishte tubuar rreth 30 pjesëmarrës me kumtesa e fjalë rasti për jetën dhe veprën e akademik Ajetit. Materialet u përmbledhën në një vëllim 308 faqesh dhe libri tashmë është në qarkullim.

4. Sabri Hamiti, *Testamenti*. – Libri ishte paraparë me program për fundin e vitit 2017, por autorit i është vënë në dijeni se botimi nuk mund të realizohet brenda afatit për shkak të vonësive të botimeve të Akademisë që u shkaktuan me mungesën e mjeteve dhe nga përparësia që kishte Fjalori enciklopedik i Kosovës. Testamenti është libër studimesh për lirikën shqipe dhe historinë e letërsisë, i ndarë në tri pjesë: Lirika shqipe, Leksione e Testamenti dhe ka 378 faqe. Autori e ka dorëzuar dorëshkrimin në vitin 2018. Dorëshkrimi është vlerësuar nga recensentët Zejnullah Rrahmani e Rexhep Ismajli dhe është miratuar për botim në mbledhjen e Seksionit. Vepra është shtypur me donacion dhe ka dalë në qarkullim në muajin nëntor.

5. Kujtim Shala, *Identiteti i pa/zbulluar* (Letërsi e identitet). – Është një studim mbi raportet e letërsisë me identitetin, të letërsisë si shenjë identitare dhe të letërsisë si fushë specifike që determinon identitetet. Dorëshkrimi, i përfshirë në Programin e punës së Seksionit për vitin 2018, është dorëzuar në kohën e planifikuar (shtator 2018). Recensentët Ali Aliu dhe Zejnullah Rrahmani janë caktuar dhe kanë dhënë vlerësimin për dorëshkrimin, i cili pastaj është aprovuar për botim në mbledhjen e Seksionit. Libri është i gatshëm për shtyp.

6. Norbert Jokl, *Hulumtime linguistike-kulturohistorike në fushë të shqipes/* Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen. – Vepër e botuar më 1923, kryevepra e albanologut austriak Norbert Jokl është me rëndësi të dorës së parë për studimet etimologjike dhe për shumë çështje të tjera të domosdoshme për studimin e historisë së gjuhës shqipe. Përkthimi në shqip është bërë nga Skënder Gashi. Në këtë botim pranë tekstit shqip jepet edhe origjinali gjermanisht i skanuar, në mënyrë që specialistët të mund t'i referohen burimit. Dorëshkrimi është i përfunduar dhe pret të dërgohet në shtyp.

7. *Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht* (Albanistische Forschungen in den Deutschsprachigen Ländern). – Materialet e Konferencës ndërkombëtare shkencore, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e

Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, e mbajtur në Prishtinë (ASHAK) më 26 e 27 tetor 2017, e përgatitur nga Këshilli organizues, i drejtuar nga akademik Rexhep Ismajli. Është nga aktivitetet më të gjera të realizuar nga Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK-ut. Konferenca tuboi emra të njohur studiuesish jo vetëm në vendet ku flitet gjermanisht, por edhe nga Kosova, Shqipëria dhe vendet tjera të Evropës. Kontributet shkencore të rreth 50 kumtuesve janë tubuar në një dorëshkrim voluminoz, përgatitur nga akademik Ismajli, që planifikohej të botohej brenda vitit 2018. Dorëshkrimi është finalizuar dhe është i gatshëm për shtyp.

8. Tregime të zgjedhura të shkrimtarëve akademikë (I-IV). – Një botim me katër vëllime me tregime të katër autorëve tregimtarë veç e veç, anëtarë të ASHAK-ut: Anton Pashku, Eqrem Basha, Mehmet Kraja dhe Zejnullah Rrahmani. Përzgjedhjet do të shoqërohen me parathënie dhe shënime të tjera biografike e bibliografike. Është caktuar një redaksi e përbërë nga Ali Aliu, Rexhep Ismajli dhe Kujtim Shala. Për shkak të problemeve me shtyp dhe mungesës së mjeteve financiare, botimi do të kalojë në vitin 2019.

9. Revista “*Studime*” nr. 25. – Për shkak të vonesave në shtyp, numri 24 i revistës “*Studime*”, që e boton Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë e që do të duhej të dilte në fillim të vitit 2018, për

shkak të problemeve me mjete dhe vonesës së botimeve të tjera të ASHAK-ut, fillimisht qe publikuar në faqen e internetit të Akademisë dhe në disa kopje në formë maketi, ndërsa më vonë, gjatë muajit nëntor, doli i shtypur. Numrin 25 të revistës, redaksia e drejtuar nga kryeredaktori Zejnullah Rrahmanin e ka finalizuar brenda dhjetorit të vitit 2018 dhe tashmë është dorëzuar për shtyp. Pritet të dalë në muajt e parë të vitit 2019.

Sekretari i Seksionit
Akademik Eqrem Basha, d.v.

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

PROJEKTE

1. *Fjalori enciklopedik i Kosovës.* –

Projekt i përbashkët i të gjitha seksioneve të ASHAK-ut. U dorëzua në shtyp në pjesën e parë të 2018-ës. Doli nga shtypi nga mesi i vitit dhe u përrurua më 25 shtator 2018. U mbyll një fazë e punës që zgjati rreth 5 vjet dhe tashmë Fjalori Enciklopedik i Kosovës është në qarkullim. Pritet funksionalizimi i një redaksie e cila do të merrej me evidentimin e lëshimeve eventuale apo me plotësimin me zëra të tjerë deri në ribotimin e Fjalorit.

2. *Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës* - Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale. - Projekt afatmesëm.

Puna në këtë projekt ka filluar në vitin 2017 dhe ka vazhduar edhe në vitin 2018. Në fazën e parë të punës është bërë mbledhja e të dhënave dhe përpilimi i databazës shkencore-enciklopedike të vendbanimeve tona, ku është angazhuar një numër i madh i ekspertëve nga shkencat gjeohapësinore, nga sociologë, urbanistë, planerë, ekonomistë, demografë, historianë, etnologë, administratorë komunalë etj. dhe atë kryesisht staf me grada shkencore që punojnë dhe veprojnë në institucione profesionale-shkencore, pastaj në komuna dhe vendbanime, gjithnjë nën udhëheqjen e një anëtarit të grupit të punës në projekt. Në grupin e punës kanë qenë të angazhuar rreth 40 profesionistë për punë në terren dhe për përpilimin e teksteve.

Faza e parë e projektit ka përfunduar. Projekti është realizuar në bashkëpunim me Lidhjen e Historianëve në Prishtinë dhe është mbështetur nga donacionet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe Ministrisë së Ambientit dhe Pushtetit Lokal.

Faza e dytë e këtij projekti ka përfunduar po ashtu. Raporti i punës njëvjeçare me rreth 600 faqe është miratuar në mbledhjen e Seksionit më 18 dhjetor 2018.

3. Hasan Prishtina në prizmin e dokumenteve arkivore. – Projekt afatmesëm. Ky projekt ka hyrë në Programin e punës së Seksionit për

vitin 2017 dhe me atë rast është dhënë arsyetimi i hollësishëm. Deri më tani bartësit e projektit kanë hulumtuar materialet arkivore në Arkivin Shtetëror të Tiranës dhe në Arkivin e Vjenës. Vetëm nga Arkivi i Tiranës janë sjellë rreth 1000 dokumente. Edhe gjatë vitit 2018 ka vazhduar puna me hulumtimin dhe përzgjedhjen e dokumenteve që bëjnë fjalë për aktivitetin politik, rolin që luajti Hasan Prishtina në kryengritjet antiosmane dhe në përpjekjet për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë e të konsolidimit të shtetit shqiptar. Këto dokumente paraqesin vlerë të një rëndësie të dorës së parë jo vetëm për ndriçimin e të kaluarës së kësaj figure historike, por edhe për njohjen më të themeltë të proceseve shoqërore, historike e politike të periudhës 1908-1933.

Bartësit e projektit kanë planifikuar të vazhdojnë hulumtimet edhe në arkivat e tjera të qendrave diplomatike si në Berlin, Paris, Londër dhe në arkivat e rajonit: në Beograd, Shkup dhe Cetinje. Finalizimi i këtij projekti kërkon mbështetje financiare.

4. Korpusi i monumenteve epigrafike antike të Kosovës.

Projekti është afatmesëm, i paraparë të realizohet në dy faza. Faza e parë e projektit është realizuar. Pritet realizimi i pjesës së dytë.

TUBIME SHKENCORE

1. ***“Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit”***. - Simpozium shkencor ndërkombëtar.

Bartës të aktivitetit: Akademik Jusuf Bajraktari dhe anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj.

Simpoziumi u mbajt më 17 maj 2018 dhe u organizua nga këshilli organizues në përbërje: Akademik Jusuf Bajraktari, akademik Ali Aliu, anëtar korrespondent Frashër Demaj, anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj dhe anëtar korrespondent Muhamedin Kullashi. Atë e shpalli të hapur anëtarja korrespondente Justina Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore. Në të u trajtuan tema nga aspekte të ndryshme dhe nga këndvështrimi historik, juridik, politik, ekonomik e social për periudhën 10-vjeçare për Kosovën.

Kumtesat e tyre në simpozium i paraqitën: Jusuf Bajraktari, Beqir Meta nga Tirana, Ksenofon Krisafi nga Tirana, Muhamedin Kullashi, Arsim Bajrami, Sonja Biserko nga Beogradi, Islam Lauka nga Tirana, Anton Panchevi nga Bullgaria, Teki Kurti nga Tirana, Eva Hyskaj nga Tirana, Gjyljeta Mushkolaj, Frashër Demaj, Esmeralda Osmani nga Tirana dhe Justina Shiroka - Pula.

Simpoziumi i përfundoi punimet me sukses dhe kontributet autoriale të tij do të botohen në një vëllim të veçantë gjatë vitit 2019.

2. "Lidhja Shqiptare e Prizrenit (140 vjet mbas)". - Konferencë shkencore ndërkombëtare. U mbajt më 8-9 qershor 2018. Konferenca është organizuar bashkë me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, në kuadër të Protokollit ASHAK-ASHSH, nga Këshilli organizues në përbërje: Jusuf Bajraktari (kryetar), Frashër Demaj (sekretar) dhe Beqir Meta, Shaban Sinani dhe Nuri Bexheti (anëtarë). Konferenca u hap me pikën artistike "Marshi i Bashkimit" i akademik Zeqirja Ballatës.

Fjalën e hapjes e paraqiti Justina Shiroka - Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe më pas me fjalë rasti u paraqitën: President i Republikës së Kosovës z. Hashim Thaqi dhe akademike Floresha Dado nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Me kumtesat e tyre u paraqitën rreth 29 pjesëmarrës nga Austria, Bullgaria, Maqedonia, Bosnja, Sllovenia dhe Shqipëria.

Përfaqësues i Akademisë Austriake ishte Oliver Schmitt, anëtar i rregullt i saj dhe anëtar i jashtëm i ASHAK-ut.

Konferenca i zhvilloi punimet me sukses, me vlerësime të larta. Kontributet autoriale do të botohen në një vëllim të veçantë gjatë vitit 2019.

3. "Filozofia dhe teatri: raportet e teatrit bashkëkohor me teatrin modern". - Simpozium shkencor ndërkombëtar.

Bartës i aktivitetit anëtar i korrespondent Muhamedin Kullashi.

Simpoziumi u mbajt më 17 tetor 2018 dhe u organizua nga Këshilli organizues në përbërje: akademik Rexhep Ismajli, akademik Eqrem Basha dhe anëtar i korrespondent Muhamedin Kullashi.

Qëllimi i kësaj konference ishte të merren në shqyrtim disa aspekte të problemeve që kanë të bëjnë me teatrin e sotëm evropian, duke marrë parasysh debatet që janë zhvilluar e po zhvillohen brenda rrymave të mendimit kritik për teatrin.

Konferencën e hapi anëtarja korrespondente Justina Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore, ndërsa me kumtesat e tyre u paraqitën rreth 11 pjesëmarrës. Në mesin e tyre ishin profesorët nga Italia, Valentina Valentini, nga Franca Jean-Pierre Sarrazac dhe nga Shqipëria Armand Bora.

Simpoziumi i përfundoi punimet me sukses dhe kontributet autoriale të tij do të botohen në një vëllim të veçantë gjatë vitit 2019.

4. "Sistemi i arsimit, tregu i punës dhe zhvillimi ekonomik: "Sfidat dhe perspektivat". - Konferencë shkencore ndërkombëtare.

Bartës të aktivitetit akademik Isa Mustafa dhe anëtarja korrespondente Justina Pula.

Konferenca u mbajt më 26 dhe 27 tetor 2018 dhe u organizua nga Këshilli organizues në përbërje: Akademik Isa Mustafa, akademik Hivzi Islami, akademik Vinko Kandžija i Universitetit të Rijekës (Kroaci), profesor Tina Harrison i Universiteti të Edinburgut (Skoci), profesor Aziz Pollozhani i Universitetit “Nënë Tereza” të Shkupit (Maqedoni), anëtar korrespondent Arsim Bajrami dhe anëtare korrespondente Justina Shiroka - Pula.

Konferencën e hapi anëtarja korrespondente Justina Shiroka Pula -, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore, ndërsa folësit kryesorë në Konferencë ishin: Will Bartlett, London School of Economics (Angli), me temën: “Kontributi i arsimit të lartë për formimin e shkathtësive dhe

zhvillimin ekonomik në Ballkanin Perëndimor” dhe Dijana Vican, Universiteti i Zarës (Kroaci), me temën “Reformat e arsimit dhe ndërkombëtarizimi i arsimit si forca lëvizëse dhe bartëse të ndryshimeve sociale dhe ekonomike në vendet në zhvillim”.

Me kumtesa në Konferencë u paraqitën rreth 35 pjesëmarrës.

Konferenca i përfundoi punimet me sukses.

Kontributet autoriale të saj do të botohen në një vëllim të veçantë gjatë vitit 2019.

5. “Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, figurë e shekujve të humanizmit evropian” - konferencë shkencore ndërkombëtare.

Aktivitetet për shënimin e Vitit Jubilar Mbarëkombëtar për Gjergj Kastriotin – Skënderbeun kanë filluar që në muajt e parë të vitit 2018. Nga ASHAK-u, anëtarë të Komitetit shkencor ishin caktuar akademikët Rexhep Ismajli, Jusuf Bajraktari dhe anëtar i korrespondent Frashër Demaj, të cilët u janë përgjigjur ftesave dhe kanë marrë pjesë në shumicën e aktiviteteve përkatëse. Nga Kosova, me propozimin e këtij Komiteti, në aktivitetet shkencore kanë marrë pjesë 10 studiues të fushave të ndryshme. Nga ASHAK-u në Konferencën shkencore morën pjesë me kumtesa, akademik Anton K. Berishaj dhe anëtar i korrespondent Kujtim Shala, ndërsa me ligjërata speciale morën pjesë akademik Sabri Hamiti dhe akademik Zeqirja Ballata.

6. Dy konferencat e tjera shkencore, të parapara në Protokollin e bashkëpunimit ASHAK-ASHSH për vitet 2018-2020: “100-vjetori i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” dhe “110-vjetori i Kongresit të Manastirit”, nuk janë organizuar sipas programit, meqë organizatorët (ASHSH dhe Instituti për Trashëgimi Kulturorë i Shqiptarëve të Maqedonisë) nuk kanë hasur në mirëkuptimin dhe përkrahje të duhur të instancave të tyre shtetërore.

BOTIME

1. Ekrem Murtezai. - *"Filozofia e lashtë greke dhe romake"*.

Dorëshkrimi në fjalë përbëhet nga afro 30 tabakë autori dhe do të jetë i vetmi i këtij lloji në trevën e Kosovës.

Dorëshkrimi mbështetet në literaturën në gjuhën gjermane, angleze, ruse, kroate dhe serbe. Përmbajtja e dorëshkrimit përfshin një hyrje të shkurtër në filozofi, mitologji, shkenca të veçanta dhe "Shtatë të urtit grekë". Pastaj pason filozofia greke nga miletasit Talesi, Anaksimandri dhe Anaksimeni, më pas Pitagora dhe pitagorianët (Filolai, Arhita etj), si dhe çështja e lidhjes pitagoriane. Vend të veçantë zënë shkolla e Elesë dhe filozofia e përfaqësuesve të saj: Ksenofoni, Parmenidi, Zenoni dhe Melisi.

Një kaptinë e veçantë ka të bëjë me Heraklitin, me materializmin dhe dialektikën abstrakte të tij. Në dorëshkrim bëhet fjalë edhe për Epedoklen dhe Anaksagoren, si dhe për atomistët Leukipi dhe Demokriti. Pas këtyre filozofëve dhe çështjeve filozofike bëhet fjalë për Sokratin dhe shkollat sokratike; Platoni dhe platonistët. Aristoteli zë vend qendror në dorëshkrim. Bëhet fjalë edhe për Akademinë dhe akademistët, si dhe për Liceun e Aristotelit dhe nxënësit e tij, për materializmin e Epikurit dhe ithtarëve të tij. Në pjesën mbi helenizmin bëhet fjalë gjërësisht për skepticizmin dhe përfaqësuesit e tij.

Në pjesën e fundit të dorëshkrimit bëhet fjalë për filozofinë e lashtë romake dhe përfaqësuesit e saj si: Lukreci, Seneka dhe Mark Antoni. Dorëshkrimi mbërrin deri te Shën Augustini në shekullin V të epokës së re.

Dorëshkrimi pritet të finalizohet gjatë vitit 2019.

2. *Leksikon i vendbanimeve të Kosovës*

- qendrat urbane. - Vëllimi I. Grup autorësh.

Nga projekti afatmesëm "Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës - Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale" doli vëllimi i parë i botimit të leksikonit për qendrat urbane të Kosovës. Puna është përqendruar kryesisht te mbledhja e të dhënave dhe trajtimi i metropolit republikan industrialo-urban Prishtina (elementet fizike, rrjedhat historike, gjendja aktuale: evolucioni popullativ dhe komponentët bazë demografikë (rrita përmes imigrimit intensiv e të pakontrolluar), funksionet sekondare, terciare dhe kuartare; ndërtimi "i egër"); te gjashtë qendrat mezo-regionale dhe dimensionit fizionomik dhe funksional i tyre (Prizreni, Peja, Gjakova, Mitrovica, Ferizaji, Gjilani - urbanizimi primar dhe sekondar), si dhe te urbanitetet e vogla: vendbanimet e urbanizuara dhe suburbane (selitë komunale dhe vendbanimet pranëqytetëse si "dormitorij" për popullsinë e punësuar; pasojat e luftës së fundit etj.).

Në këtë vëllim janë përfshirë të dhënat e plota, themelore dhe të përgjithshme për evolucionin sasior dhe cilësor të vendbanimeve dhe të popullsisë urbane, të ekonomive familjare dhe të aspekteve të ndryshme të jetës ekonomike, si dhe dimensionit fizik, fizionomik, demografik dhe funksional i qendrave urbane në përgjithësi në tërë kompleksitetin e tyre, duke ndjekur një qasje dhe metodologji bashkëkohore profesionale-shkencore.

Libri është përfshirë në mjediset e Akademisë më 6 shtator 2018. Për botimin folën kryeredaktori akademik Hivzi Islami, recensenti akademik Anton K. Berishaj dhe prof. dr. Sabri Laçi nga Fakulteti Histori-Filologji i Universitetit Shtetëror të Tiranës, ekspert i njohur në fushën e gjeoshkencave.

Nga folësit u cilësua si botim që përmbushi një nevojë të madhe për gjeoshkencat, shkencat sociale dhe opinionin e gjerë lexues dhe shfrytëzues. Botimi do të jetë një trashëgimi e rëndësishme për shkencën dhe kulturën tonë në përgjithësi.

Në përfundim morën pjesë anëtarë të Akademisë, ekspertë nga shkencat gjeohapësinore, gjeografë, historianë, sociologë, urbanistë, planerë, ekonomistë dhe të interesuar të tjerë.

3. Gjyljeta Mushkolaj, ***“Dizajni kushtetues i qeverisjes lokale, e drejta e komunave në liri të asociimit dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje”***.

Dorëshkrimi është finalizuar për botim në muajin dhjetor të vitit 2017 dhe pjesa e fundit e librit e fokusuar në dialogun midis Prishtinës dhe Beogradit dhe ndikimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur me themelimin dhe me ndërtimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe është “testuar” para pjesëmarrësve të Simpoziumit Shkencor *Shteti i Kosovës dhe sfidat e ndërtimit të tij - rasti i Kosovës dhe i Shqipërisë*, të organizuar nga ASHAK, në një version adekuat për simpozium me titull “Sfidat kushtetuese të zbatimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Republikën e Kosovës.”

Duke qenë se menjëherë pas finalizimit të dorëshkrimit, zbatimi i dokumentit dhjetëpikësh i nënshkruar nga përfaqësuesit e Kosovës dhe të Serbisë e kishte përmbysur plotësisht të ashtuquajturin “proces të normalizimit” të marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit, kjo pjesë e fundit e librit mbet e hapur, meqenëse në prill të vitit 2018 presidentët e të dy vendeve e hapën idenë e përmbylljes së konfliktit midis Kosovës dhe të Serbisë me shkëmbim të territoreve. Çuditërisht, shtetet sponsorizuese të pavarësisë së Kosovës edhe pse nuk dukej se e konsideronin idenë si të shkëlqyer dhe në përgjithësi përgjigjet shkonin nga pranimi i hidhur i asaj ideje e deri në përbuzje të tronditur, lejuan që një ide e tillë të mbetet në agjendë të tyre.

Fatkeqësisht, asnjëra anë e debatit nuk i kushtoi shumë rëndësi asaj që duhej të ishte çështje qendrore: Si do të ndikojnë ndryshimet e propozuara në jetën e atyre që banojnë në zonat në diskutim, e që është bazë e modelit evropian për mbrojtjen e pakicave kombëtare, të inkuorporuara tërësisht në Kushtetutën e Kosovës.

Sido që të zhvillohen ngjarjet, dorëshkrimi është finalizuar dhe pjesa e fundit e librit është përmbyllur me një debat të munguar edhe në qarqet akademike e edhe në ato të politikëbërësve, se sa do të ndikojë madje vetëm ideja për këmbim të territoreve në vetë vlerat evropiane për qeverisje lokale, e që është në të njëjtën kohë edhe bazament i të dy strukturave të Evropës - Unionit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Dorëshkrimi pritet të dorëzohet së shpejti për t'u përgatitur për shtyp.

4. Revista **"Studime shoqërore"** nr. 4. - Revista në të cilën përfshihen studime dhe artikuj shkencorë, tekste ligjëratash inauguruese, vështrime, recensione e kritika etj. nga disiplinat e shkencave shoqërore është publikuar në faqen ueb të ASHAK-ut, ndërsa në dhjetor revista ka dalë nga shtypi dhe është shpërndarë sipas rregullave përkatëse.

Revista **"Studime shoqërore"** nr. 5 pritet të finalizohet në pjesën e parë të vitit 2019.

Sekretare e Seksionit,
Anëtare korrespondente Justina Pula, d.v.

SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

PROJEKTE

1. **Fjalori enciklopedik i Kosovës.** –

Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut. U dorëzua në shtyp në pjesën e parë të 2018-ës. Doli nga shtypi nga mesi i vitit dhe u përrurua më 25 shtator 2018. U mbyll një fazë e punës që zgjati rreth 5 vjet dhe tashmë Fjalori enciklopedik i Kosovës është në qarkullim. Pritet funksionalizimi i një redaksie, e cila do të merrej me evidentimin e lëshimeve eventuale apo me plotësimin me zëra të tjerë deri në ribotimin e tij.

TUBIME SHKENCORE

2. **"Materialet kompozita".** - Tryezë shkencore. Bartës i aktivitetit anëtar i korrespondent Fetah Podvorica.

Tryeza është mbajtur më 6 prill 2018 dhe ka përfunduar punimet me sukses. Ajo ka vënë në pah rëndësinë shumë të madhe të përdorimit të materialeve kompozita në jetën e përditshme, duke nxitur bashkëpunimin ndërdisiplinar ndërmjet hulumtuesve shkencorë të lëmenjve të ndryshëm në nivel vendi dhe më gjerë.

Në këtë tryezë, ndër të tjera, është diskutuar për llojet e ndryshme të materialeve kompozita, strukturën dhe vetitë e tyre, përfitimn ei materialeve kompozita, zbatimin e tyre në degë të

ndryshme të teknologjisë dhe industrisë, ndikimin e materialeve kompozita në mjedis, riciklimin e tyre etj.

Këshilli organizues i tryezës në përbërje prej anëtarëve korrespondentë Fetah Podvorica dhe Myzafere Limani ka bërë përgatitjet e nevojshme, ndërsa me kumtesat e tyre janë paraqitur: Prof. Fetah Podvorica; prof. Jean Pinson (Francë); prof. Indrit Vozga dhe Jorgaq Kaqani (Shqipëri), prof. dr. Salih Gashi; prof. Ardian Morina (Angli), prof. Hysni Osmani, prof. Naser Kabashi, prof. asoc. Dashnor Nebija, prof. ass. Avni Berisha; dr. Dardan Hetemi dhe dr. Flamur Sopaj.

Promovimi i tryezës është bërë edhe përmes mediave të shkruara dhe elektronike, ndërsa RTK e ka dhënë një intervistë drejtpërdrejt të kryetarit të këshillit organizativ të tryezës në emisionin e mëngjesit, kurse Ekonomia Online ka bërë xhirime gjatë gjithë seancës së parë.

Kontributet autoriale të tryezës janë bërë gati dhe do të botohen në një vëllim të veçantë.

BOTIME

1. Fejzullah Krasniqi e Rexhep Selimaj, “Komforti termik”. - Me kërkesën e autorëve ky botim shtyhet për vitin 2019.

2. Revista “Resarch - Kërkime” nr. 23. - Revista është botuar kësaj radhe në

gjuhën angleze. Në të janë përfshirë 6 punime shkencore. Është publikuar në faqen ueb të Akademisë në prill të këtij viti dhe ditëve në vijim pritet të dalë edhe në kopje fizike në letër.

Numri 24 i kësaj reviste pritet të dalë në fillim të vitit 2019.

Sekretari i Seksionit,
Anëtar korrespondent Fetah Podvorica,
d.v.

SEKSIONI I ARTEVE

PROJEKTE

1. Fjalori enciklopedik i Kosovës. – Projekt i përbashkët i të gjitha seksioneve të ASHAK-ut. U dorëzua në shtyp në pjesën e parë të 2018-ës. Doli nga shtypi nga mesi i vitit dhe u promovua me 25 shtator 2018. U mbyll një fazë e punës që zgjati rreth 5 vjet dhe tashmë Fjalori enciklopedik i Kosovës është në qarkullim. Pritet funksionalizimi i një redaksie, e cila do të merrej me evidentimin e lëshimeve eventuale apo me plotësimin me zëra të tjerë deri në ribotimin e tij.

AKTIVITETE SHKENCORE DHE ARTISTIKE

1. Tryezë shkencore dhe ekspozitë personale e akademik Muslim Mulliqit.

Tryeza shkencore dhe ekspozita janë mbajtur më 19 shtator 2018. Tryeza filloi punimet në orën 11:00 dhe atë e

shpalli të hapur anëtari korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve, ndërsa me kumtesat e tyre u paraqitën Brane Kovič nga Sllovenia, Suzana Varvarica - Kuka dhe Abaz Hado nga Shqipëria, si dhe Hivzi Muharremi nga Kosova. Pas tryezës u përrua edhe libri “Muslim Mulliqi - Monografi”, botim i ASHAK-ut, me autor Brane Kovič. Në orët e mbrëmjes në një atmosferë të këndshme u hap Ekspozita e akademik Muslim Mulliqit. Atë e hapi anëtari korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve, ndërsa me fjalë rasti para pjesëmarrësve u paraqit akademik Rexhep Ferri, i cili në fjalën e tij e vlerësoi lart veprën dhe figurën e Muslim Mulliqit.

2. Ekspozita personale e akademik Tahir Emra me rastin e 80-vjetorit të lindjes dhe 60-vjetorit të krijimtarisë artistike. Ekspozita është hapur më 20 nëntor, nën përkujdesjen e kuratorit Kujtim Buza. Në të u përfshinë shumë punime të cikleve të ndryshme të krijimtarisë së autorit. Ekspozitën e shpalli të hapur anëtari korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve, ndërsa profesor Kujtim Buza mbajti një fjalë rasti, duke e vlerësuar lart krijimtarinë e akademik Emrës. Në fund autori falënderoi Akademinë për organizimin e Ekspozitës dhe të gjithë pjesëmarrësit.

ASHAK-u ka botuar edhe Katalogun, i cili u është ndarë pjesëmarrësve të Ekspozitës dhe vizitorëve të shumtë.

Ekspozita qëndroi e hapur për një muaj.

3. Ekspozitë e përbashkët e artistëve akademikë në Vjenë. Ekspozita nuk ka arritur të organizohet këtë vit. Do të bëhen përpjekje që të realizohet në të ardhmen.

KONCERTE

1. Koncert për piano i akademik Rauf Dhomit me veprat, duke filluar nga sonata, scherco, fugar, aria, etj. Koncerti nuk është mbajtur për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Sekretari i Seksionit,
Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, d.v.

SHËRBIMI ADMINISTRATIV, PROFESIONAL E TEKNIK

Shërbimi administrativ, profesional e teknik (SHPAT) i ASHAK-ut, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale, administrative e teknike u angazhua dhe punoi në realizimin e Programit të punës të Akademisë.

DEPARTAMENTI PËR BUXHET DHE FINANCA – DBF

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2018 për ASHAK-un ishte në vlerë totale prej 1.240.364,00 €. Në kategorinë paga e mëditje janë 825.421,00 €, në kategorinë mallra e shërbime 384.943,00 €, në kategorinë

shpenzime komunale janë 5.000,00 € dhe në kategorinë e shpenzimeve kapitale janë 25.000,00 €.

Përpos mjeteve nga Fondi i Buxhetit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, ASHAK-u ka pasur depozita mjjetesh nga Donatori Salbating Internacional, të bartura nga viti 2017, fond i cili për vitin 2018 ishte në vlerë totale prej 8.636,99 €.

Njëherësh gjatë vitit 2018 janë grumbulluar të hyra qeveritare nga shitja e botimeve në vlerë prej 15.388,50 €.

Departamenti i Përkrahjes Profesionale dhe i Teknologjisë së Informacionit e Komunikimeve – DPPTIK

Departamenti i Përkrahjes Profesionale dhe i Teknologjisë së Informacionit e Komunikimeve, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale të teknologjisë së informacionit e komunikimeve dhe veprimtarisë botuese, gjatë vitit 2018 kreu këto punë:

- Përpunoi rreth 874,68 tabakë shtypi (11.292 faqe) dhe organizoi botimin e 34 titujve të librave e publikimeve me rreth 14.095 kopje, si dhe përgatiti për shtyp 5 tituj të tjerë me rreth 3500 faqe, të gatshëm për t'u botuar në vitin 2019;

- Përditësoi vazhdimisht regjistrin e veprimtarisë botuese;

- Ndërlidhur me veprimtarinë botuese, aktivitetet e së cilës i përkrahu

drejtpërsëdrejti dhe për shërbimet e tjera teknike, ia doli të angazhojë 70% ose 260.132,6 të gjithë buxhetit të ASHAK-ut në kategorinë Mallra dhe shërbime.

- Përkrahu profesionalisht punën e Akademikëve dhe të Administratës;

- Në bashkërenditje me shërbimet e tjera të ASHAK-ut përkrahu profesionalisht drejtpërsëdrejti 15 (pesëmbëdhjetë) aktivitete akademike e shkencore (konferenca, tubime, tryeza shkencore, ekspozita, takime mes akademive, panaire librash, ligjërata, etj.);

- Përgatiti specifikimet teknike dhe inicoi 14 aktivitete prokurimi, gjegjësisht 42% të të gjitha kërkesave të prokurimit të ASHAK-ut dhe menaxhoi kontratat të cilat kishin të bëjnë me aktivitetet e DPPTIK;

- Përkrahu profesionalisht projektin Shqipja e shkruar e shek. XX, projektin e Vendbanimeve, si dhe projektin e Fjalorit enciklopedik;

- Përgatiti projektpropozimin për Sistemin e Zërimit të ASHAK-ut dhe e bëri mbindërtimin dhe rregullimin e sistemit të vëzhgimit të ASHAK-ut;

- Vazhdoi me organizimin dhe rregullimin e depos së Librit si dhe të materialit tjetër harxhues të nevojshëm për funksionimin normal të Administratës dhe të Akademisë;

- Mbikëqyri dhe u përkujdes për funksionimin normal të shërbimeve të TIK-ut dhe të Multimedieve, si dhe për funksionimin normal të faqes ueb duke e populluar atë me të dhënat e përditësuara;

- Organizoi dhe mbikëqyri edhe mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të shërbimeve logjistike për Administratën dhe Akademinë;

- Mori pjesë në përgatitjen e rregulloreve të nevojshme për punën e ASHAK-ut;

- Mori pjesë në të gjitha aktivitetet profesionale si: nëpër komisione profesionale, të rekrutimit, të pranimit të mallit, të përcaktimit të cilësisë etj.

- Vazhdoi punën pa zyrtarin e TI-së për përkrahje, dhe pa zyrtarin e logjistikës, punë të cilat u mbuluan nga vetë ekipi i DPPTIK-ut.

DEPARTAMENTI I BIBLIOTEKËS DHE I ARKIVIT - DBA

Gjatë vitit 2018 kanë vazhduar aktivitetet e rregullta që lidhen me menaxhimin, mirëmbajtjen dhe riorganizimin e bibliotekës. Është aranzhuar dhe mirëmbajtur fondi bibliotekar dhe ka përfunduar regjistrimi i të gjithë librave ekzistues dhe atyre të blerë apo të pranuar si dhuratë në ndërkohë. Ka vazhduar regjistrimi dhe rikuperimi i fondit të mbetur të librave dhe revistave.

Botimet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës janë prezantuar

në pesë panairë: Panairin e Prishtinës, Panairin e Tiranës, Panairin e Shkupit, Panairin e Frankfurtit dhe Panairin e Salon de Livre të Parisit. Në tri të parat botimet e ASHAK janë prezantuar nga personeli i ASHAK, ndërsa në panairin e Frankfurtit dhe të Parisit nga Shoqata e Botuesve të Kosovës.

Biblioteka e ASHAK-ut është pasuruar me një numër të konsiderueshëm botimesh (gjithsej 958) përmes blerjes, këmbimit dhe dhurimit nga autorët dhe me një numër të konsiderueshëm të revistave.

Ka vazhduar komunikimi me biblioteka të akademive të ndryshmen dhe me institucionet kosovare e të vendeve të rajonit dhe më gjerë për të zgjeruar bashkëpunim dhe këmbimin e botimeve.

Në përputhje me Rregulloren mbi veprimtarinë botuese të ASHAK dhe sipas kërkesave drejtuar ASHAK-ut janë dhuruar mbi 1500 botime të ASHAK.

Ka vazhduar dërgimi i botimeve të ASHAK në Bibliotekën e Kongresit Amerikan (BKA).

Gjatë vitit është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me institutin IZUM nga Sllovenia sipas së cilës ASHAK-ut i mundësohet aplikimi falas i programit COBISS.

Sekretare e Akademisë,
Lendita Pula, d.v.

RAPORTI I PERFORMANCËS FINANCIARE PËR VITIN 2018

Mjetet e ndara dhe të aprovuara, sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2018, për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, kanë qenë në vlerë prej **1,240,364.00 €** si total në të gjitha kategoritë ekonomike. Buxheti me ndryshime gjatë vitit, sipas kategorive ekonomike, pasqyrohet në tabelat e mëposhtme:

Buxheti fillestar sipas Ligjit të Buxhetit është i pasqyruar si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investimet kapitale	Subvencionet dhe transferet	Gjithsej
825,421.00	384,943.00	5,000.00	25,000.00	0.00	1,240,364.00

Buxheti përfundimtar i alokuar është i pasqyruar si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investimet kapitale	Subvencionet dhe transferet	Gjithsej
831,132.41	384,943.00	3,731.45	25,000.00	0.00	1,244,806.86

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2018 ka pasur ndryshime në fund të vitit me Vendimin e Qeverisë nr:07/80 të datës 18.12.2018, në vlerë totale prej 4,442.86 €, ku në kategorinë e paga e mëditje janë shtuar mjete financiare në vlerë prej 5,711.41 për mbulimin e pagave të rregullta mujore, dhe në emër të kursimeve janë përvetësuar mjetet financiare në kategorinë e shpenzimeve komunale në vlerë prej 1,268.55 €, prandaj si rezultat i këtyre ndryshimeve buxheti përfundimtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës për vitin fiskal 2018 ka qenë i alokuar në vlerë totale prej 1,244,806.86 €.

BUXHETI I APROVUAR ME LIGJIN E BUXHETIT PËR VITIN 2018 ALOKIMI DHE REALIZIMI PËR PERIUdhËN JANAR – DHJETOR

Kategoritë ekonomike	Buxheti i aprovuar 2018 (A)	Buxheti me Vendimin e Qeverisë (B)	Alokimet Janar – Dhjetor (C)	Realizimet Janar – Dhjetor (D)	% (D/C)
Paga dhe mëditje	825,421.00	831,132.41	831,132.41	831,132.41	100%
Mallra dhe shërbime	384,943.00	384,943.00	384,943.00	384,909.93	99.99%
Shpenzime komunale	5,000.00	3,731.45	3,731.45	3,187.78	85.43%
Investimet kapitale	25,000.00	25,000.00	25,000.00	24,698.76	98.80%
Gjithsej	1,240,364.00	1,244,806.86	1,244,806.86	1,243,928.88	99.93%

Vlera fillestare sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2018 ka qenë 1,240,364.00€, kurse buxheti i alokuar në të gjitha kategoritë ekonomike në fund të vitit 2018 ka qenë në vlerë totale prej 1,244,806.86 €. Megjithatë dinamika e shpenzimeve nuk është bërë sipas planit fillestar të rrjedhjes së parasë, për shkaqe objektive.

Alokimet e mjeteve nga buxheti i konsoliduar i Kosovës sipas Planit të rrjedhës së parasë për periudhën janar – dhjetor 2018

Mjetet e alokuara në periudhën janar – dhjetor kanë qenë në vlerë prej **1,244,806.86 €**, ose e shprehur në përqindje 100.36% krahasuar me buxhetin e aprovuar.

	janar- shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Gjithsej
Paga dhe mëditje	627,906.92	67,741.83	67,741.83	67,741.83	831.132.41
Mallra dhe shërbime	358,000.00	20,000.00	4,943.00	2,000.00	384,943.00
Shpenzime komunale	4,200.00	400.00	200.00	-1068.55	3,731.45
Shpenzimet kapitale	25,000.00	0.00	0.00	0.00	25,000.00
Gjithsej	1,015,106.92	88,141.83	72,884.83	68,673.28	1,244,806.86

REALIZIMI I BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2108

Realizimi i buxhetit në bazë të alokimit vjetor ka qenë **1,243,928.88€**, shprehur në përqindje 99.93 % i buxhetit të alokuar.

Realizimi i buxhetit pasqyrohet si në vijim:

Kategoritë ekonomike	Alokimet Janar – Dhjetor (A)	Realizimi Janar – Dhjetor (B)	Ndryshimi (C)	% (B/A)
Paga dhe mëditje	831,132.41	831,132.41	0.00	100%
Mallra dhe shërbime	384,943.00	384,909.93	33.07	99.99%
Shpenzime komunale	3,731.45	3,187.78	543.67	85.43%
Shpenzimet kapitale	25,000.00	24,698.76	301.24	98.80%
Gjithsej	1,244,806.86	1,243,928.88	877.97	99.93%

Paga dhe mëditje

Mjetet e alokuara për paga dhe mëditje për vitin 2018 janë në vlerë prej **831,132.41 €**, shprehur në përqindje 100.00 % i buxhetit të aprovuar, ndërsa numri i aprovuar për personelin e ASHAK-ut është 55.

Alokimi

Kategoria ekonomike	janar - shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Gjithsej	%
Paga dhe mëditje	627,906.92	67,741.83	67,741.83	67,741.83	831,132.41	100.00%

Realizimi

Muaji	Numri i punëtorëve	Buxheti	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Ndryshimi (A-B)
Janar	55	68,265.55	68,265.55	68,265.55	0.00
Shkurt	55	68,505.38	68,505.38	68,505.38	0.00
Mars	55	70,938.33	70,938.33	70,938.33	0.00
Prill	55	68,523.12	68,523.12	68,523.12	0.00
Maj	55	68,523.12	68,523.12	68,523.12	0.00
Qershor	55	70,757.72	70,757.72	70,757.72	0.00
Korrik	55	68,872.62	68,872.62	68,872.62	0.00
Gusht	55	75,803.04	75,803.04	75,803.04	0.00
Shtator	55	67,718.04	67,718.04	67,718.04	0.00
Tetor	55	67,741.83	67,741.83	67,741.83	0.00
Nëntor	55	67,741.83	67,741.83	67,741.83	0.00
Dhjetor	55	67,741.83	67,741.83	67,741.83	0.00
Gjithsej	55	831,132.41	831,132.41	831,132.41	0.00

Mallra dhe shërbime

Mjetet e alokuar për mallra dhe shërbime për vitin 2018 janë në vlerë prej 384,943.00 €. Alokimi i mjeteve për mallra dhe shërbime për periudhën janar-dhjetor 2018 përbën 100.00 % të buxhetit të aprovuar.

Alokimi

Kategoria ekonomike	Janar - shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Gjithsej	%
Mallra dhe Shërbime	358,000.00	20,000.00	4,943	2,000.00	384,943.00	100%

Realizimi

Nr.	Muaji	Buxheti	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Zotim Obligimet e hapura (C)	Ndryshimi (A-B)
1	Janar	50,000.00	50,000.00	52,517.10	10,338.54	-12,855.64
2	Shkurt	70,000.00	70,000.00	22,452.63	20,395.85	27,151.52
3	Mars	40,000.00	40,000.00	36,190.83	-7,169.12	10,978.29
4	Prill	25,000.00	25,000.00	25,905.99	7,824.91	-8,730.90
5	Maj	40,000.00	40,000.00	19,174.60	5,796.92	15,028.48
6	Qershor	28,000.00	28,000.00	38,378.51	-12,388.74	2,010.23
7	Korrik	35,000.00	35,000.00	40,163.88	-5,834.13	670.25
8	Gusht	10,000.00	10,000.00	8,289.31	-4353.99	6,064.68
9	Shtator	60,000.00	60,000.00	47,928.89	10,212.85	1,858.26
10	Tetor	20,000.00	20,000.00	45,576.73	-3,903.38	-21,673.35
11	Nëntor	4,943.00	4,943.00	36,706.21	-9,653.81	-22,109.40
12	Dhjetor	2,000.00	2,000.00	11,625.25	-11,265.90	1,640.65
	Total	384,943.00	384,943.00	384,909.93	0.00	33.07

Shpenzimet për shërbimet komunale

Buxheti për shpenzime komunale për vitin 2018 është 5,000.00€. Alokimi i mjeteve për shpenzime komunale për periudhën janar-dhjetor 2018 përbën 74.63 % të buxhetit të aprovuar.

Alokimi

Kategoria ekonomike	janar-shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Gjithsej	%
Shpenzime komunale	4,200.00	400.00	200.00	-1,068.55	3,731.45	74.63%

Realizimi ¹

Nr.	Muaji	Buxheti	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Ndryshimi (A-B)
1	Janar	500.00	500.00	253.41	246.59
2	Shkurt	700.00	700.00	254.65	445.35
3	Mars	400.00	400.00	300.07	99.93
4	Prill	500.00	500.00	75.91	209.71
5	Maj	400.00	400.00	214.38	400.00
6	Qershor	500.00	500.00	0.00	500.00
7	Korrik	400.00	400.00	857.57	-457.57
8	Gusht	400.00	400.00	0.00	400.00
9	Shtator	400.00	400.00	480.82	-80.82
10	Tetor	400.00	400.00	238.89	161.11
11	Nëntor	200.00	200.00	261.85	-312.08
12	Dhjetor	-1,068.55	-1,068.55	250.23	-1068.55
	Gjithsej	3,731.45	3,731.45	3,187.78	543.67

Donacionet – Grantet e donatorëve

Alokimi

Emri i donatorëve	Totali i grantit	Alokimi	Realizimi	Mjetet e lira	%
Salbatring International	4,636.99	4,636.99	0.00	4,636.99	0.00 %
Salbatring International	4,000.00	4,000.00	0.00	4,000.00	0.00 %
Gjithsej	8,636.99	8,636.99	0.00	8,636.99	0.00 %

Përpos mjeteve nga Fondi i Buxhetit të Republikës së Kosovës, ASHAK, ka pasur donacionin e bartur nga viti 2017 nga Salbatring Internacional, në vlerë totale prej 8,636.99, fond i cili për vitin 2018 ka qenë i ndarë në kategorinë e mallrave e shërbimeve për blerjen e librave në kodin 13510 në vlerë prej 4,636.99€ dhe në kategorinë e subvencioneve për ndarjen e shpërblimit mbështetës kodin 22200 në vlerë prej 4,000.00 €. ASHAK-u ka realizuar edhe të hyra jo tatimore nga shitja e botimeve, të cilat janë depozituar drejtpërsëdrejti në llogarinë e vetme të Thesarit për përdorim sipas paraqitjes së nevojave për paranë publike. Realizimi i buxhetit në shkallën 99.93 % tregon performancë jashtëzakonisht të mirë.

Raportin e përgatiti:

Drejtoreshë e Departamentit për Buxhet e Financa, Vjollca Ejupi Hykolli.

¹ Shpenzimet e komunaleve nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës janë bërë vetëm në kodin e telefonisë fikse, shpenzimet e tjera komunale i mbulon Ministria e Administratës Publike.

PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2019



PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2019

SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

PROJEKTE

1. Këshilli Ndërkademi për Gjuhën Shqipe. – Veprimtaria e Këshillit Ndërkademi për Gjuhën Shqipe mbetet edhe më tutje në programin e bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH dhe është përfshirë në Protokollin për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor midis dy akademive për periudhën 2018-2020, në të cilin është shënuar: Përgatitja për botim e akteve të veprimtarisë së Këshillit Ndërkademi për Gjuhën Shqipe dhe vijimi i punës së mëparshme. Puna e Këshillit në të vërtetë ka ecur me ritme të ngadalshme, apo ka stagnuar, edhe pse është konsideruar se kanë mbetur shumë çështje për t'u diskutuar. Në planifikimin e vitit të kaluar kemi shënuar: "Këshilli është duke e përmbyllur aktivitetin dhe pritet përgatitja e materialeve për botim, të cilat mund të finalizohen gjatë 2018-ës". Nga Protokollin e ri i nënshkruar nga të dy akademitë kërkohet vijim i punës së mëparshme.

2. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX. – Projekti kishte paraparë që brenda vitit 2017 të finalizohet puna rreth botimit Leksiku shqip i revistës "Përparimi", 1955-1968. Dorëshkrimi

(rreth 1000 fq.) është i përgatitur. Mund të dalë brenda vitit 2018 (?). Të kujtojmë se më 2016 nga ky projekt qe botuar Fjalësi shqip i lematizuar i Fjalorit serbokroatisht-shqip të S. Dobroshit i v. 1953. Skanimi, digjitalizimi i materialeve dhe puna rreth Korpusit ka kërkuar angazhime të gjera, me specialistë të fushave dhe kompletimin e kushteve teknike. Mund të thuhet se janë kapërcyer disa nga vështirësitë rreth aftësisë teknike e profesionale të Qendrës Leksikografike Enciklopedike, para së gjithash me sigurimin e skanerit me performanca të sofistikuar dhe vënien e tij në punë. Gjatë vitit 2018 nuk janë angazhuar kuadrot që merreshin me drejtimin e punëve, të cilëve u skadoi kontrata në fund të 2017-ës. Për vitin 2019 duhet të vazhdohet puna dhe të pranohet kuadri i kualifikuar që do ta shpjerë më tutje këtë projekt afatgjatë.

3. Vepra e plotë e Norbert Joklit. – Vepra e albanologut austriak Norbert Jokl vazhdon të kompletohet, përkundër vështirësive në mbledhjen dhe sistemimin e materialeve, përkushtimin që të botohet paralelisht në shqip dhe në origjinal - gjermanisht. Deri tani kanë dalë dy vëllime: Studim për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip / Studien zur Albanischen Etimologie und Wortbildung, (2011), përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli dhe Studime historiko-krahasuese për gjuhën shqipe / Historisch-Vergleichende untersuchungen über

das Albanische (2017) përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli dhe prof. dr. Heiner Eichner nga Akademia Austriake. Gjatë vitit 2018 do të botohet vëllimi i tretë Hulumtime linguistike – kulturo-historike në fushë të shqipes, i përkthyer nga Skënder Gashi. Botimi duhet të shkojë në shtyp në pjesë e dytë të vitit 2018. Kontakti me Akademinë e Shkencave të Austrisë, me të cilën kemi bashkëpunuar deri tash, do të na ndihmojë të vazhdojmë projektin me mbledhjen, sistemin dhe botimin e kontributeve të tjera të Joklit.

4. Korpusi i shqipes së folur në Kosovë. Projekti i krijimit të një korpusi të folur të shqipes në Kosovë, që nënkupton mbledhjen e materialeve gjuhësore të folura nëpër të gjitha viset e Kosovës dhe që iu shërben studiuesve në fushë të gjuhësisë në radhë të parë, por edhe në fusha të tjera, si antropologjia e sociologjia, është iniciuar nga fundi i vitit 2017 dhe është inkuadruar në programin e vitit 2018. Krahas materialit të regjistruar korpusi përfshin të dhënat (brendafolëse) të respondentëve: mosha, gjinia, shkollimi, profesioni, njohja e gjuhëve të tjera, lëvizja nga vendbanimi dhe kontaktet me të folmet e tjera. Për këtë projekt ekziston një program i detajuar që ishte dorëzuar kur u planifikua programi i punës së Seksionit për vitin 2018. Korpusi shërben për matje kuantitative në fushën e fonetikës e të fonologjisë, të morfologjisë e të sintaksës si dhe të leksikut e të sociolinguistikës. Materialet e mbledhura do të klasifikohen sipas

zonave, statuseve shoqërore, moshës, shkollimit, gjinisë dhe mund të transkribohen për lehtësim studimi. Deri tash, në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Filologjisë dhe të Universitetit të Humboldt (Berlin), ka pasur trajnim të kuadrit që do të angazhohet në këtë projekt. Një pjesë e tij do të dërgohet në Berlin (4-10 qershor 2018) për aftësime të mëtejshme. Një mostër testuese prej disa dhjetëra intervistash janë mbledhur, por nuk janë sistemuar. Faza e parë e projektit pritet të përfundojë në fund të dhjetorit të vitit 2018. Projekti do të vazhdohet gjatë vitit 2019.

5. Fjalor enciklopedik i gjuhësisë (titull pune). - Krijimi i një Fjalori të gjuhësisë me vështirim enciklopedik, duke e pasur në rend të parë gjuhësinë shqiptare, është thënë se do të ndihmonte për normëzimin e terminologjisë së gjuhësisë në gjuhën shqipe. Është inkuadruar në programin e punës për vitin 2018. Rëndësia e një projekti të tillë do të ishte, para së gjithash, shpjegimi dhe interpretimi i termave të gjuhësisë. Duke i pasur brenda vetes termat e fushave të ndryshme të gjuhësisë, Fjalori do të shërbente si mjet i rëndësishëm për studentët, studiuesit dhe të interesuarit e tjerë. Fjalori parashihet të realizohet sipas këtyre fushave: a. fonetikë, b. studime sociolinguistike dhe gjuhësi e tekstit, c. gramatikë. Fjalorët e fushave të veçanta janë autorialë, ndaj edhe botohen veç e veç për çdo fushë. Bartës të projektit janë Rexhep Ismajli

dhe Bardh Rugova. Në këtë fazë ka përfunduar Fjalori i Fonetikës me më se 400 terma dhe vëllim prej afër 200 faqesh të formatit të botimit. Fjalori i studimeve sociolinguistike dhe funksionale është më i vëllimshëm. Janë hartuar afër 2000 terma. Pritet ta arrijë afatin e paraparë të përfundimit në fund të dhjetorit 2018. Fjalori i fonetikës mund të parashihet për botim më 2019.

TUBIME SHKENCORE

1. Studimet albanistike në Itali, konferencë shkencore. Në vazhdimësi të dy konferencave të rëndësishme shkencore, Studimet albanistike në Amerikë, që u mbajt në vitin 2015 dhe Studimet për shqipen në vendet ku flitet gjermanisht, e realizuar gjatë vitit 2017, pothuaj me distancë të njëjtë kohore, planifikohet edhe konferenca shkencore për studimet albanistike në Itali, me shumë interes jo vetëm për praninë e arbëreshëve, për kulturën, letërsinë dhe studimet albanologjike dhe albanistike, por edhe për rezultatet e shumë studiuesve italianë të gjuhës shqipe në radhë të parë, por edhe të letërsisë, antropologjisë dhe kulturës shqiptare në përgjithësi. Italia është vendi me më së shumti qendra studimi të shqipes, katedra universitare që kanë përgatitur personel, pedagogë e studiues dhe që kanë realizuar projekte të rëndësishme studimi. Rezultatet që u arritën në dy konferencat e përmendura, interesimi i madh i atyre që morën pjesë dhe rëndësia e kontributeve që u sollën na shtojnë

bindjen se edhe ky aktivitet, jo më pak i rëndësishëm se dy të parët, meriton të jetë pjesë e programeve të ASHAK-ut.

2. Për epistologjinë e shkencave albanologjike sot, konferencë shkencore. Program i propozuar në Protokollin për Zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor Shkencor midis ASHAK dhe ASHSH nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë për organizim të përbashkët. Konferenca do të mbahet në Tiranë.

BOTIME

1. Romani shqiptar, fillimi i shekullit XXI. Materialet e Konferencës shkencore që do të mbahet në mesin e muajit tetor 2018, organizuar nga ASHAK dhe ASHSH si pjesë e Protokollit për bashkëpunim midis dy akademive. Konferenca ka ftuar kritikë, studiues e dijetarë të letërsisë për të vështruar romanin e fillimit të shekullit XXI, dy dekadat e fundit, që konsiderohen boshti më dinamik i zhvillimit të tij. Nga koncepti i paraparë i kësaj Konference, mund të thuhet se është me shumë interes botimi i materialeve, kumtesave të rreth 20 e më shumë pjesëmarrësve që do të paraqiten në këtë Konferencë.

2. Materialet e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe. – Siç parashihet në Protokollin për Zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-shkencor midis ASHAK dhe ASHSH për vitet 2018-2020, Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe do të

vijojë punën dhe në plan të parë ka përgatitjen për botim të akteve të veprimtarisë së këtij Këshillit. Meqenëse gjatë vitit 2018 nuk ishte paraparë botimi i materialeve të Këshillit, mbledhja, sistemimi dhe përgatitja për shtyp e tyre do të kryhet gjatë vitit 2019, kur planifikohet të realizohet botimi.

3. Kujtim Shala, ***Ut heri dicebamus*** (titull pune). Dorëshkrimi ka për objekt trajtimi veprën e Zef Pllumit, me disa kapërcime të çështjes së kulturës e të jetës sociale të shqiptarëve, që librit i jep status monografie. Dorëshkrimi përbëhet nga 250 faqe dhe është i kryer. Mund të parashihet për botim në pjesën e parë të vitit 2019.

4. ***Fjalor enciklopedik i gjuhësisë*** - Fjalori enciklopedik i fonetikës me më se 400 terma dhe me vëllim prej afër 200 faqesh të formatit të botimit tashmë ka përfunduar dhe është i gatshëm për botim. Kompletimi i tij, i parashikuar më 30 qershor 2018, ka përfunduar dy muaj më herët. Botimi mund të realizohet brenda vitit 2018, por nga dinamika e realizimit të botimeve tjera të këtij viti duket se është më mirë të parashihet në gjashtëmujorin e parë vitin 2019. Fjalori i studimeve sociolinguistike dhe funksionale, ndërkaq, është më i vëllimshëm. Janë hartuar afër 2000 terma. Pritet ta arrijë afatin e paraparë të përfundimit kah fundi i dhjetorit 2018 dhe do të jetë i gatshëm për botim gjithashtu në vitin 2019.

5. Revista “Studime” nr. 26. – Në kohën e hartimit të këtij Programi për vitin 2019, nr. 25 i revistës “Studime”, që boton Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, realizuar nga redaksia e re me kryeredaktor akademik Zejnullah Rahmanin është përfunduar. Redaksia bën përgatitjet për nr. 26, me kontribute, studime shkencore e artikuj nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë, në shqip dhe në gjuhë të tjera, me recensione, kronika dhe paraqitje botimesh të reja. Numri pritët të dorëzohet në muajt e fundit të vitit 2018.

Sekretari i Seksionit
Akademik Eqrem Basha, d.v.

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

PROJEKTE

1. Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës - Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale. - Projekt afatmesëm, faza vijuese.

Në mbledhjen e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të mbajtur më 30. 6. 2016 është miratuar projekti afatmesëm “Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës - Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale”. Para kësaj, projekti ideor është shqyrtuar në Grupin e punës, pastaj në Seksionin e Shkencave Shoqërore dhe në Kryesi të Akademisë. Gjatë vitit 2017 një numër i

madh bashkëpunëtorësh (ekspertë nga shkencat gjeohapësinore, nga sociologë, urbanistë, planerë, ekonomistë, demografë, historianë, etnologë, administratorë komunalë etj.) ka punuar intensivisht në mbledhjen e të dhënave empirike dhe në sistemimin e materialit të vjelur në terren për karakteristika të ndryshme gjeografike, mjedisore, historike, arkeologjike, demografike, ekonomike, kulturore etj. Më 6 maj 2017 është mbajtur edhe një punëtori për këtë qëllim në mjediset e Akademisë. Puna e fazës së parë rezulton me përgatitjen për botim të vëllimit të parë me titull “Qendrat urbane”.

Gjatë vitit 2018 si dhe gjatë vitit 2019 do të vazhdojë puna në fazën e dytë të mbledhjes së materialit për vendbanimet rurale të Kosovës. Është hartuar tashmë modeli në formë të udhëzimit - pyetësorit si një nga instrumentet kryesore të hulumtimeve në terren për sigurimin e të dhënave burimore dhe origjinale shkencore-enciklopedike mbi vendbanimet e Kosovës në përgjithësi. Gjatë muajit qershor do të mbahet edhe një punëtori, që do të mbështetet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si donator, ku do të debatohet për të gjitha çështjet relevante të punës në terren mbi bazë të Pyetësorit-udhëzuesit me 50 pyetje dhe nënpyetje, të dhënat e të cilit do të shfrytëzohen vetëm për qëllime shkencore. Puna që do të përfundojë do të kurorëzohet me botimin e vëllimit të dytë për vendbanimet rurale, sikundër që pas një viti tjetër do

të përfundojë edhe faza e tretë, me botimin e vëllimit të tretë. Botimet, me vëllimet I-III, do të përfshijnë të dhënat sa më të plota, themelore dhe të përgjithshme për evolucionin sasior dhe cilësor të vendbanimeve dhe të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të aspekteve të ndryshme të jetës ekonomike dhe dimensionin funksional të vendbanimeve në përgjithësi në tërë kompleksitetin e tyre.

Përfundimi i projektit dhe nxjerrja në dritë e tri vëllimeve do të plotësojë mungesën e informatave dhe njohurive për dinamikën e jetës dhe të zhvillimit të vendbanimeve të Kosovës, të kaluarën dhe të tashmen e tyre, me një qasje dhe metodologji bashkëkohore shkencore. Dalja në dritë e këtyre botimeve pa dyshim do të përmbushë një nevojë të kahershme për gjeoshkencat, shkencat sociale dhe opinionin e gjerë lexues dhe shfrytëzues dhe do të jetë një trashëgimi e madhe për shkencën dhe kulturën tonë. Arsyeimi i hollësishëm i projektit dhe i të gjitha fazave të tij është dhënë në të gjitha instancat e Akademisë në mesin e vitit 2016.

2. Hasan Prishtina në prizmin e dokumenteve arkivore. – Projekt afatmesëm. Ky projekt ka hyrë në Programin e punës së Seksionit për vitin 2017 dhe me atë rast është dhënë arsyeimi i hollësishëm. Projekti është në fazën e hulumtimeve arkivore nëpër arkivat vendore dhe ndërkombëtare. Deri më tani janë bërë hulumtime në disa arkiva si: Arkivi i Kosovës, Arkivi i

Shtetit Shqiptar, Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë, Arkivi i Institutit të Historisë në Prishtinë, Arkivi Nacional në Londër (The National Archives) dhe do të vazhdohet me hulumtime në arkivat tjera që posedojnë fonde për veprimtarinë e Hasan Prishtinës. Projekti vazhdon edhe në vitin 2019.

3. Matja e ekonomisë informale në Kosovë dhe përcaktuesit e saj. - Projekt një vjeçar. Bartëse e projektit: Justina Shiroka - Pula, anëtare korrespondente.

Qëllimi i projektit:

Qëllimi i këtij projekti është matja e madhësisë së ekonomisë joformale në Kosovë, duke u bazuar në instrumentet matëse të ekonomive në tranzicion, si dhe shqyrtimi i faktorëve kryesorë që ndikojnë në pjesëmarrjen në ekonominë joformale. Termi "ekonomi joformale" përdoret për t'iu referuar çdo prodhimi të ligjshëm të mallrave dhe shërbimeve që është fshehur qëllimisht nga autoritetet publike. Rezultat i këtij projekti do të jetë konstruktimi dhe kalkulimi i një indeksi që do të masë ekonominë joformale për t'iu dhënë hartuesve të politikave informacione, për marrje të vendimeve të justifikuara në lidhje me politikën, si dhe për të nxitur një kuptim më të thellë të proceseve të ndërmarrësisë në Kosovë dhe më gjerë. Për më tepër, përmes një modeli ekonometrik do të bëhet identifikimi dhe matja e faktorëve kryesorë që ndikojnë në përfshirjen e ndërmarrësve në

ekonominë joformale dhe ofrimi i disa rekomandime për politika. Indeksi do të konstruktohet duke u bazuar te Putniņš dhe Sauka (2015) dhe në anketën me 500 ndërmarrës në Kosovë. Kjo qasje bazohet në nocionin se ata që kanë më shumë gjasa të dinë në lidhje me sasinë e prodhimit - të ardhurave që nuk raportohen, janë ndërmarrësit që vetë angazhohen në raportimin dhe prodhimin "nën hije" apo joformal. Indeksi kombinon vlerësimet e të ardhurave të raportuara të biznesit, punëtorët e peregjistruar ose të fshehtë, si dhe pagat "në dorë" të paraportuara për të siguruar vlerësime të madhësisë së ekonomisë informale si pjesë e PBV-së (Produkti bruto-vendor). Metoda e përdorur në këtë raport për vlerësimin e madhësisë së ekonomisë informale kërkon më pak supozime sesa shumica e metodave ekzistuese, në veçanti në krahasim me metodat e bazuara në treguesit makro. Për më tepër, ky indeks i ekonomisë joformale mund të përdoret përgjatë kohës apo në të gjithë sektorët dhe vendet dhe është një mjet i dobishëm për vlerësimin e efektivitetit të politikave të dizajnuara për të minimizuar ekonominë e informale.

Qasjet e bazuara në anketim përballen me rrezikun e nënvlerësimit të madhësisë totale të ekonomisë informale për shkak të mospërgjigjeve dhe përgjigjeve të pavërteta, duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të temës. Kjo metodë e minimizon këtë risk duke përdorur një sërë teknikash të mbledhjes së të dhënave që në studimet e mëparshme janë treguar

efektive në nxjerrjen e përgjigjeve më të sinqerta. Këto përfshijnë konfidencialitetin ndaj identitetit të respondentit, duke e strukturuar anketimin si një studim të kënaqësisë me politikën e qeverisë, duke i prezantuar gradualisht pyetjet më të ndjeshme pas pyetjeve më pak të ndjeshme, duke i formuluar pyetjet për keqraportim në mënyrë indirekte, duke i përjashtuar përgjigjet jokonsistente dhe në analizën, kontrollimin për faktorët që kanë korrelacion me përgjigje potenciale të pavërteta, si toleranca ndaj raportimit të gabuar (shih Putniņš & Sauka, 2015; Williams & Krasniqi, 2017, për diskutim më të hollësishëm).

4. Lidhja e Prizrenit në Dokumentet Austro-Hungareze (1879-1881). Projekt dy vjeçar.

Bartës i projektit, akademik Jusuf Bajraktari.

Qëllimi i projektit:

Lidhja e Prizrenit është një ngjarje madhore në historinë tonë kombëtare, e cila shënon lindjen në mënyrë të institucionalizuar të kombit modern shqiptar. Ajo ka lënë gjurmë të thella në historinë tonë kombëtare me të gjithë aktivitetin e saj multidimensional, kulturor, politik, ushtarak dhe institucional. Ajo arriti të krijonte të parën qeveri kombëtare gjithëshqiptare, të parën ushtri kombëtare gjithëshqiptare. Ishte organizata politike me përfaqësim nga

të gjitha trevat shqiptare. Veprimtaria e saj në mbrojtje të trojeve që Kongresi i Berlinit kishte vendosur t'i shkëputeshin Shqipërisë ka lënë gjurmë të thella në identitetin dhe në memorien historike shqiptare.

Ajo gjithashtu ka pasur ndikim të madh në marrëdhëniet ndërkombëtare të kohës dhe veçanërisht në krijimin e një mendimi dhe qëndrimi të ri të Fuqive të Mëdha për sa i përket çështjes shqiptare. Gjatë kohës së saj dhe pas saj, çështja shqiptare do të merrte një dimension gjithnjë e më të madh ndërkombëtar dhe do të ishte gjithnjë e më tepër e pranishme në planet dhe politikat e Fuqive të Mëdha.

Dokumentet austro-hungareze që propozohen për botim kanë një vlerë të madhe, sepse e pasqyrojnë me imtësi të gjithë veprimtarinë e Lidhjes dhe, më gjerë akoma, të shqiptarëve në këto vite.

Gjithashtu ato pasqyrojnë edhe qëndrimin e vetë Austro-Hungarisë dhe të vendeve të tjera ndaj çështjes shqiptare.

Vlera specifike e dokumenteve austro-hungareze është e spikatur edhe për këto arsye:

1. Austro-Hungaria ishte shteti që tregoi interesin më të madh ndaj çështjes shqiptare në këto momente dramatike dhe kruciale të zhvillimit të saj.

2. Ky shtet kishte prezencën diplomatike më të fuqishme në terren dhe i ndoqi me shumë interes dhe korrektësi zhvillimet shqiptare.

3. Shqipëria konsiderohej nga Austro-Hungaria si një zonë me rëndësi të veçantë politike, strategjike dhe ushtarake për interesat dhe politikën e saj. Botimi i dokumentacionit austro-hungarez për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit do të sjellë një njohje të re dhe të detajuar të zhvillimeve politike, kulturore, ekonomike dhe sociale të trevave shqiptare; do të hedhë dritë dhe do të nxjerrë në pah të dhëna të panjohura për një galeri personalitetesh historike të kohës. Në tërësinë e tyre këto vëllime dokumentare përbëjnë një kontribut në rishkrimin dhe plotësimin e historisë sonë kombëtare të kësaj periudhe, me realizëm, me detaje të hollësishme dhe me nivel të lartë shkencor. Vlerat njohëse të botimit të këtyre dokumenteve janë të mëdha. Ato do të shërbejnë si një dritare dije për botën akademike dhe atë studentore, veçanërisht studentët, pedagogët, mësuesit, intelektualët do të gjejnë aty historinë e plotë të kombit tonë, por gjithashtu edhe episode tepër emocionale për shumë familje, fise shqiptare dhe të paraardhësve të tyre.

Përfituesit e Projektit janë: Studiuesit e historisë, albanologët, studiuesit e diplomacisë dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare, sociologët etj. Më gjerë akoma, lexuesit në gjithë botën shqiptare.

TUBIME SHKENCORE

1. **Matja e ekonomisë informale në Kosovë dhe përcaktuesit e saj**, tryezë shkencore. - Kjo tryezë është pjesë dhe rrjedh nga Projekti i pasqyruar më lart. Parashihet të prezantohen dhe të elaborohen rezultatet e hulumtimit, anketës me 500 ndërmarrje që veprojnë në Kosovë. Po ashtu në tryezë do të prezantohet zbatimi i modelit ekonometrik, që kohëve të fundit është standard për bizneset në Evropë dhe më gjerë. Materialet e tryezës do të botohen në një vëllim të veçantë.

Tryeza planifikohet të mbahet në muajin qershor të vitit 2019.

BOTIME

1. Revista **“Studime shoqërore”** nr. 6.- Revistë vjetore që do të botohet gjatë vitit 2019. Në të do të botohen studime dhe artikuj shkencorë, tekste ligjërimesh inauguruese, vështrime, recensione e kritika etj. nga disiplinat e shkencave shoqërore.

Sekretare e Seksionit,
Anëtare korrespondente
Justina Shiroka - Pula, d.v.

SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

PROJEKTE

1. Hulumtim mbi mundësitë e rishfrytëzueshmërisë së brezeve të reja frekuencore UHF, VHF dhe valëve milimetrike për rrjete të komunikimeve pa tela në territorin e Kosovës, i paraqitur nga anëtarja korrespondente Myzafere Limani, projekt 2-vjeçar. Ky projekt është në kuadër të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve.

- Objektivat kryesore të projektit janë:

I) Vlerësimi eksperimental i shfrytëzueshmërisë së brezeve frekuencore UHF, VHF dhe milimetrike në Republikën e Kosovës, si dhe ndërtimi i bazës së të dhënave përkatëse;

II) Modelimi i interferencës dhe zhvillimi i pragjeve përkatëse të interferencës për shfrytëzimin e këtyre si përdorues sekondar (pa licencë);

III) Analiza softuerike e bashkekzistencës së rrjeteve heterogjene kognitive pa tela në këto breze;

IV). Realizimi i simulimeve numerike përmes platformave të përshtatshme softuerike për vlerësimin e performancës së mekanizmave për bashkekzistencën e teknologjive të

ndryshme pa tela në brezin e matur frekuencor;

V) Nxjerrja e përfundimeve për skenarët më të përshtatshëm për bashkekzistencën e teknologjive të ndryshme pa tela në brezin e matur frekuencor;

VI) Njoftimi i komunitetit shkencor ndërkombëtar dhe autoriteteve rregullative në Kosovë për performancën dhe mundësinë e shtrirjes së rrjeteve kognitive heterogjene pa tela për rishfrytëzimin e brezit të licencuar frekuencor.

2. Modifikimi i sipërfaqes së qymyrit me shtresa të holla organike, i paraqitur nga anëtari korrespondent Fetah Podvorica, projekt 2-vjeçar. Ky projekt është në kuadër të fushës së kimisë së materialeve.

- Objektivat kryesore të projektit janë:

I. Veshja e sipërfaqes së qymyrit me grupe alkile gjatë reaksionit ndërmjet alkilhalogjenureve dhe radikaleve arile të krijuara me anë të reduktimit të kripërave arildiazonium.

II). Vërtetimi i pranisë së shtresave të holla me grupe alkile në sipërfaqe të qymyrit me anë të metodave të ndryshme të analizës së sipërfaqeve. Këto metoda do të shërbejnë, njëkohësisht, për të gjetur kushtet optimale të formimit të këtyre shtresave: llojit të molekulës së alkil halogjenurit, llojit të kripës së

arildiazoniumit, raportin e përqendrimeve të tyre; kohëzgjatjen e modifikimit, përdorimin e ndonjë mjeti reduktues etj.

III) Përdorimi i qymyrit të modifikuar në sipërfaqe me grupet alkile për përgatitjen e membranave asimetrike heterogjene qymyr i modifikuar – acetat celuloze. Veshja e sipërfaqes së qymyrit do ta bëhet me grupe të ndryshme alkile të cilat dallojnë si në përbërje kimike për shkak se ato mund të përmbajnë edhe grupe funksionale specifike po ashtu edhe në gjatësi të vargut karbonik.

IV) Testimi i efikasitetit të membranave asimetrike heterogjene qymyr i modifikuar – acetat celuloze.

V) Optimizimi i performancës së këtyre membranave të cilat përmbajnë qymyrin e modifikuar me shtresa të holla alkile.

VI) Përgatitja e shtresave të përziera organike me grupe alkile dhe arile të lidhura në sipërfaqe të qymyrit duke përdorur si gjenerator të radikaleve alkile prej alkil halogjeneve, kripëra të aril diazoniumeve, radikale arile të cilave lidhen edhe vetë për sipërfaqe të qymyrit.

BOTIME

1.Qamil Haxhibeqiri, **Fibracionet**.

Fibracionet janë pasqyrime të veçanta të hapësirave topologjike që kanë vetinë e ngritjes së homotopisë. Ato luajnë rol të posaçëm në teorinë e homotopisë, sidomos në llogaritjen e grupeve të homotopisë të hapësirave topologjike. Fibracionet e formës në kategorinë e formës dhe për progrupet e homotopisë si dhe grupet e formës kanë rol të ngjashëm me rolin që kanë fibracionet në teorinë e homotopisë për grupet e homotopisë. Pikërisht studimeve të këtyre kuptimeve u kushtohet ky libër. Ky libër përmban tetë kapituj dhe është i shkruar në 320 faqe dhe i takon fushës së algjebrës topologjike dhe teorisë së formës. Kapitujt që përmban ky libër janë:

I) Disa kuptime themelore nga teoria e kategorive dhe homotopia.

II) Fibracionet e hapësirave topologjike.

III) Kategoria e formës.

IV) Rezolventat.

V) Limitet e anasjellë.

VI) Ngritja dhe ngritja e përafërt e homotopisë.

VII) Fibracionet e formës për hapësirat topologjike.

VIII) Fibracionet e formës për hapësirat kompakte të Hausdorfit.

2. Revista "Resarch-Kërkime" nr. 24. Aktualisht redaksia pas nxjerrjes së numrit 23 në gjuhën angleze, e ka bërë shpalljen për prurjet e reja deri në gjysmën e muajit shtator 2018 dhe pastaj do të procedohet me nxjerrjen e numrit tjetër të revistës në fillim të vitit 2019. Në këtë revistë botohen punimet origjinale shkencore të cilat i përkasin Seksionit të Shkencave të Natyrës.

Aktivitete të tjera:

Vazhdohet me realizimin e aktiviteteve të Protokollit të bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë në projektet të cilat janë në kuadër të fushëveprimtarisë së Seksionit të Shkencave të Natyrës të ASHAK-ut.

Sekretari i Seksionit,
Anëtar korrespondent
Fetah Podvorica, d.v.

SEKSIONI I ARTEVE

EKSPOZITA

1. Ekspozitë me veprat e akademik Agim Çavdrabashës. Ekspozita do të organizohet në mjediset e Akademisë. Në të do të përfshihen punime të cikleve të ndryshme të krijimtarisë së autorit. Për ekspozitën do të përgatitet edhe botimi i katalogut.

KONCERTE

Koncert për nder të 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës. Koncerti do të përgatitet nga akademik Zeqirja Ballata.

Sekretari i Seksionit,
Anëtar korrespondent Luan Mulliqi,
d.v.

PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS



PROCESVERBAL

Nga mbledhja XCIV e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 8 shkurt 2018, në orën 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Anton K. Berishaj, Ekrem Murtezai, Eqrem Basha, Feriz Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Mehmet Kraja, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Arsim Morina, Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Justina Pula, Kujtim Shala, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Myzafer Limani, Qamil Haxhibeqiri dhe Salih Gashi.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë, akademik Nexhat Daci, i cili në fjalën e hapjes e uroi akademik Rexhep Ismajlin për zgjedhjen e tij anëtar nderi i Shoqatës së Linguistëve të Amerikës. Kryetari Daci tha se zgjedhja e akademik Ismajlit, anëtar nderi i shoqatës në fjalë është nder jo vetëm për akademik Ismajlin, por edhe për Akademinë në veçanti. Ai i uroi akademik Ismajlit shëndet dhe suksese të mëtejme.

Kuvendi më pas njëzëri miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCIII të Kuvendit të Akademisë;

2. Miratimi i Raportit të punës të ASHAK-ut për vitin 2017;

3. Miratimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2017;

4. Miratimi i Planit strategjik gjithëpërfshirës të ASHAK-ut për vitet 2018-2021;

5. Çështje vijuese.

Ad. 1.-

Procesverbali i mbledhjes XCIII të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2.-

Në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kryetari Daci tha se Raporti paraqet punën e Akademisë për vitin e kaluar dhe se seksionet i kanë shqyrtuar raportet e tyre në mbledhje të rregullta. Raporti i plotë më pas është shqyrtuar edhe në mbledhjen e Kryesisë së Akademisë. Kryetari më pas shtoi se materialet janë ndarë me kohë dhe sot jemi mbledhur për miratimin e Raportit.

Kuvendi filloi shqyrtimin e Raportit të punës të ASHAK-ut me rend, duke filluar nga Kuvendi. Gjatë shqyrtimit të raportit të punës së Kuvendit, J.

Bajraktari propozoi të bëhen disa ndryshime në faqen 5 dhe 6. Propozimi u miratua.

Më pas u shqyrtuan me rend raportet e punës të Kryesisë, të seksioneve dhe të Shërbimit profesional, administrativ e teknik të ASHAK-ut.

Kuvendi njëzëri miratoi raportin e punës të ASHAK-ut për vitin 2017. Raporti është pjesë përbërëse e procesverbalit dhe do të botohet në Vjetari 2017.

Ad. 3.-

Kuvendi po ashtu shqyrtoi dhe miratoi pa vërejtje edhe Raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2017. Edhe ky raport është pjesë përbërëse e procesverbalit dhe do të pasqyrohet në Vjetari 2017.

Ad. 4.-

Kuvendi shqyrtoi draftin e Planit strategjik gjithëpërfshirës të ASHAK-ut për vitet 2018-2021. Kryetari Daci e njoftoi Kuvendin se drafti i Planit strategjik është hartuar nga Grupi i caktuar me vendim të Kryesisë së ASHAK-ut dhe e hapi diskutimin. Diskutuan M. Kraja, S. Hamiti, Salih Gashi, Arsim Bajrami, Hivzi Islami. M. Kraja në diskutimin e tij paraqiti disa sugjerime lidhur me pikat që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkombëtar të Akademisë. S. Hamiti propozoi që teksti të shkurtrohet, ashtu që disa pika të përmbliidhen në një të

vetme. S. Gashi tha se është bërë punë e mirë dhe paraqiti disa propozime të reja për plotësimin e disa pikave. A. Bajrami e përgëzoi Grupin punues për punën e bërë dhe paraqiti disa propozime, të cilat tha se do t'i hartojë me shkrim dhe do t'ia paraqesë Grupit. H. Islami në diskutimin e tij tha se ky Plan strategjik është i pari që po hartohet në Akademi dhe se hartimi i tij rrjedh si kërkesë e Auditorit të përgjithshëm, e që edhe për ne është një gjë e mirë, sepse mundëson planifikim më të mirë financiar. Grupi punues ka bërë punë të mirë, mund të ketë disa lëshime të cilat mund të përmirësohen.

Pas diskutimeve, kryetari Daci tha se e përshëndet dhe e përkrah punën e Grupit punues. Dokumenti është hartuar me përgjegjësi dhe përkushtim, por gjithnjë ka vend për përmirësime. Ai më pas ia kaloi fjalën sekretares shkencore Myzaferë Limanit, njëherësh kryesuese e Grupit punues, për të dhënë sqarimet përkatëse. M. Limani në diskutimin e saj fillimisht i falënderoj të gjithë parafolësit për vlerësimet e mira dhe për sugjerimet e propozimet e paraqitura. Ajo e njoftoi Kuvendin se Grupi punues ka punuar në përbërje të plotë dhe ka hartuar strukturën themelore të planit strategjik gjithëpërfshirës, të cilën ua ka ndarë të gjithë anëtarëve të Akademisë për të paraqitur sugjerimet dhe propozimet eventuale. Brenda periudhës prej rreth 20 ditëve grupi ka pranuar dy propozime nga dy anëtarë të Akademisë (Z. Ballata dhe M. Halimi). Meqë nuk ka pasur të tjera propozime

Grupi e ka finalizuar dokumentin të cilin paraprakisht e ka shqyrtuar Kryesia e Akademisë, e cila më pas ka vendosur t'ia përcjellë Kuvendit të saj. Ajo vazhdoi duke thënë se pajtohet me sugjerimet dhe propozimet që u dhanë dhe mendon që ato duhet të përfshihen në Planin strategjik.

Në fund kryetari Daci, duke marrë parasysh diskutimet rreth kësaj çështjeje, propozoi që miratimi i Planit strategjik të shtyhet për mbledhjen e radhës të Kuvendit dhe në ndërkohë të plotësohet me propozimet që u paraqitën. Propozimi u miratua njëzëri nga Kuvendi.

Ad. 5.-

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi u njoftua nga L. Pula se për nder të 10-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës, kryetari Daci shtron drekë solemne më 15 shkurt 2018.

Mbledhja u mbyll në orën 12:20
Kryetari i Akademisë
Akademik Nexhat Daci

PROCESVERBAL

Nga mbledhja XCV e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 28 qershor 2018, në orën 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët:
Ali Aliu, Anton K. Berishaj, Eqrem Basha, Feriz Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zeqirja Ballata, Zejnullah Rrahmani dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Morina, Bardh Rugova, Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Justina Pula, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Muhamedin Kullashi, Myzafer Limani, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi dhe Xhevdet Xhafa.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë akademik Nexhat Daci.

Kuvendi miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCIV të Kuvendit të Akademisë;
2. Miratimi i Programit të punës të ASHAK-ut për vitin 2019;
3. Miratimi i Planit strategjik gjithëpërfshirës për vitet 2018-2021;
4. Miratimi i rregulloreve: Rregullorja për organizimin e koncerteve, Rregullorja për organizimin e ekspozitave, Rregullorja për udhëtimet

zyrtare dhe Rregullorja për përdorimin e veturave zyrtare;

5. Çështje vijuese.

Ad. 1.-

Procesverbali i mbledhjes XCIV i Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2.-

Kuvendi shqyrtoi Programin e punës të ASHAK-ut për vitin 2019, me radhë sipas seksioneve.

Programi i punës për vitin 2019 u miratua unanimisht dhe është pjesë përbërëse e procesverbalit.

Ad. 3.-

Kuvendi po ashtu shqyrtoi Planin strategjik gjithëpërfshirës të ASHAK-ut për vitet 2018-2021. Kryetari Daci tha se Plani strategjik po shqyrtohet për herë të dytë në Kuvend dhe se nuk e konsideron të nevojshme të hapet diskutimi për këtë pikë. Ai tha se drafti u është ndarë dy herë të gjithë anëtarëve të Akademisë për të paraqitur vërejtjet dhe sugjerimet përkatëse. Ato që i janë dërguar grupit punues janë marrë parasysh dhe janë përfshirë në draft dhe sot jemi këtu për ta miratuar atë. Pas kryetarit diskutoi M. Kraja dhe S. Hamiti. M. Kraja në diskutimin e tij tha se ky është drafti i dytë që po shqyrtohet dhe nuk ka

shumë ndryshime nga i pari. Plani strategjik është shumë evaziv dhe nuk përputhet me Ligjin dhe Statutin e Akademisë, ka fjali të tepërta që duhet të redaktohen, ndërsa S. Hamiti tha se teksti i Planti strategjik është i përgjithësuar.

Pas diskutimeve Kuvendi njëzëri e miratoi Planin strategjik gjithëpërfshirës 2018-2021. U tha që para publikimit në faqen ueb dokumenti të redaktohet nga një anëtar i Akademisë, të cilin do ta caktojë Kryesia e saj.

Ad. 4.-

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi shqyrtoi me radhë rregulloret e përgatitura për miratim në Kuvend. Kryetari Daci tha se edhe rregulloret u janë ndarë me kohë të gjithë anëtarëve të Akademisë për të paraqitur vërejtje dhe sugjerime.

Gjatë shqyrtimit të rregulloreve për organizimin e ekspozitave dhe koncerteve diskutimin e filloi Z. Ballata i cili propozoi që këto dy rregullore të shkrihen në një të vetme, por N. Daci dhe L. Mulliqi sqaruan se ekspozitat dhe koncertet kanë specifikat e tyre, prandaj Grupi punues e ka parë të nevojshme të jenë të ndara. Xh. Xhafa në diskutimin e tij propozoi që në Rregulloren për organizimin e ekspozitave të përfshihen vetëm ekspozitat e anëtarëve të Akademisë për shkak se Akademia nuk ka buxhet të mjaftueshëm për organizimin e

ekspozitave të autorëve nga jashtë. Por L. Mulliqi sqaroi se ekspozitat planifikohen dhe organizohen me miratimin e organeve drejtuese të Akademisë, duke u bazuar në buxhetin e saj, prandaj nëse nuk ka mjete të mjaftueshme nuk miratohen, por në parim në rregullore duhet të përfshihen edhe autorët e jashtëm, meqë kjo gjë është e paraparë edhe me Ligjin dhe Statutin e ASHAK-ut. M. Kraja në diskutimin e tij tha se ASHAK-ut i duhen edhe rregullore të tjera për organizimin e aktiviteteve shkencore si: konferenca, simpoziume, tryeza, etj. Ai po ashtu tha se duhet të rishikohet përbërja e Grupit punues, meqë ata nuk mund të dinë për të gjitha fushat. Me këtë rast ndërhyri kryetari Daci, i cili tha se Grupi punues ka paraparë hartimin edhe të rregulloreve të tjera, ndërsa sa i përket përbërjes së Grupit ai tha se në të janë të përfshirë anëtarë të të gjitha seksioneve të cilët kanë punuar me përkushtim dhe profesionalizëm.

Në vazhdim diskutoi edhe Zejnullah Rrahmani i cili e përgëzoi Grupin punues për punën e bërë, por tha se do të ishte mirë që të gjitha aktivitetet të përfshiheshin në një rregullore të vetme.

Pas diskutimeve u miratuan njëzëri Rregullorja për organizimin e koncerteve dhe Rregullorja për organizimin e ekspozitave.

Më pas filloi shqyrtimi i Rregullores për udhëtimet zyrtare. M. Kraja propozoi

që neni 3, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 të plotësohet në fund me këtë fjali: "Në koordinim me kryetarin e Akademisë". Propozimi u miratua dhe u tha që fjalia të përfshihet në Rregullore. Rregullorja më pas u miratua njëzëri.

Në fund u shqyrtua edhe Rregullorja për përdorimin e veturave zyrtare. A. Aliu propozoi që neni 2, paragrafi 1 të plotësohet si në vijim: "Kryetari i Akademisë e përdor automjetin zyrtar për punë zyrtare pa kufizim". S. Hamiti në diskutimin e tij tha se kjo rregullore është shumë gjithëpërfshirëse dhe në të ka gjëra shumë të thjeshta që nuk ka nevojë të sanksionohen me rregullore. Pas diskutimit të S. Hamitit reagoi kryetari Daci, i cili tha se kjo rregullore është më se e nevojshme, sepse ASHAK-u i ka dy vetura dhe vetëm një shofer. Shoferi duhet të jetë në Akademi për kryerjen e punëve që i takojnë e jo nëpër udhëtime zyrtare. Po ashtu veturat e Akademisë mund të përdoren nga anëtarët e Akademisë, apo nga punonjësit e administratës, me autorizime përkatëse vetëm në raste të domosdoshme, gjithnjë në përputhje me Rregulloren. Me këtë rast S. Hamiti në fjalën e tij shprehu shqetësim se kohë më parë i është dashur të udhëtojë në Tiranë për të mbajtur ligjëratë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Ligjëratat ka qenë e paraparë me Programin e punës së ASHAK-ut dhe me Protokollin ASHAK-ASHSH. Ai tha se ka udhëtuar me veturë private dhe arsyetimi që ka marrë nga ASHAK-u ka qenë mungesa e shoferit.

Pas S. Hamitit, kryetari Daci sqaroi se çështja e përdorimit të veturave është qartësuar edhe në mbledhjen e Kryesisë së Akademisë. Ai tha se të gjithë duhet t'u përmbahen rregulloreve, të paraqesin me kohë kërkesat për udhëtime zyrtare në mënyrë që të ketë kohë të sigurohet transporti me taksi, meqë tani e tutje udhëtimet duhet të bëhen me shërbim të taksive.

Rregullorja për përdorimin e veturave zyrtare u miratua me dy vota kundër (A. Aliu dhe M. Kraja).

Mbledhja u mbyll në orën 12:20

Kryetari i Akademisë,
akademik Nexhat Daci

Procesmbajtëse

Lendita Pula

KRONIKA E VITIT 2018

VIZITË E ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINSITRIT TË ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË NË ASHAK



Zëvendëskryeministri në Qeverinë e Republikës së Kosovës z. Fatmir Limaj dhe ministri i MASHT-it, z. Shyqiri Bytyçi me bashkëpunëtorë, më 4 janar 2018 i bënë një vizitë Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Ata u pritën nga Kryesia e ASHAK-ut, e udhëhequr nga akademik Nexhat Daci, kryetar i ASHAK-ut. Me atë rast mysafirët e uruan kryetarin e Akademisë, akademik Nexhat Dacin për zgjedhjen e tij si kryetar i Akademisë si dhe ofruan bashkëpunim dhe përkrahje për zhvillim të arsimit dhe shkencës në përgjithësi. Në veçanti kërkuar një mbështetje në rrafshin shkencor nga Akademia për trajtimin e çështjeve të ndryshme në fushën e arsimit, duke përfshirë ndonjë qasje praktike për zhvillimin e mëtejshëm të punës në universitete.

Udhëheqësit e Akademisë falënderuan mysafirët për vizitën dhe njëherësh ofruan bashkëpunim të plotë. Ky bashkëpunim do të zhvillohet përmes hapjes së Akademisë ndaj institucioneve arsimore, akademike

dhe atyre shkencore-kërkimore në vend, në rajon dhe më gjerë. Të dy palët u pajtuan për bashkëpunim të ngushtë në të ardhmen.

REKTORI I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS VIZITON ASHAK-un

Rektori i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” z. Marjan Dema me bashkëpunëtorë, më 11 janar 2018 i bënë një vizitë Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Ata u pritën nga Kryesia e ASHAK-ut e udhëhequr nga akademik Nexhat Daci, kryetar i ASHAK-ut. Me atë rast mysafirët e uruan kryetarin e Akademisë akademik Nexhat Dacin për zgjedhjen e tij si kryetar i Akademisë si dhe ofruan bashkëpunim substancial dhe kërkuar përkrahje në procesin aktual të reformave në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” që përfshijnë krijimin e standardeve për ndryshime.

Udhëheqësit e Akademisë falënderuan mysafirët për vizitën dhe njëherësh ofruan bashkëpunim të plotë duke potencuar përvojën pozitive në rrafshin ndërkombëtar kur bashkëpunimi ndërmjet ASHAK-ut, Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe



institucioneve tjera nga e gjithë hapësira shqiptare ka qenë i suksesshëm. Ky bashkëpunim do të zhvillohet përmes hapjes së Akademisë ndaj institucioneve arsimore, akademike dhe atyre shkencore-kërkimore në vend, në rajon dhe më gjerë. Të dy palët u zotuan për bashkëpunim të ndërsjellë në të ardhmen.

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI, ANËTAR NDERI I SHOQATËS SË LINGUISTËVE TË AMERIKËS

Akademik Rexhep Ismajli është zgjedhur anëtar i përhershëm nderi i Shoqatës së Linguistëve të Amerikës (Linguistic Society of America (LSA)), që është institucioni më i rëndësishëm shkencor për çështje të gjuhësisë. Njoftimi është dërguar të martën nga drejtoresha ekzekutive e LSA-së Alyson Reed.

Akademik Ismajli do t'i ketë të përfjetshme statusin dhe përfitimet e anëtarësisë.

“Kushtetuta jonë thotë se ‘një studiues i huaj i shquar në fushën e studimeve gjuhësore e që nuk është banor i SHBA-së, mund të zgjedhet anëtar nderi i Shoqatës, në bazë të rekomandimeve të Komitetit Ekzekutiv’”, ka shkruar drejtoresha Reed në letrën e njoftimit për anëtarësimin e Ismajlit.

Linguistic Society of America (LSA) është themeluar më 1924 dhe shërben për promovimin e studimeve

shkencore në fushën e gjuhësisë. Është pandan i Akademisë së Shkencave për çështje të gjuhësisë. Boton dy revista, ndër më prestigjiozet në botë: “Language” dhe “Semantics and Pragmatics”.

Rexhep Ismajli (1947) është anëtar i ASHAK-ut që nga viti 1993.

Ndër anëtarët e tjerë të nderit të LSA-së janë disa nga autoritetet më të mëdha të gjuhësisë botërore, përfshirë: Michael Halliday, John Lyons, Randolph Quirk, Wolfgang Dressler e Peter Trudgill.

ANËTAR KORRESPONDENT FETAH PODVORICA QËNDROI NË TIRANË

Me ftesë të Seksionit të Shkencave Të Natyrës dhe Teknikës të ASHSH-së, anëtari korrespondent Fetah Podvorica ka qëndruar në Tiranë më 2 shkurt dhe ka marrë pjesë në Konferencën shkencore: “Prurjet shkencore për kërkim e zhvillim në publikimet e revistës “Journal of Natural and Technical Sciences” dhe përparësitë e hulumtimeve në të ardhmen. Profesor Podvorica, në emër të ASHAK-ut, përkatësisht Seksionit të Shkencave të Natyrës, i ka përshëndetur organizatorët e Konferencës dhe të pranishmit e tjerë.

MBAHET TRYEZA SHKENCORE: MATERIALET KOMPOZITE



Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Shkencave të Natyrës, organizoi Tryezën shkencore "Materialet kompozita".

Tryeza është mbajtur më 6 prill 2018 dhe ka përfunduar punimet me sukses. Ajo ka vënë në pah rëndësinë shumë të madhe të përdorimit të materialeve kompozita në jetën e përditshme, duke nxitur bashkëpunimin ndërdisiplinar ndërmjet hulumtuesve shkencorë të lëmenjve të ndryshëm në nivel vendi dhe më gjerë.

Në këtë tryezë, ndër të tjera është diskutuar për llojet e ndryshme të materialeve kompozita, strukturën dhe vetitë e tyre; Përfitimi i materialeve kompozita; Zbatimi i tyre në degë të ndryshme të teknologjisë dhe industrisë; Ndikimi i materialeve kompozita në mjedis, ricklimi i tyre etj.

Këshilli organizues i tryezës në përbërje prej anëtarëve korrespondentë Fetah Podvorica dhe Myzafer Limani ka bërë përgatitjet e nevojshme, ndërsa me kumtesat e tyre janë paraqitur: Prof.

Fetah Podvorica, prof. Jean Pinson (Francë), prof. Indrit Vozga dhe Jorgaq Kaqani (Shqipëri), prof. dr. Salih Gashi, prof. Ardian Morina (Angli), prof. Hysni Osmani, prof. Naser Kabashi, prof. asoc. Dashnor Nebija, prof. ass. Avni Berisha, dr. Dardan Hetemi dhe dr. Flamur Sopaj.

Promovimi i tryezës është bërë edhe përmes mediave të shkruara dhe elektronike, ndërsa RTK e ka dhënë një intervistë drejtpërdrejtë të kryetarit të këshillit organizativ të tryezës në emisionin e mëngjesit, kurse Ekonomia Online ka bërë xhirime gjatë gjithë seancës së parë.

Kontributet autoriale të tryezës janë bërë gati dhe do të botohen në një vëllim të veçantë.

MBAHET TAKIMI NDËRMJET AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË DHE AKADEMISË SONË

Më 10 prill 2018, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) u mbajt takimi me delegacionin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH), në kuadër të zbatimit të Protokollit të bashkëpunimit ndërmjet dy akademive.



Delegacioni në përbërjen: Akademike Floresha Dado, kryetare e Seksionit të Shkencave Shoqërore Albanologjike, akademik i asociuar Shaban Sinani, sekretar shkencor i Seksionit të Shkencave Shoqërore Albanologjike dhe akademik Beqir Meta, drejtor i Institutit të Historisë në Tiranë, u prit nga akademik Jusuf Bajraktari, nënkryetar i Akademisë, anëtare korrespondente Justina Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe anëtar korrespondent Frashër Demaj.

Në këtë takim u bisedua për realizimin e pikave të Protokollit të bashkëpunimit të ndërsjellë, në mënyrë të veçantë për përgatitjet rreth Konferencës shkencore kushtuar shënimit të 140-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që është evenimenti kryesor e i cili do të organizohet në Kosovë.

U bisedua, po ashtu, edhe për organizimin e Konferencës shkencore në kuadër të shënimit të 550-vjetorit të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, që do të mbahet në Tiranë.

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI, ANËTAR I AKADEMISË SË ARTEVE DHE TË SHKENCAVE TË AMERIKËS

Akademik Rexhep Ismajli është zgjedhur anëtar i jashtëm nderi i Akademisë së Arteve dhe të Shkencave të Amerikës (American Academy of Arts and Science -

<https://www.amacad.org/content/members/newFellows.aspx?s=a>).

Njoftimin e ka bërë të mërkurën kryetari i Akademisë Amerikane, Jonathan F. Fanton.

“Ky nderim shënjon konsideratën e thellë që kanë drejtuesit e fushës suaj dhe anëtarët tanë”, shkruan në njoftim.

Akademia e Arteve dhe e Shkencës e Amerikës është themeluar më 1780 prej disa nga themeluesit e SHBA-së Benjamin Franklin, John Adams, Thomas Jefferson e George Washington.

Në mesin e anëtarëve të saj janë mbi 200 fitues të Çmimit Nobel dhe të Çmimit Pulitzer.

Ndër emrat më të njohur që kanë qenë anëtarë të kësaj Akademie janë edhe Charles Darwin, Albert Einstein, Alexandar Graham Bell, Winston Churchill, Akiro Kurosawa, John Updike e Nelson Mendela. Në mesin e anëtarëve që janë pranuar sivjet është edhe ish-presidenti amerikan Barack Obama.

Akademik Ismajli do të marrë pjesë në ceremoninë e pranimi në Cambridge, Massachusetts, në tetor të këtij viti.

Rexhep Ismajli (1947) është gjuhëtar, student i Andre Martinet-së në Paris, profesor i Universitetit të Prishtinës.

Anëtar i ASHAK-ut është që nga viti 1993.

Në janar të këtij viti ai është zgjedhur edhe anëtar i përhershëm nderi i Shoqatës së Linguistëve të Amerikës (Linguistic Society of America (LSA) që është institucioni më i rëndësishëm shkencor për çështje të gjuhësisë, duke qenë autoriteti i vetëm nga Evropa Juglindore i zgjedhur në këtë institucion.

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI LIGJËRON NË AKADEMINË E AUSTRISE

Akademik Rexhep Ismajli ka mbajtur ligjëratë në Akademinë e Shkencave të Austrisë (ÖSTERREICHISCHE AKADEMIE DER WISSENSCHAFTEN) më 2 maj 2018 në Vjenë.

Ismajli ka ligjëruar para akademikëve austriakë temën “Ndarja dialektore e shqipes në këndvështrim ballkanologjik”.

ASHAK-u MERR PJESË NË PANAIRIN E 30-të TË LIBRIT NË SHKUP

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës prej datës 3 deri më 9 maj 2018 mori pjesë në Panairin e 30-të të librit "Shkupi 2018".

Në këtë Panair ASHAK-u prezantoi një listë të gjatë të botimeve të veta.

KRYETARJA DHE ZËVENDËSKRYETARI I GJYKATËS KUSHTETUESE VIZITOJNË ASHAK-un



Kryetari i ASHAK-ut akademik Nexhat Daci më 7 maj 2018 priti në një takim kryetaren e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Mr. Sc. Arta Rama - Hajrizin dhe zëvendëskryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës prof. Dr. Ivan Çukaloviq.

KRYETARI DACI QËNDROI NË BULLGARI

Më 15-19 maj 2018 kryetari i Akademisë, akademik Nexhat Daci mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të ALLEA-s në Sofje-Bullgari. Kryetari Daci u takua me homologë të akademive anëtare të ALLEA-s dhe zhvilloi takime të rëndësishme për thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

MTBAHET SIMPOZIUMI SHKENCOR "PAVARËSIA E KOSOVËS DHE SFIDAT E SHTETNDËRTIMIT"

Simpoziumi u mbajt më 17 maj 2018 dhe u organizua nga këshilli organizues në këtë përbërje: Akademik Jusuf Bajraktari, akademik Ali Aliu, anëtar

korrespondent Frashër Demaj, anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj dhe anëtar korrespondent Muhamedin Kullashi. Atë e shpalli të hapur anëtarja korrespondente Justina Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore. Në të u trajtuan tema nga aspekte të ndryshme dhe nga këndvështrimi historik, juridik, politik, ekonomik e social për periudhën 10-vjeçare të Kosovës.

Kumtesat e tyre në simpozium i paraqitën: Jusuf Bajraktari, Beqir Meta (Tiranë), Ksenofon Krisafi (Tiranë), Muhamedin Kullashi, Arsim Bajrami, Sonja Biserko (Beograd), Islam Lauka (Tiranë), Anton Panchev (Sofje – Bullgari), Teki Kurti (Tiranë), Eva Hyskaj (Tiranë), Gjyljeta Mushkolaj, Frashër Demaj, Esmeralda Osmani (Tiranë) dhe Justina Shiroka - Pula.

Simpoziumi i përfundoi punimet me sukses dhe kontributet autoriale të tij do të botohen në një vëllim të veçantë gjatë vitit 2019.

AKADEMIKËT SABRI HAMITI DHE REXHEP ISMAJLI MARRIN PJESË NË AKTIVITETIN PËR SHËNIMIN E VITIT JUBILAR PËR GJERGJ KASTRIOTIN – SKËNDERBEUN

Më 24-25 maj 2018 akademikët Sabri Hamiti e Rexhep Ismajli kanë qëndruar në Tiranë. Në Pallatin e Kongreseve, para një auditoriumi të gjerë, akademik Hamiti ka mbajtur ligjëratën: "Figura e Skënderbeut në letërsinë shqipe". Ligjëratë është përcjellë me vëmendje

nga të pranishmit, me ç'rast ka pasur edhe shumë pyetje dhe diskutime. Ligjëratën, sipas rregullit, e ka hapur akademik Rexhep Ismajli, i cili e ka bërë paraqitjen për akademik Hamitin.

Në të njëjtën ditë akademik Rexhep Ismajli ka marrë pjesë edhe në homazhe me rastin e vdekjes së akademik Kolec Topallit, anëtar i ASHSH-së dhe anëtar i jashtëm i ASHAK-ut. Ai në emër të ASHAK-ut ka mbajtur fjalë mortore.

NËNSHKRUHET MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NDËRMJET ASHAK-ut DHE UNIVERSITET "HASAN PRISHTINA" TË PRISHTINËS



Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) dhe Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", më 28 maj 2018 nënshkruan Memorandumin e mirëkuptimit në mjediset e Akademisë në Prishtinë. Memorandumi i mirëkuptimit është nënshkruar nga udhëheqësit e të dy institucioneve të larta shkencore dhe arsimore, kryetarit të ASHAK-ut, akademik Nexhat Daci dhe rektorit të UP-së, profesor Marjan Demajt. Ky memorandum ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe të

bashkëveprimit për ngritjen dhe promovimin e performancës në të gjitha fushat e interesit të përbashkët, si dhe t'i përcaktojë fushat fundamentale të kërkimeve akademike për të cilat palët janë të interesuara të punojnë së bashku në të ardhmen.

Udhëheqësit e të dy institucioneve janë zotuar të punojnë për zbatimin e pikave të këtij Memorandumi të mirëkuptimit, i cili është dokumenti i parë i këtij lloji i nënshkruar nga përfaqësuesit e këtyre dy institucioneve të larta akademike.

KRYETARI DACI QËNDROI NË ITALI

Me ftesë zyrtare, më 30 maj - 2 qershor 2018 akademik Daci ka marrë pjesë në Konferencën e përbashkët shkencore "Procesi i Ballkanit Perëndimor". Gjatë qëndrimit kryetari Daci ka marrë pjesë aktive në punimet e Konferencës dhe ka realizuar takime të rëndësishme për avancimin e rolit të ASHAK-ut dhe të vendit në përgjithësi.

MBAHET KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE "LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT (14 VJET MBAS)"

Konferenca u mbajt më 8-9 qershor 2018 dhe u organizua bashkë me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, në kuadër të Protokollit ASHAK-ASHSH, nga Këshilli organizues në përbërje prej: Jusuf Bajraktarit - kryetar, Frashër Demajt - sekretar dhe Beqir Metës, Shaban Sinanit dhe Nuri Bexhetit - anëtarë. Konferenca u hap me pikën

artistike "Marrshi i Bashkimit" të akademik Zeqirja Ballatës.

Fjalën e hapjes e paraqiti Justina Shiroka - Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe më pas me fjalë rasti u paraqitën: Presidenti i Republikës së Kosovës z. Hashim Thaqi dhe akademike Floresha Dado nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Me kumtesat e tyre u paraqitën rreth 29 pjesëmarrës nga Austria, Bullgaria, Maqedonia, Bosnja, Sllovenia dhe Shqipëria.

Përfaqësues i Akademisë Austriake ishte Oliver Schmitt, anëtar i rregullt i saj dhe anëtar i jashtëm i ASHAK-ut.

Konferenca u realizua me sukses, me vlerësime të larta. Kontributet autoriale do të botohen në një vëllim të veçantë gjatë vitit 2019.

KRYETARI DACI PRITI AVOKATIN E POPULLIT

Kryetari i ASHAK-ut akademik Nexhat Daci priti sot më 23 korrik 2018 në një takim në mjediset e Akademisë Avokatin e Popullit z. Hilmi Jasharin dhe zëvendësen e Avokatit të Popullit, znj. Majlindë Sinani - Lulaj. Takimi kishte për qëllim diskutimin e rritjes së bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve në fushat në të cilat palët janë të interesuara të punojnë së bashku në të ardhmen.

Gjatë takimit erdhi te një konstatim i përbashkët se ka gatishmëri nga ASHAK-u dhe Zyra e Avokatit të Popullit të punojnë së bashku për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave fundamentale, duke u bazuar në konventat relevante ndërkombëtare. Realizimi i këtyre të drejtave është prioritet për të gjithë.

Udhëheqësit e të dy institucioneve janë zotuar të punojnë për rritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe promovimin e të drejtave fundamentale të njeriut si parakusht për funksionimin e shtetit të së drejtës dhe zhvillimin demokratik të vendit.

PËRUROHET LEKSIKONI “VENDBANIMET E KOSOVËS, TABLOJA FIZIKE-HAPËSINORE, DEMOGARFIKE DHE FUNKSIONALE”, VËLLIMI I - QENDRAT URBANE



Më 6 shtator 2018 në mjediset e Akademisë u bë përurimi i “Leksikonit të vendbanimeve, vëllimi I, Qendrat urbane”. Për botimin folën kryeredaktori akademik Hivzi Islami, recensenti akademik Anton K. Berishaj dhe prof. dr. Sabri Laçi nga Fakulteti Histori-Filologji i Universitetit Shtetëror

të Tiranës, ekspert i njohur në fushën e gjeoshkencave.

Nga folësit u cilësua si botim që përmbushi një nevojë të madhe për gjeoshkencat, shkencat sociale dhe opinionin e gjerë lexues dhe shfrytëzues. Botimi do të jetë një trashëgimi e rëndësishme për shkencën dhe kulturën tonë në përgjithësi.

Në përurim morën pjesë anëtarë të Akademisë, ekspertë nga shkencat gjeohapësinore, gjeografë, historianë, sociologë, urbanistë, planerë, ekonomistë dhe të interesuar të tjerë.

AKADEMIK ZEQIRJA BALLATA QËNDROI NË TIRANË

Më 14 shtator 2018, në kuadër të shënimit të Vitit jubilar për Skënderbeun, akademik Ballata ka mbajtur në Tiranë, në Pallatin e Kongreseve, Ligjëratën: “Gjergj Kastrioti - Skënderbeu në kulturat muzikore ndërkombëtare dhe në atë mbarëkombëtare shqiptare”

Paraqitja e akademik Zeqirja Ballatës është bërë nga akademik Vasil Tole, sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

TRYEZA SHKENCORE, PËRURIMI DHE EKSPOZITA PERSONALE E AKADEMIK MUSLIM MULLIQIT

Tryeza shkencore dhe ekspozita janë mbajtur më 19 shtator 2018. Tryeza

filloi punimet në orën 11:00 dhe atë e shpalli të hapur anëtar korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve, ndërsa me kumtesat e tyre u paraqitën Brane Kovič nga Sllovenia, Suzana Varvarica - Kuka dhe Abaz Hado nga Shqipëria, si dhe Hivzi Muharremi nga Kosova. Pas tryezës u përrua edhe libri “Muslim Mulliqi - Monografi”, botim i ASHAK-ut, me autor Brane Kovič.



Në orët e mbrëmjes, në një atmosferë të këndshme, u hap Ekspozita e akademik Muslim Mulliqit. Atë e hapi anëtar korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve, ndërsa me fjalë rasti para pjesëmarrësve u paraqit akademik Rexhep Ferri, i cili në fjalën e tij e vlerësoi lart veprën dhe figurën e Muslim Mulliqit.

PËRURORHET FJALORI ENCIKLOPEDIK I KOSOVËS



Më 25 shtator në mjediset e Akademisë u përrua Fjalori enciklopedik i Kosovës (FEK). Ceremoninë e shpalli të hapur akademik Ali Aliu dhe më pas me fjalë rasti të pranishmëve iu drejtua kryetari i Akademisë, akademik Nexhat Daci, i cili në fjalën e tij e vlerësoi lart punën e bërë për FEK. Për botimin foli akademik Mehmet Kraja, kryeredaktor i FEK-ut.

Në këtë aktivitet përveç anëtarëve të Akademisë morën pjesë numër i madh i profesorëve universitarë, përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të interesuar të tjerë.

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI NË CAMBRIDGE U SHPALL ANËTAR I JASHTËM NDERI I AKADEMISË SË ARTEVE DHE TË SHKENCAVE TË AMERIKËS

Akademik Rexhep Ismajli, anëtar i rregullt i ASHAK-ut, anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtar i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve me seli në Salzburg të Austrisë, në ceremoninë solemne që u zhvillua me 5 e 6 tetor

2018 në Selinë e Akademisë në Cambridge të Massachusetts-it u shpall bashkë me një numër anëtarësh të rinj të rregullt dhe të nderit të jashtëm anëtar i jashtëm nderi i Akademisë së Arteve dhe të Shkencave të Amerikës (American Academy of Arts and Sciences). Në këtë institucion akademik Ismajli u zgjodh në prill të këtij viti. Njoftimin e bëri të ditur vetë kryetari i Akademisë Amerikane, Jonathan F. Fanton, në të cilin shkruante: “Ky nderim shënjon konsideratën e thellë që kanë drejtuesit e fushës suaj dhe anëtarët tanë”. Motivimi që u lexua publikisht vinte në pah faktet se Ismajli njihet si studiues i gjuhës shqipe, i historisë së saj ashtu si dhe i gjendjes së sotme, si profesor i gjuhësisë së përgjithshme dhe i historisë së shqipes, si ish-kryetar i ASHAK-ut, etj. Në janar po të këtij viti ai ishte zgjedhur anëtar i përhershëm nderi i Shoqatës së Linguistëve të Amerikës (Linguistic Society of America - LSA).

Akademik Rexhep Ismajli ka zhvilluar veprimtari në fushën e tij në Prishtinë, ka bërë specializime në Francë dhe Gjermani, ndërsa ka mbajtur mësimë për fushat e albanologjisë në Universitetin e Munihut, në Universitetin e Lubjanës dhe ka ligjëruar në tubime shkencore në vende të ndryshme të Evropës dhe të Azisë (Izrael, Kinë...). Ka bashkëpunuar ngushtë me profesorët e njohur në Prishtinë si Idriz Ajeti, Besim Bokshi e të tjerët më vonë, ndërsa kontakte bashkëpunimi ka pasur dhe vazhdon të ketë me studiues të njohur në fushat me të cilat merret, si A. Martinet

(student i të cilit ishte), E. Çabej, S. Riza, E. Hamp, Sh. Demiraj, K. Topalli, S. Mansaku, B. Beci, V. Friedman, L. Newmark, N. Borecki, I Sawicka, A. Rusakov, W. Fiedler, Brian D. Joseph, L. Savoia, F. Solano, F. Altimari, M. Mandala e shumë të tjerë. Anëtar i ASHAK-ut është nga viti 1993. Është marrë dhe me zgjerimin e bashkëpunimit të Akademisë sonë me botën akademike dhe shkencore në Evropë dhe jashtë saj. E ka përfaqësuar denjësisht Akademinë në raportet me botën shkencore. Ka qenë dhe kryetar i Këshillit Kombëtar të Shkencës të Republikës së Kosovës (2008-2011).

KRYETARI DACI QËNDROI NË MAL TË ZI

Me ftesë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Malit të Zi, kryetari Daci prej 3-7 tetor ka qëndruar në Mal të Zi dhe ka marrë pjesë në Simpoziumin: “Kultura, teknologjia dhe humanizmi”, i organizuar nga Akademia Malazeze dhe Euro Mediterranean Academy Network (EMAN).

Kryetari Daci ka zhvilluar takime me përfaqësues të akademive të Kroacisë, Izraelit, Maqedonisë, etj.

Me kryetarin e Akademisë Malazeze kanë biseduar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy akademive dhe janë dakorduar për përgatitjen dhe nënshkrimin e protokollit të bashkëpunimit.

MBAHET KONFERENCA SHKENCORE "ROMANI SHQIPTAR, FILLIMI I SHEKULLIT XXI"



Konferenca u organizua nga Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK-ut në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, mbështetur në Protokollin për bashkëpunim shkencor midis dy akademive. Konferenca u mbajt, siç ishte paraparë, më 10 tetor 2018. Ishin paraqitur për të marrë pjesë 21 referues, që kishin dërguar titujt e kumtesave dhe abstraktet, të cilat u publikuan bashkë me programin e punës. Në Konferencë u paraqitën 15 referues, ndërsa një prej tyre e dërgoi kumtesën. Pesë pjesëmarrës nuk erdhën për arsye të ndryshme (një rast vdekjeje, dy arsyetime me sëmundje, të lajmëruar ditën Konferencës...). Aktiviteti u mbajt në dy seanca të ngjeshura me nga 7-8 pjesëmarrës, për t'u mbyllur në orën 14.30. Konferenca mbledhi kritikë, studiues e dijetarë të letërsisë për trajtim të shumanshëm të zhanrit të romanit shqiptar të fillimit të shekullit XXI dhe u vlerësua e suksesshme, në kornizat e asaj që pritej. Tashmë jemi në fazën e grumbullimit të versioneve për shtyp të kumtesave që do të publikohen në fillim të vitit të ardhshëm.

PËRURORHET LIBRI "LINDJA E VËSHTIRË E SHTETËSISË SË KOSOVËS" E AKADEMIK NEXHAT DACI

Më 15 tetor 2018 në mjediset e Akademisë u përurua libri "Lindja e vështirë e shtetësisë së Kosovës" e autorit akademik Nexhat Daci.

Fjalën e hapjes në këtë përurim e mbajti akademik Jusuf Bajraktari, ndërsa për librin folën recensentët Arsim bajrami dhe Gjyljeta Mushkolaj, anëtarë korrespondentë të ASHAK-ut.

Të dy recensentët e vlerësuan lart librin në fjalë. Në fund të pranishmit i përshëndeti edhe autori akademik Daci, i cili fillimisht i falënderoi parafolësit për fjalët e mira dhe të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre.

Të pranishëm në këtë aktivitet përveç anëtarëve të Akademisë ishin edhe Presidenti i Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi, Kryeministri z. Ramush Haradinaj, Zëvendëskryeministri z. Behgjet Pacolli, përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe mysafirë të shumtë.



MBAHET SIMPOZIUMI SHKENCOR NDËRKOMBËTAR “FILOZOFIA DHE TEATRI - RAPORTET E TEATRIT BASHKËKOHOR ME TEATRIN MODERN”

Bartës i aktivitetit anëtari
korrespondent Muhamedin Kullashi.

Simpoziumi u mbajt më 17 tetor 2018
dhe u organizua nga këshilli organizues
në përbërje: Akademik Rexhep Ismajli,
akademik Eqrem Basha dhe anëtari
korrespondent Muhamedin Kullashi.



Qëllimi i kësaj konference ishte të
merren në shqyrtim disa aspekte të
problemeve që kanë të bëjnë me
teatrën e sotëm evropian, duke marrë
parasysh debatet që janë zhvilluar e po
zhvillohen brenda rrymave të mendimit
kritik për teatrin.

Konferencën e hapi anëtarja
korrespondente Justina Shiroka - Pula,
sekretare e Seksionit të Shkencave
Shoqërore, ndërsa me kumtesat e tyre
u paraqitën rreth 11 pjesëmarrës. Në
mesin e tyre ishin profesorët: Nga Italia
Valentina Valentini, nga Franca Jean-
Pierre Sarrazac dhe nga Shqipëria
Armand Bora.

Simpoziumi i përfundoi punimet me
sukses dhe kontributet autoriale të
pjesëmarrësve do të botohen në një
vëllim të veçantë gjatë vitit 2019.

ANËTARE KORRESPONDENTE GJYLJETA MUSHKOLAJ QËNDROI NË BRUKSEL

Me ftesë të ALLEA-s, anëtarja
korrespondente Gjyljeta Mushkolaj ka
marrë pjesë në seminarin me temë
"Komunikimi i shkencës në një botë
komplekse."

Seminari është organizuar më 17 tetor
2018 në Bruksel dhe është përbërë nga
dy pjesë: punësoria ditore dhe
bashkëbisedimi i mbrëmjes.

Në seminar hulumtuesit, komunikuesit
shkencorë, politikëbërësit dhe
përfaqësuesit e industrisë diskutuan
për sfidat me të cilat ballafaqohet
shkenca dhe mënyrat e tejkalimit të
tyre për të përmirësuar komunikimin
shkencor në nivel evropian.
Pjesëmarrësit analizuan *status quo* e
shkencës aktuale, nismat e ndërmarra
për komunikim në të gjithë Evropën,
diskutuan strategjitë dhe mundësitë e
ardhshme për krijimin e platformave të
reja për bashkëpunim në këtë fushë.

MBAHET KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE "SISTEMI I ARSIMIT, TREGU I PUNËS DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT"

Bartës të aktivitetit: akademik Isa Mustafa dhe anëtare korrespondente Justina Shiroka - Pula.



Konferenca u mbajt më 26 dhe 27 tetor 2018 dhe u organizua nga Këshilli organizues në përbërje: Akademik Isa Mustafa, akademik Hivzi Islami, akademik Vinko Kandžija, Universiteti i Rijekës (Kroaci), profesor Tina Harrison, Universiteti i Edinburgut (Skoci), profesor Aziz Pollozhani, Universiteti "Nënë Tereza", Shkup (Maqedoni), anëtari korrespondent Arsim Bajrami, anëtare korrespondente Justina Shiroka-Pula.

Konferencën e hapi anëtare korrespondente Justina Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore, ndërsa folësit kryesor në Konferencë ishin: Will Bartlett, London School of Economics (Angli), me temën: "Kontributi i arsimit të lartë për formimin e shkathtësive dhe zhvillimin ekonomik në Ballkanin Perëndimor"

dhe Dijana Vican, Universiteti i Zarës (Kroaci), me temën: "Reformat e arsimit dhe ndërkombëtarizimi i arsimit si forcë lëvizëse dhe bartëse të ndryshimeve sociale dhe ekonomike në vendet në zhvillim".

Me kumtesa në Konferencë u paraqitën rreth 35 pjesëmarrës.

Konferenca i përfundoi punimet me sukses.

Kontributet autoriale të saj do të botohen në një vëllim të veçantë gjatë vitit 2019.

AKADEMIK ANTON K. BERISHAJ DHE ANËTARI KORRESPONDENT KUJTIM SHALA QËN RUAN NË TIRANË

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e Vitit Jubilar Mbarëkombëtar për Gjergj Kastriotin – Skënderbeun, akademik Anton K. Berishaj dhe anëtari korrespondent Kujtim Shala morën pjesë në Konferencën albanologjike ndërkombëtare.

Akademik Berishaj paraqiti kumtesën: "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu sipas disa burimeve të publikuara jugosllave", ndërsa profesor Shala paraqiti kumtesën: "Skënderbeu i letërsisë". Në këtë Konferencë akademik Jusuf Bajraktari e drejtoi seancën e tretë.

Aktivitetet për shënimin e Vitit Jubilar Mbarëkombëtar për Gjergj Kastriotin –

Skënderbeun kanë filluar që në muajt e parë të vitit 2018. Nga ASHAK-u anëtarë të Komitetit shkencor ishin caktuar akademikët Rexhep Ismajli, Jusuf Bajraktari dhe anëtari korrespondent Frashër Demaj, të cilët u janë përgjigjur ftesave dhe kanë marrë pjesë në aktivitetet përkatëse. Nga Kosova, me propozimin e këtij Komiteti, në aktivitetet shkencore kanë marrë pjesë 10 studiues të fushave të ndryshme.

HAPET EKSPOZITA PERSONALE E AKADEMIK TAHIR EMRËS

Në galerinë e Akademisë më 20 nëntor u hap ekspozita personale e akademik Tahir Emra me rastin e 80-vjetorit të lindjes dhe 60-vjetorit të krijimtarisë artistike. Ekspozita u organizua nën përkujdesjen e kuratorit Kujtim Buza. Në të u përfshinë shumë punime të cikleve të ndryshme të krijimtarisë së autorit.

Ekspozitën e shpalli të hapur anëtar korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve, ndërsa profesor Kujtim Buza mbajti një fjalë rasti, duke e vlerësuar lart krijimtarinë e akademik Emrës. Në fund autori falënderoi Akademinë për organizimin e Ekspozitës dhe të gjithë pjesëmarrësit.



PËRURORHET LIBRI “STRUKTURA E RROKJES SHQIPE”

Më 23 nëntor, në mjediset e Akademisë u përurua libri: “Struktura e rrokjes shqipe” e autoreve: Irena Sawicka dhe Karolina Dargiel.



Fjalën e hapjes e mbajti anëtari korrespondent Bardh Rugova, ndërsa për librin foli akademik Rexhep Ismajli, i cili e vlerësoi lart punën e bërë dhe tha se libri është i rëndësishëm së veçantë.

Në fund edhe autorja Sawicka falënderoi akademik Ismajlin dhe ASHAK-un për botimin e librit.

DELEGACIONI NGA AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E MAQEDONISË (ASHAM) VIZITË NË ASHAK

Më 27 nëntor në mjediset e Akademisë u zhvillua takimi ndërmjet delegacioni të ASHAM-it dhe ASHAK-ut.

Palët biseduan për pikat e përbashkëta të Protokollit të bashkëpunimit dhe u pajtuan për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit.

NDËRROI JETË ALBANOLOGU FRANCEZ CHRISTIAN GUT



Është ndarë nga jeta më 26 nëntor dhe është varrosur më 30 nëntor studiuesi i fushave të ndryshme të albanologjisë, profesori i shquar, përkthyesi i letërsisë shqiptare, anëtari i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës prof. dr. Christian Gut.

I lindur në Paris në vitin 1931, Christian Gut kreu studimet për histori e filologji në Ecole Nationale des Chartes dhe i kurorëzoi me një tezë nga historia e së drejtës franceze, për të mbrojtur pastaj doktoratën në es lettres. Kreu disa detyra midis funksioneve administrative, mësimdhënies dhe punës shkencore. Shërbeu në Algjeri, më vonë si ekspert i UNESCO-s në Çad, Kongo, Senegal, Qipro, etj. Një kohë drejtoi arkivat e qytetit të Parisit.

Pas diplomimit në Ecole Nationale des Langue Orientales, në vitin 1966 mentori i tij, albanologu i mirënjohur Henri Boissin, i besoi kurset e historisë së popullit shqiptar. Më 1972 hapi degën e historisë dhe të filologjisë shqiptare në Ecole Practique des Hauts Etudes, ku deri në pensionim bëri të mundur përgatitjen e disa tezave të doktoratës.

Përreth një gjysmë shekulli në shërbimet publike, prej të cilave 35 vjet mësimdhënie universitare, z. Gut ka botuar një mori artikujsh e studimesh, midis të tjerash edhe në revistën “Studime” të ASHAK-ut. Ka dhënë kontribut të çmuar në veprat kolektive me interes të përgjithshëm enciklopedik dhe veçanërisht shquhet angazhimi i tij në përkthimin e veprave të rëndësishme të letërsisë shqiptare. Ka përkthyer në frëngjisht dhe e ka botuar në Pejë Kanunin e Lekë Dukagjinit, që erdhi si rezultat i një pune të gjatë studimi të së drejtës së hershme të shqiptarët.

Në vitin 1996 u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa në vitin 2008 ASHAK botoi monografinë e tij “Pashko Vasa”, njëri nga personalitetet më të rëndësishme të Rilindjes Kombëtare Shqiptare me të cilin prof. Gut është marrë dendur.

Me vdekjen e tij albanologjia humbi një nga studiuesit e rëndësishëm të gjuhës, letërsisë dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi.

ANËTARI KORRESPONDENT FETAH PODVORICA MBAN LIGJËRATË NË FRANCË

Prof. Fetah Podvorica, anëtar korrespondent i ASHAK-ut ka marrë pjesë, si ligjërues i ftuar, në konferencën shkencore ndërkombëtare “Water Micropollutants: from removal to detection” të mbajtur në Orleans të Francës prej datës 26 deri më 28 nëntor 2018. Ai e ka mbajtur ligjëratën me titull “Electro-Fenton process. Influence of the electrode materials”.

**VJETARI
2018**

Botues

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Shfqet Riza

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 6.5 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup

